



# FESTOJMË FAMILJEN

NJË UDHËTIM SË BASHKU



© World Vision International 2014

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë, me përjashtim të fragmenteve të shkurtra në materiale pasqyruese, pa lejen paraprake nga botuesi.

Botuar nga departamenti i Përkushtimit të Krishterë në emër të World Vision International.

Për informacione të mëtejshme rreth këtij botimi apo rreth botimeve të World Vision International, apo për kopje shtesë të këtij botimi, ju lutem kontaktoni: [wvi\\_publishing@wvi.org](mailto:wvi_publishing@wvi.org).

Nëse dëshironi ta përktheni këtë material në gjuhën e vendit tuaj, ju lutem kontaktoni [wvi\\_publishing@wvi.org](mailto:wvi_publishing@wvi.org) përpara se të vazhdoni më tej me përkthimin.

Kryeredaktore: Edna Valdez. Redaktore e përmbytjes: Rebecca Russell. Redaktore e përdorueshmërisë: Lori Macklin. Menaxhimi i realizimit: Katie Klopman, Daniel Mason. Redaktor bocash: Joan Laflamme. Korrektura: Audrey Dorsch. Skicimi dhe faqosja: Lara Pugh.

Citimet nga Shkrimet Biblike janë marrë nga: Versioni ABS Shoqëria Biblike Shqiptare © 2009 Bibla e Studimit.

## Parathënie

Zhvillimi shpirtëror i fëmijëve (ZSHHF) është një shprehje e rëndësishme e identitetit, e dëshmisë dhe e përkushtimit tonë të krishterë ndaj një qasjeje holistike drejt zhvillimit transformues. Vitet e fundit kemi qenë vetë dëshmitarë të mënyrës se si zhvillimi shpirtëror i fëmijëve ka krijuar mundësi për të ushqyer shpirtërisht dhe pasur një ndikim jo vetëm tek jeta e fëmijëve me të cilët ne punojmë, por gjithashtu tek prindërit, kujdestarët, drejtuesit e tyre në besim si dhe te vetë stafi ynë. Ne e kuptojmë se fëmijët nuk rriten të izoluar, por janë pjesë e familjeve, lagjeve apo fshatrave, si dhe e komuniteteve të besimit. Nëse duhet që të kemi me të vërtetë një shërbesë e cila ndryshon jetë, ne duhet të lidhemi me këto mjedise dashurie dhe përkujdesje. Në punën tonë, ne punojmë shpesh me fëmijët, por nganjëherë shpërfillim prindërit dhe kujdestarët. “Festojmë familjen” është një material i rëndësishëm burimor, i cili synon të mbushë një pjesë të këtyre boshllëqeve.

Ne i shikojmë prindërit si siguruesit kryesorë të zhvillimit të gjithanshëm për fëmijët, përfshi këtu zhvillimin shpirtëror. Për këtë arsye, një strategji kyçe e ZSHHF-së është inkurajimi i prindërve për të krijuar mjedise të sigurta dhe të dashura, në të cilat fëmijët të ndihen të përbushur. Duke dëgjuar mendimet e fëmijëve, ne e kuptojmë se është e domosdoshme që ata të kenë një mjedis të sigurt ku ata të ndiejnë dashuri si dhe lirinë për të kërkuar dhe për të njohur Perëndinë. Ne gjithashtu e dimë se vëmendja që fëmijët marrin nga kujdestarët (apo mungesa e kësaj dashurie dhe përkujdesjeje) ndikon në mënyrën se si ata e kuptojnë Perëndinë. Për shembull, kur fëmijët trajtohen me drejtësi, butësi dhe dashuri, ata e kanë më të lehtë ta shikojnë Perëndinë si të drejtë, të butë, të mirësishëm dhe të dashur. Nga ana tjetër, kur fëmijët janë abuzuar apo janë shpërfillur prej atyre të cilët ata kanë pasur më afër, ata mund të kenë frikë se Perëndia është si të afërmit e tyre. Për rrjedhojë, në partneritet me prindërit, si dhe duke i mbështetur ata në përpjekjet e tyre për të krijuar një mjedis mbrojtës dhe të dashur për fëmijët, ne mund të ndikojmë te mënyra se si fëmijët mësojnë të mendojnë rreth Perëndisë.

Udhësuesi “Festojmë familjen” synon të jetë një material burimor për stafin tonë si dhe për partnerët nga kishat, ndërkohë që ata mbështesin prindërit dhe kujdestarët në udhëtimin e tyre drejt mirëqenies shpirtërore të fëmijëve si dhe për jetën në tërë plotësinë e saj. Ky doracak shërben si një udhëzues për lehtësuesit. Ai ofron mundësinë për të marrë pjesë në veprimtari të thjeshta, të cilat sigurojnë hapësirën për një vetëreflektim të thellë si dhe për rritje.

Trajnimi “Festojmë familjen” jo vetëm i ndihmon prindërit dhe kujdestarët, për t’i pajisur dhe për t’i mbështetur ata me mjete të dobishme, por edhe i inkurajon që të kuptojnë historitë e veta të fëmijërisë si dhe në radhë të parë përvojat e tyre. Sapo ata të kenë mundur të reflektojnë për disa nga përvojat e së shkuarës së tyre, do të mundën gjithashtu të fillojnë të kuptojnë se si këto ngjarje të fëmijërisë së tyre kanë ndikuar te mënyra se si ata po rrisin fëmijët e vet.

Trajnimi “Festojmë familjen” është produkt i dëgjimit të historive dhe pikëpamjeve të prindërve dhe kujdestarëve nga një spektër i gjerë traditash dhe kontekstesh, dhe i shqyrtimit të kujdesshëm në lutje tek Perëndia. Ne shpresojmë që përmes “Festojmë familjen” të udhëtojmë bashkë e të mund të shikojmë disa prej plagëve në të shkuarën tonë; të krijojmë hapësirë për dashuri, hir, shërim dhe falje në të tashmen tonë dhe të jemi të pajisur me mjetet e duhura, të cilat do të na ndihmojnë të përbushin ëndrrat tona për familjen tonë në të tashmen dhe në të ardhmen. Lutja jonë për “Festojmë familjen” është që ky udhëtim të jetë i atillë që t’i drejtojë familjet drejt një jetë në të tërë plotësinë e saj nga brezi në brez.



Kathy Currie  
Drejtues i Partnershipit – Fëmijët në Shërbesë



Dan Ole Shani  
Drejtues i Partnershipit – Përkushtimi i Krishterë

## Komentet e pjesëmarrësve

“Festojmë familjen” është përdorur në vende të ndryshme dhe reagimi si i stafit të World Vision, ashtu edhe i pjesëtarëve të komunitetit ka qenë i fuqishëm. Ja disa komente nga stafi i World Vision:

### **Daru Marhaendhy, Kordinator i Formimit Shpirtëror, WV Indonezi**

“Pjesëmarrja në “Të festojmë familjet” është një bekim për mua. Workshop-i nuk ka të bëjë me ‘një person të jashtëm’, por i adresohet vetes sonë si dhe familjeve tona. Mjetet në dispozicion janë të lehta për përdoruesin, por [workshop-i] me të vërtetë që trajton çështjet bazë përbrenda jetës familjare. Në mars ne planifikojmë të zhvillojmë një orë mësimi për këtë festim të familjes përbrenda një konteksti besimesh të ndryshme fetare. Një prej PZHZ-ve [programet e zhvillimit zonal] tona ka shfaqur interes për të adoptuar veprimtaritë e këtij programi dhe ne do ta realizojmë këtë me Grupin Vetëndihmues (prindërit dhe stafin e PZHZ-së). Ju lutemi të na mbani në lutje.”

### **Danut Manastireanu, Drejtor i Besimit dhe Zhvillimit, MEER**

“Jam shumë i gëzuar që shikoj se në këtë takim faktikisht nuk pati mure ndarëse mes myslimanëve dhe të krishterëve. Disa prej nesh janë prindër ndërkohë që të tjerë ne kemi prindër. Disa prej nesh janë gjyshër, kështu që kjo ka të bëjë vërtet me ne dhe padyshim që kjo bën ndryshimin. Niveli i angazhimit i të gjithëve ju bëri ndryshimin. Mendoj se kjo ndodhi për shkak se gjithçka që u zhvillua nuk ishte diçka që nuk ka lidhje me ne, por, përkundrazi, që diçka që kishte të bënte me të gjithë të pranishmit si dhe me të tjerë njerëz që ata i duan fort e për të cilët kujdesen shumë. Ne mund të bëjmë punën tonë si inxhinierë të klasit të dytë, duke zbatuar vetëm atë që na thuhet, por kur vëmë në punë edhe krijimtarinë tonë, që është një nga dhuratat më të shkëlqyera që na ka dhënë Perëndia, rezultati nuk është vetëm diçka e mirë dhe funksionale, por është gjithashtu diçka e bukur”.

## Mirënjohje

Ne falënderojmë Perëndinë për dhuratën e të qenurit pjesëmarrës në zhvillimin shpirtëror të fëmijëve si dhe të momenteve të shumta transformuese të përbashkësisë dhe zbulësës.

Ne falënderojmë atë djalosh nga Mali, i cili mbolli farën në zemrën tonë dhe na frymëzoi për krijimin e këtij materiali burimor. Kërkesa e tij e shprehur me fjalët: “Ju lutem, mësojini prindërit tanë se si të na kenë përsëri për zemër” na dha një shtysë për t’u nisur në rrugën tonë të dëgjimit të prindërve dhe të zbulimit të pikave lidhëse mes tyre dhe fëmijëve – dashuri dhe hir<sup>1</sup>, falje, mirësi dhe falenderim.

I shprehim mirënjohjen tonë fondacionit “Bolthouse”, që na vuri në dispozicion materialet, të cilat na mundësuan dëgjimin e më shumë se një mijë fëmijëve dhe qindra prindërve nga Mali, Nikaragua, Uganda, Kamboxhia, Filipinet dhe nga Shqipëria.

Ndaj skuadrës dhe miqve tanë të Nismës së Dëshmisë së Krishterë (NDK), të cilët udhëtuan bashkë me ne:

Sepse keni prirë rrugën tonë dhe na keni mbështetur pa rezerva: Tim Dearborn, Kathy Currie, Paul Stephenson, Dan Ole Shani, Jeanine Collins dhe skuadrës tonë të Qendrës Mbarëbotërore të Përkushtimeve të Krishtera (QMPK);

Skuadrës së NDK-së në Filipine: pastor Joey Umali, pastor Choi Magdaong, Katt Anthony, Atit Bart Pastor, motrës

Annie Corpin, Grace Baloro (PZHZ Diadem) dhe Beth Delgado (PZHZ Davao);

Skuadrës së NDK-së Shqipëri dhe miqve tanë: Albana Gerxhi, Edmond Palucaj (PZHZ, Lezhë) dhe Erjola Zenuni (PZHZ, Korçë);

Skuadrës së NDK-së në Nikaragua dhe miqve tanë: Azucena Lopez, Zorayda Gomez dhe Abiud Urbina;

Skuadrës së NDK-së në Kamboxhia dhe miqve tanë nga WV, Indonezi, që morën pjesë në diskutimet e Grupit të Fokusit (DGF-të): Chinhho Saing, Veasna Sok, Chin Soksan, Dwi Yatmoko dhe Daru Marhaendhy;

Skuadrës së NDK-së në Mali dhe miqve tanë: Rebeka Kamate, Modibo Diarra (PZHZ, Diago) dhe Jane Fane (PZHZ, Nonsombougou);

Skuadrës së NDK-së në Uganda dhe mikeshës sonë Christine Uwamahoro.

Dëshirojmë të ofrojmë falënderime të mëtejshme ndaj Sarah Plummer, Margaret Posnett si dhe shumë kolegëve të tjerë të World Vision, të cilët na ndihmuan të rishikojmë dhe të përpunojmë këtë material gjatë procesit të botimit si dhe përmes diskutimeve pilote. Ju jemi mirënjohës për kohën që na kushtuat si dhe për kontributet tuaja të menduara thellë.

Fjalët në këtë program mësimor dhe persiatjet e zemrës sonë u miratofshin para Zotit dhe Shpenguesit tonë, Jezus Krisht! Amen!

<sup>1</sup> Një ndihmë hyjnore e pamerituar, që u jepet njerëzve për rigjenerimim apo shenjtërimin e tyre.

## Përmbajtja

<b>Parathënia</b> .....	<b>iii</b>
<b>Komentet e pjesëmarrësve</b> .....	<b>iv</b>
<b>Mirënjohjet</b> .....	<b>v</b>
<b>Historiku</b> .....	<b>1</b>
<b>Hyrje në strukturën e “Festojmë familjen”</b> .....	<b>2</b>
<b>Shënimet udhëzuese të lehtësuesit</b> .....	<b>5</b>
<b>Veprimtaritë hyrëse</b> .....	<b>7</b>
Sesioni 1: Mirëseardhja dhe caktimi i pritshmërive .....	7
<b>Hyrje</b> .....	<b>10</b>
Sesioni 2: Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time .....	10
<b>Moduli 1 Të adresojmë të shkuarën</b> .....	<b>13</b>
Sesioni 3: Ngjarja më e pashlyer për mua nga fëmijëria .....	14
Sesioni 4: Shenja të plotësisë, shenja të thyerjes .....	16
Sesioni 5: Farat e mirësisë .....	19
<b>Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen</b> .....	<b>24</b>
Sesioni 6: Gëzime dhe dhimbje .....	25
Sesioni 7: Hapësirë për dashuri dhe hir .....	32
Sesioni 8: Arsye për mirënjohje dhe mundësi për të falur .....	39
<b>Moduli 3 Të vizionojmë të ardhmen</b> .....	<b>43</b>
Sesioni 9: Momente përcaktuese .....	44
Sesioni 10: Ndërtues të mençur .....	50
Sesioni 11: Përcaktimi i hapave tanë .....	54
<b>Moduli 4 Të ndjekim ëndrrat tona</b> .....	<b>72</b>
Sesioni 12: “Të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të mia” .....	73
Sesioni 13: Të flasim bekime .....	77
Sesioni 14: Plani i zbatimit të mësimin .....	81
<b>Shtojcat</b> .....	<b>84</b>
Bibliografia .....	85
Lista e plotë e materialeve të nevojshme .....	88
Modeli i përshtatshmërisë të sesionit .....	89
Vlerësimet në fund të workshop-it .....	91
Dokumentimi i historisë së ndikimit .....	93
Fleta gjurmuese e replikimit .....	95



## Historiku



‘Të lutem, a mund t’u thuash prindërve tanë që të na kenë sërish për zemër?’

‘A mund të na mësoni se si t’i rrisim fëmijët tanë dhe të tregojmë kujdesin e duhur ndaj tyre?’




‘Të lutem, a mund t’u thuash prindërve tanë që të na kenë sërish për zemër?’- qe ajo çka tha një djalosh nga shteti afrikan i Malit kur u pyet se si e kuptonte ai mirëqenien. Stafit të ZHSHF-së iu desh ta pyeste rishtas, në mënyrë që të sigurohej se pyetja e tyre qe përkthyer saktë; po, kjo ishte ajo që ai kishte thënë. Që prej asaj kohe, këto fjalë na kanë mbetur në mendje. Ushtrimi i dëgjimit të mendimeve të fëmijëve, zhvilluar me fëmijë nga grupe të ndryshme shoqërore, të përfaqësuara në partneritetin tonë, nxjerr në pah tri mënyra të rëndësishme përmes të cilave të miturit bëhen të vetëdijshëm për Perëndinë. Ato janë: droja dhe mahnitja që të krijohet nga ato që Perëndia ka krijuar, veprat e motivuara nga dashuria dhe mirësia e njerëzve që i rrethojnë, si dhe mrekullitë e lutjet që marrin përgjigje. Kjo gjithashtu tregoi që një mjedis i sigurt, i dashur dhe përkujdesës ndaj tyre është kusht themelor për ushqimin shpirtëror të fëmijëve dhe i nevojshëm në rrugën drejt zhvillimit shpirtëror të tyre.

Një vit e gjysmë më vonë, dhe si përgjigje ndaj kërkesës së këtij djali, u krye një ushtrim për dëgjimin e mendimeve të fëmijëve, por kësaj radhe me prindër. World Vision beson se prindërit janë të parët që kanë përgjegjësi për mirërritjen e fëmijëve të tyre si dhe për krijimin e atij mjedisi të sigurt dhe të dashur, në mënyrë që fëmijët të zhvillohen e të jenë të mbarë. Morën pjesë mbi 600 prindër dhe një prej rezultateve më të rëndësishme të veprimtarisë qe kërkesa e një prindi, i cili u shpreh: ‘Ju lutem, a mund të na mësoni se si t’i rrisim fëmijët tanë dhe të tregojmë kujdesin e duhur ndaj tyre?’ Kjo kërkesë na nisi edhe një herë drejt një udhëtimi plot zbulime të ndryshme.

Cili është problemi? Ky djalosh dëshiron që prindërit ta duan, por edhe prindërit dëshirojnë t’i tregojnë dashuri. Të dyja palët dëshirojnë të njëjtën gjë e, megjithëkëtë, duket se mes tyre ka diçka që i ndan. Kjo ka çuar në një proces shqyrtimi dhe Perëndia, me kalimin e kohës, na zbuloi pikat lidhëse të shprehura me pesë fjalë të çmuara: dashuri, hir, mirësi, falje dhe falënderim.

Kjo është baza e festimit të familjeve – reagimi ndaj pyetjes së një djaloshi dhe kërkesës së një prindi.

## Hyrje e “Festojmë familjen”



“Festojmë familjen” është e bazuar në këto katër koncepte të çmuara: krijimi i hapësirës për dashuri dhe hir, gjetja e farave të mirësisë, mundësitë për falje dhe arsyet për falënderim. Ky program i drejton familjet në një udhëtim drejt plotësisë së jetës, duke u përqendruar te katër pjesët e udhëtimit: trajtimi i së shkuarës, njohja e së tashmes, vizionimi i së ardhmes dhe ndjekja e ëndrrave tona. Me këtë, shpresohet që të nisim një brez të ri plotësie dhe favori si dhe ta prishim ciklin e thyerjes dhe varfërisë nga të gjitha anët brenda familjeve.

Fokusi është te familja, jo thjesht te fëmija e as vetëm te prindërit. Kjo është një përpjekje për të mbështetur njësinë bazë të shoqërisë, e cila nga shumë anë është njësi bazë e dashurisë dhe e përkujdesjes. Në shumicën e rasteve, kjo njësi bazë do të jenë pikërisht fëmijët dhe prindërit, por në disa situata të caktuara mund të bëhet fjalë për cilindo grup njerëzish që tregon dashuri dhe kujdes për fëmijët në kontekstin e ushqimit të marrëdhënieve.

Shpresohet që plotësia e jetës të arrihet për familjet. Ndërkohë që kjo është edhe një shpresë, edhe një vendmbërritje, është gjithashtu e mundur që të përjetojmë shprehje të plotësisë së jetës ndërsa jemi në këtë udhëtim. Për shembull, dhurata e jetës, veprat e mirësisë dhe dashurisë, hiri që merret e që jepet, kremtimi i besnikërisë së Perëndisë dhe fitorja mbi sfidat.

Çdo familje e nis udhëtimin e saj me tërësinë e realiteteve të veta, me shenja të thyerjes dhe shenja të plotësisë. Pikënisja mund të mos jetë ideale, por, gjithsesi, është një pikënisje prej nga ku mund të ndërtohet dhe të rindërtohet gjithçka. Sidoqoftë, ne duam të arrijmë në atë pikë ku ka prova të plotësisë, të favorit dhe të bekimit; ne dëshirojmë të përjetojmë rimëkëmbje, paqe dhe gëzim në familjet tona.

Në workshop-in “Festojmë familjen” do të merren në shqyrtim katër tema kyçe. Këto tema janë theksuar, për shkak se ato mund të ndihmojnë në kapërcimin e hendekut ku marrëdhëniet janë thyer dhe mund të kontribuojnë në udhëtimin për plotësinë dhe mbushullinë e jetës.



Tema e parë është “Farat e mirësisë”. Është e rëndësishme që të kuptojmë se çdo person ka një farë të mbjellë nga Perëndia dhe, për rrjedhojë, bëhet fjalë për një farë të mirë. Shpeshherë ne e mbajmë mendjen te gabimet që bëjnë të tjerët dhe harrojmë të mirat që na janë bërë prej tyre. Ky qëndrim ngre pengesa ndër pjesëtarët e familjes. Në mënyrë që familjet të kenë mbarësi, ne duhet të kërkojmë për të gjetur fara mirësie. Gjetja e farave të mirësisë është pika fillestare e faljes.

Tema e dytë është “Arsye për falënderim”. Ne nuk falënderojmë shpesh. E kemi më për mbarë të gjejmë arsye për t’u ankuar, sesa arsye për të falënderuar. “Festojmë familjen” do të na ndihmojë për të gjetur arsye për të falënderuar atë që na jep jetë.

Tema e tretë është “Hapësirë për dashuri dhe hir”. Si krijojmë ne hapësirë për hir në shtëpitë tona? Si ta krijojmë një hapësirë aq të sigurt sa ç’duhet në mënyrë që familja jonë të hyjë, të jetojë dhe të ketë mbarësi? Perëndia na jep dashuri dhe hir në mënyrë të pakushtëzuar, dhe na fton edhe neve për të bërë të njëjtën gjë ndaj të tjerëve.

Tema e katërt e punës është “Mundësi për falje”. Cilat janë fushat në të cilat kemi nevojë të rritemi? Cilat janë dobësitë tona? Si mund t’i përdorim këto si mundësi për të kërkuar apo për të ofruar falje? Shërimi është një tipar i rëndësishëm i udhëtimit tonë drejt plotësisë së jetës për familjet.

Këto fusha pune diskutohen më tej në modulet dhe sesionet vijuese.

Të trajtosh të shkuarën	Të njohësh të tashmen	Të vizionosh të ardhmen	Të ndjekim ëndrrat tona
Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time (hyrje)	Gëzime dhe dhimbje	Momente përcaktuese	“Të gdhendur në pëllëmbët e duarve të mia”
Ngjarja më e pashlyer për mua nga fëmijëria	Hapësirë për dashuri dhe hir	Ndërtues të mençur	Të flasim bekime
Shenja të plotësisë, Shenja të thyerjes	Arsye për mirënjohje dhe mundësi për të falur	Përcaktimi i hapave tanë	
Fara të mirësisë			

Moduli i parë “Të trajtosh të shkuarën” fillon duke pasur në mendje përfundimin: Cila është shpresa dhe ëndrra që kam për familjen time? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje përcakton drejtimin si dhe kursin e udhëtimit. Përcaktimi i shpresës dhe i ëndrrave tona për familjen tonë është edhe pika e nisjes, edhe pika e përfundimit.

Pjesëmarrësit e kthejnë vështrimin prapa, në të shkuarën e tyre, për të mësuar, për t’u çliruar dhe për të festuar. Mënyra se si na kanë rritur prindërit ka një ndikim të ndjeshëm si në vetëdijen tonë, ashtu edhe në pavetëdijen, te mënyra se si ne rrisim fëmijët tanë. Ka aspekte të së shkuarës sonë të cilat kemi nevojë t’i kremtojmë e t’i marrim me vete në udhëtimin tonë, siç ka edhe aspekte të së shkuarës sonë që na duhet t’i shpengojmë e prej të cilave të çlirohemi. Përndryshe këto pjesë të së shkuarës nuk do të na lejojnë që të shikojmë përpara. Ne duhet t’i lëmë mënjatë gjërat që na pengojnë në udhëtimin tonë të jetës e të mbajmë ato që na japin jetë.

Kupto, vlerëso, identifikoj, merru me dhe kremto janë disa prej fjalëve të fuqishme të përdorura në modulin e dytë: “Të njohim të tashmen”. Pjesa e parë e modulit, “Gëzim dhe dhimbje”, i fton pjesëmarrësit që të shikojnë më thellë e t’i kuptojnë gëzimet dhe dhembjet nga dy pikëpamje: Çfarë shkakton gëzim apo dhimbje ndaj meje si prind dhe çfarë u sjell gëzim apo dhimbje fëmijëve të mi? Kjo pjesë do të shqyrtojë gjithashtu parimet e rëndësishme të identitetit, të roleve dhe të realitetit si dhe shfaqjes së tyre te të tërë pjesëtarët e familjes.

“Hapësirë për dashuri dhe hir” u kujton pjesëmarrësve që t’u ofrojnë pjesëtarëve të familjes së tyre dashurinë dhe hirin që është marrë falas nga Perëndia. Kur marrëdhëniet prishen, është e vështirë që të ofrosh dashuri dhe hir, por duket se pa këto nuk ka mënyrë tjetër shërimi.

Të gjeshtë të gjitha arsyet e mundshme për të falënderuar dhe të shfrytëzosh të tëra mundësitë që të jepen për të kërkuar dhe/ apo dhënë falje siguron një taban për familjet tona që jo vetëm të merren me të tashmen, por gjithashtu të përgatiten për të ardhmen. “Arsye për falënderim dhe mundësi për të falur” i fton pjesëmarrësit që të shqyrtojnë pikat e forta si dhe arsyet për të falënderuar dhe për të marrë në shqyrtim fushat në të cilat ata kanë nevojë të rriten, si mundësi për të kërkuar apo ofruar falje. Të dyja këto praktika u lejojnë familjeve tona shërim dhe rimëkëmbje.

Moduli i tretë, “Te vizionosh të ardhmen”, tregon elementet e ndryshme të nevojshme për t’i bërë shtëpitë tona më të forta dhe më të përgatitura për të ardhmen. Për t’i bërë shtëpitë tona të forta për të ardhmen, na duhet që ta kthejmë vështrimin pas dhe të identifikojmë çfarë i ka bërë familjet tona të jenë këto që janë sot. Ne mund të nxjerrim mësim nga këto përjetime dhe kuptimi më i thellë i tyre, sidomos i atyre faktorëve që na mbajtën lart gjatë vështirësive. Në punë e sipër, pothuajse gjithnjë fillojmë të kuptojmë sovranitetin dhe besnikërinë e Perëndisë. Shikojmë se Perëndia ishte me ne në të shkuarën dhe se do të jetë me ne edhe në brezat që do të vijnë.

Moduli i katërt dhe i fundit, “Të ndjekim ëndrrat tona”, ka të bëjë me besëlidhjen që kemi me Perëndinë dhe kërkimin e bekimit të Tij. Këtu na tregohet për një premtim që Perëndia na ka bërë e që gjendet tek “Isaia” 49:15-16 si dhe një premtim që ne shpallim për familjet dhe shtëpitë tona. Kjo i fton pjesëmarrësit që të shikojnë shembullin e dashurisë së përjetshme të Perëndisë si dhe rrjedhojat që ajo sjell, ndërkohë që vazhdojmë në udhëtimin tonë drejt përjetimit të plotësisë së jetës për familjet tona. Praktika e thënies së bekimeve për familjet tona është kulmimi i workshop-it “Festojmë familjen”. Kjo i fton pjesëmarrësit që të reflektojnë për elementet e “Isaia” 54:2-3, të gjejnë domethënien e atij pasazhi për familjet tona dhe të formojnë deklarata bekimesh rreth këtyre domethënieve. Kjo shërben si një kujtesë e fuqishme jo vetëm e dashurisë së Perëndisë për ne, por edhe e përgjegjësisë sonë të shenjtë përpara Perëndisë për t’i dashur familjet tona e për t’u kujdesur për to.

Festimi i familjeve është i frymëzuar nga Shkrimi. Të gjitha sesionet me radhë përmbajnë veprimtari, hapësirë dhe kohë në dispozicion të pjesëmarrësve, për t’u krijuar atyre mundësinë të reflektojnë dhe të shkruajnë në ditarin e tyre, si dhe për të ndarë njohuri të thella dhe reflektimet e tyre me njëri-tjetrin.

## Shënimet udhëzuese të lehtësuesit

### Përmbajtja e udhëzimeve të sesionit

Në çdo udhëzues sesioni, lehtësuesi do të gjejë:

- kohën e saktë të vlerësuar si të nevojshme për sesionin;
- një përshkrim të shkurtër të sesionit dhe të objektivave të tij;
- udhëzime për veprimtarinë si dhe kohën e vlerësuar të nevojshme për secilën pjesë të sesionit;
- udhëzime për shënimet në ditar;
- shënime për lehtësuesin (siguron udhëzimin dhe gjërat e rëndësishme, me qëllim që lehtësuesi të jetë i vetëdijshëm për to apo t'i ketë parasysh gjatë sesionit);
- një listë me materialet e nevojshme (për t'u përgatitur përpara sesionit, ju lutem shikoni listën e plotë afër fundit të këtij doracak);
- modelet e nevojshme (duhen printuar për pjesëmarrësit përpara sesionit);
- udhëzimin për kryerjen e workshop-it duke mbajtur parasysh tekstet e besimeve të tjera fetare.

### Ditari

Secilit prej pjesëmarrësve duhet t'i sigurohet një ditar, të cilin të mund ta përdorë përgjatë gjithë workshop-it. Ka hapësira të caktuara në fund të çdo sesioni, në të cilat pjesëmarrësit mund të shënojnë. Ditarët kanë për qëllim që të jenë diçka të cilën pjesëmarrësit do ta marrin me vete në shtëpi për ta përdorur personalisht. Pjesëmarrësit duhet të ndihen të lirë për të shkruar, për të vizatuar apo për ta shprehur veten në menyrë vetjake, duke e ditur që shënimet e tyre në ditar nuk do të dorëzohen e as të bëhen publike (po qe se nuk ndodh që pjesëmarrësit vullnetarisht kërkojnë t'u tregojnë të tjerëve për reflektimet e tyre). Pjesëmarrësit kanë për detyrë t'i marrin me vete ditarët në çdo sesion.

### Zhvillimi i trajnimit “Festojmë familjen” duke mbajtur parasysh besimet e tjera fetare

Ky material mund të përdoret në kontekste të larmishme kulturore dhe fetare dhe nuk është planifikuar vetëm për audiencat e krishtera. Sidoqoftë, kur zhvillojmë “Festojmë familjen” me pjesëmarrës nga besime të tjera, është veçanërisht e rëndësishme të komunikojmë që materiali u shkrua nga një këndvështrim i krishterë. Një sesion për “Zhvillimin e trajnimit në kontekstet e besimeve të tjera” jepet në fund të çdo sesioni dhe ofron udhëzime ndaj lehtësuesve si dhe siguron zgjedhje për përshtatjen e materialit, me qëllim që të përshtatet më mirë me audiencën.

### Kontekstualizimi apo përshtatja e sesionit

Materiali mund të duhet të përshtatet sipas rrethanave, me qëllim që t'u shërbejë më mirë disa situatave të caktuara kulturore apo fetare. Për këtë arsye, te shtojca, në fund të materialit, është ofruar modeli i përshtatshmërisë i sesionit, me qëllim që të ndihmojë në mbarëvajtjen e procesit. Ju lutem lini kohë në fund të secilit sesion për të përdorur këtë model.

### Vlerësimi pas përfundimit të trajnimit si dhe modeli i dokumentimit të historisë së ndikimit të tij

Ju lutem siguroni që pjesëmarrësit, menjëherë pas përfundimit, të kenë mundësinë për të plotësuar modelet e vlerësimit pas workshop-it si dhe dokumentimin e historisë së ndikimit të tij (të përfshira në doracak). Në modelin e dokumentimit të historisë së ndikimit ofrohet një hapësirë për të vendosur foton e pjesëmarrësit. Ju lutem bëjini nga një foto dixhitale çdo pjesëmarrësi gjatë trajnimit (sigurisht me lejen paraprake prej tyre) dhe futeni foton dixhitale te modeli bashkë me përgjigjen përkatëse të shtypur në kompjuter. Ju lutem mblidhni dhe hartoni përgjigjet dhe dërgojani Shelly\_ShupeWinterberg@wvi.org Ky informacion rreth workshop-it do të jetë tejet i dobishëm në përpunimin e materialit, si dhe do të na ndihmojë të vlerësojmë efektshmërinë e tij dhe të masim ndikimin e tij.

## Programi orientues për trajnimin “Festojmë familjen”

**Qëllimi:** Pajisja e familjeve në mënyrë që ato të mund të krijojnë një mjedis të sigurt dhe të dashur, në të cilin të zhvillojnë fëmijët si dhe të sigurojnë mirëqenien e tyre.

**Objektivat:** Në fund të trajnimit 4-ditor pjesëmarrësit do të kenë:

- fituar një vlerësim më të thellë të rolit të familjeve në përpjekjen për sigurimin e zhvillimit dhe mirëqenies shpirtërore të fëmijëve;
- zgjeruar këndvështrimin dhe kuptimin e gjendjes dhe rrethanave të familjeve;
- kuptuar strukturën, mënyrat e punës dhe mjetet të cilat mund t'i mbështetin familjet ndërkohë që udhëtojnë së bashku drejt plotësisë;
- identifikuar mënyra të thjeshta për të pajisur, për të mbështetur dhe për të afirmuar familjet.

Ky program orientues kohor është një plan i këshilluar për rrjedhën dhe kohën e sesioneve. Sidoqoftë, disa sesione mund të kërkojnë më shumë apo më pak kohë, në varësi kjo të numrit të pjesëmarrësve, hapësirës për reflektim, pyetjeve etj. Lehtësuesve mund t'u duhet të masin dhe të kontrollojnë, si dhe të bëjnë përshtatjet e nevojshme kur nisin dhe përfundojnë sesionet, në mënyrë që të përshtaten më natyrshëm me kohën e pushimit dhe ngrënies së vakteve.

Koha/Dita	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4
	<b>MËNGJESI</b>	<b>MËNGJESI</b>	<b>MËNGJESI</b>	<b>MËNGJESI</b>
Mëngjesi	<b>Veprimtaritë hapëse</b> Sesioni 1: Mirëpritja dhe caktimi i pritshmërive Vështrim i përgjithshëm <ul style="list-style-type: none"> <li>• Objektivat</li> <li>• Struktura konceptuale</li> <li>• Programi</li> </ul>	Sesioni 5: Farat e mirësisë  <b>Moduli 2: Të kuptojmë të tashmen</b> Sesioni 6: Gëzime dhe dhimbje	<b>Moduli 3: Vizionimi e së ardhmes</b> Sesioni 9: Momente përcaktuese	<b>Moduli 4: Ndjekja e ëndrrave tona</b> Sesioni 12: “Të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të mia”
<b>Mëngjesi</b>	<b>PUSHIM</b>	<b>PUSHIM</b>	<b>PUSHIM</b>	<b>PUSHIM</b>
Mëngjesi	<b>Prezantimi</b> Sesioni 2: Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time	Sesioni 6 (vazhdim): Gëzime dhe dhimbje	Sesioni 10: Ndërtues të mençur	Sesioni 13: Të flasim bekime
	<b>DREKA</b>	<b>DREKA</b>	<b>DREKA</b>	<b>DREKA</b>
Pasdite	<b>Moduli 1: Trajtimi i së shkuarës</b> Sesioni 3: Ngjarja më e pashlyer për mua nga fëmijëria	Sesioni 7: Hapësirë për dashuri dhe hir	Sesioni 11: Përcaktimi i hapave tanë	<b>Plani i zbatimit të mësimin</b> Sesioni 14
<b>Pasdite</b>	<b>PUSHIM</b>	<b>PUSHIM</b>	<b>PUSHIM</b>	<b>PUSHIM</b>
Pasdite	Sesioni 4: Shenja të plotësisë, shenja të thyerjes	Sesioni 8: Arsye për mirënjohje dhe mundësi për të falur	Sesioni 11 (vazhdim): Përcaktimi i hapave tanë	<b>Përmbledhja</b> <b>Integrimi dhe përmbyllja</b>
Mbrëmje	Përmbledhje / Përfundimi i ditës	Përmbledhje / Përfundimi i ditës	Përmbledhje / Përfundimi i ditës	Sesioni 15
	<b>DARKA</b>	<b>DARKA</b>	<b>DARKA</b>	<b>DARKA</b>

*Shënim. Koha për reflektime bazuar te Shkrimi është e integruar brenda sesioneve.*

**Veprimtaritë hapëse**

Mirëpritja dhe caktimi i pritshmërive: Sesioni I

**Sesioni I: Mirëseardhja dhe caktimi i pritshmërive**

Veprimtaria hapëse në këtë sesion të parë u mundëson pjesëmarrësve të njohin njëri - tjetrin si dhe të ndajnë pritshmëritë që kanë për trajnimin. Lehtësuesi e përdor këtë kohë për të diskutuar objektivat e trajnimit dhe për t'u dhënë pjesëmarrësve një pasqyrë të përgjithshme të ndërtimit të modulit "Festojmë familjen".

**Koha totale e sesionit**

75 minuta

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- thënë se çfarë presin në tre fushat e workshop-it: përmbajtja, metodologjia e trajnimit si dhe mësimi nga pjesëmarrësit e tjerë;
- arritur të kuptojnë mirë strukturën, objektivat dhe rrjedhën e konceptimit të trajnimit "Festojmë familjen".

**Mirëseardhja**

Sesioni fillon me mirëseardhjen dhe paraqitjen e pjesëmarrësve, duke i ndihmuar ata që të mësojnë diçka rreth njëri - tjetrit.

- Kërkoji secilit pjesëmarrës që të thotë emrin e tij/e saj dhe të përshkruajë shkurtimisht gjërat kryesore rreth familjes së tij apo të saj. Për shembull: "Më quajnë Edmond. Familja ime pëlqen shumë muzikën. Të tërëve në shtëpi na pëlqen të këndojmë".

**Koha**

15 minuta

**Veprimtaria I: Caktimi i pritshmërive**

Kjo veprimtaria identifikon dhe diskuton atë që pjesëmarrësit presin nga trajnimi. Drejto mbarëvajtjen e kësaj veprimtarie duke përdorur procesin e mëposhtëm:

- Përpara fillimit të trajnimit, përgatit tre tabakë letre, duke i vënë secilit prej tyre një titull të veçantë: PËRMBAJTJA, METODOLOGJIA dhe PJESEMARRËSIT E TJERË.
- Afishoj tre tabakët e letrës në sallën e sesionit dhe ndaj pjesëmarrësit në tri grupe.
- Secilit grup jepi një lapustil (me ngjyrë të ndryshme për secilin grup) dhe kërkoju pjesëtarëve të grupit që të qëndrojnë pranë tabakut të letrës që u është caktuar. Grupi i parë qëndron pranë tabakut me titull PËRMBAJTJA; grupi i dytë qëndron pranë tabakut me titull METODOLOGJIA dhe grupi i tretë qëndron pranë tabakut me titull PJESEMARRËSIT E TJERË.
- Udhëzo pjesëmarrësit të shkruajnë çka presin nga trajnimi nën kategorinë që u është caktuar. Në përfundim të kohës, kërkoji secilit grup të kalojë te tabaku tjetër i letrës dhe të shkruajë pritshmëritë që kanë, duke përdorur lapustilin e tyre me ngjyrë. Nëse disa prej pritshmërive të tyre janë të shkruara tashmë aty, ato thjesht duhet të bëjnë një shenjë përbri saj për ta theksuar. Pasi të kenë mbaruar me të tre tabakët, pjesëmarrësit kthehen nëpër vende.
- Lexo listën me zë të lartë, duke ofruar komente apo sqarime, dhe pastaj trego nëse pritshmëritë e renditura do të plotësohen në këtë trajnim. Nëse ka pjesëmarrës që janë të shqetësuar për gjëra të cilat nuk dëshirojnë t'i ndajnë me të gjithë grupin, atëherë ftoj gjatë pushimit të mëngjesit që t'ju tregojnë shqetësimin e tyre. Trego udhëzimet për trajnimin "Rregullat shtesë të veprimtarisë", nëse këto nuk janë vënë ende gjatë kohës së përcaktimit të pritshmërive të pjesëmarrësve. Nëse është bërë e qartë se nevojiten udhëzues të tjerë shtesë gjatë zhvillimit të ushtrimit, tani është koha e përshtatshme për sqarimin e tyre.

**Koha**

15 minuta





## Veprimtari hapëse Mirëpritja dhe caktimi i pritshmërive: Sesioni I




### Veprimtaria 2: Tabloja e përgjithshme


- Pasi ke dëgjuar pritshmëritë e pjesëmarrësve, bëj një përmbledhje të objektivave të workshop-it. Përdor faqet që keni marrë nga prezantimi në PowerPoint (një shembull i tyre është më poshtë), për të treguar programin mësimor të workshop-it dhe që të shërbejnë si mjete për diskutim. Ftoj pjesëmarrësit që pas çdo faqe t'i ndajnë pyetjet e tyre me të tjerët, së bashku me kërkesat për sqarim.
- Historiku: Si lindi ky program mësimor? Kur një djalosh në shtetin afrikan të Malit u pyet se si e kuptonte “mirëqenien”, përgjigja e dhënë prej tij i mbeti në mendje pjesëtarit të stafit që kishte bërë pyetjen. Djaloshi tha: Të lutem, a mund t'u thuash prindërve tanë që të na kenë sërish për zemër? Nga kjo kërkesë e thjeshtë dhe njëherësh e thellë mori udhë një projekt për të dëgjuar fëmijët, të cilët vijnë nga grupe shoqërore të ndryshme, e që ka për qëllim t'i ndihmojë prindërit e tyre që të lidhen me ta në një mjedis të dashur e përkujdesës, i cili do të siguronte një kontekst ushqyes të zhvillimit shpirtëror të tyre.
- Drejtoji pjesëmarrësit në një vështrim të përgjithshëm të strukturës së konceptimit të programit mësimor, duke përdorur faqet e dhëna në prezantimin e PowerPoint-it. (Në vijim, pamje ilustruese të faqeve të prezantimit.)



- Bëj një përshkrim të shkurtër të secilit prej katër moduleve të programin mësimor “Festojmë familjen” si dhe një prezantim të shkurtër të sesioneve që gjenden në secilin prej moduleve. (Në vijim, pamje të faqeve të prezantimit.)



- Pas dhënies së një tabloje të përgjithshme të sesioneve, njihi pjesëmarrësit me programin e të tërë workshop-it (Referoju programit të paraqitur përpara këtij sesioni.)



**Koha**  
45 minuta



## **Veprimtari hapëse** Mirëseardhja dhe caktimi i pritshmërive: Sesioni I



### **Shënime për lehtësuesin**

Gjatë përmbledhjeve të sesioneve, ftoji pjesëmarrësit që të bëjnë pyetje. Ky sesion ka një përmbajtje të gjatë dhe programi është krijuar me një veçori elastike, në mënyrë që t'u mundësojë pjesëmarrësve të ngrenë pyetje e të fitojë një dallueshmëri më të madhe rreth sfondit dhe konceptit të tij.



### **Materialet e nevojshme**

- Projektor LCD
- faqet nga prezantimi i PowerPoint-it të “Festojmë familjen” (të siguruara bashkë me doracakun)
- Tabakë letre
- Lapustilë me ngjyra të ndryshme
- Letër ngjitëse/materiale ngjitëse
- Referenca: Programi orientues për workshop-in “Festojmë familjen” (faqe 6)

## Hyrje Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time: Sesioni 2



### Sesioni 2: Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time

Sesioni 2 është fillimi i workshop-it dhe pjesëmarrësit përkushtohen në udhëtimet që familjet e tyre kanë ndërmarrë. Kjo i bën ata të aftë që të flasin për shpresat dhe ëndrrat që kanë për familjet e tyre. Me këtë njohuri, që shërben për t'i udhëzuar dhe për t'i frymëzuar ata, pjesëmarrësit mund të ndërmarrin hapa konkretë së bashku me familjet e tyre, për të realizuar shpresat dhe ëndrrat e tyre.

**Totali i kohës së sesionit**

70 minuta



### Objektivat

Në fund të sesionit, pjesëmarrësi do të kenë:

- menduar për udhëtimin e familjeve të tyre deri më tani si dhe do të kenë kuptuar shpresat dhe ëndrrat që kanë për familjet e tyre.



### Hyrje

Si lehtësues:

- Projekto në ekran një kornizë fotografie.
- Pyet: **“Çfarë shikoni në pamjen e shfaqur në ekran?”**
- Jep shembuj se si ne përpiqemi të dukemi sa më mirë që të mundemi nëpër fotografi: të veshim rrobat tona më të mira, të buzëqeshim apo të mbajmë pozicionin tonë më të mirë trupor.
- Pyet: **“Çfarë mënyrash të tjera përdorim për të dalë sa më mirë në një fotografi? Po familja jonë? Po sikur për çdo çast të jetës tonë të ekzistonte një fotografi? A jemi gjatë gjithë kohës në më të mirën që mund të japim për familjen tonë?”**
- Thuaj: **“Tani do të reflektojmë dhe do të ëndërrojmë së bashku. Pyete veten se cila fotografi do të tregonte shpresën dhe ëndrrën tënde për familjen tënde.”**

**Koha**

10 minuta



### Veprimtari: Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time

- Ndaj pjesëmarrësit në grupe të vogla (po të jetë e mundur, 5-7 pjesëtarë për çdo grup).
- Secilit pjesëmarrës jepi një kopje të kornizës së fotos nga “Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time”.
- Shpërnda lapustilë dhe kërkoju pjesëmarrësve të bëjnë një vizatim që përfaqëson shpresën dhe ëndrrën që ata kanë për familjen e tyre.
- Sapo të gjithë pjesëmarrësit të kenë përfunduar vizatimet e tyre, kërko që t'i ndajnë ato me të tjerët e më pas t'i shpjegojnë në grupet e vogla ku bëjnë pjesë. Kërkoju grupeve të vogla të identifikojnë idetë e përbashkëta në vizatimet e bëra.
- Pasi të tëra grupet të kenë përfunduar tregimet e tyre, bashkujini ato në një grup të vetëm. Kërkoni që nga secili prej grupeve të mëparshme të dalë një përfaqësues, i cili të bëjë një përmbledhje të asaj që grupi i tij/i saj zbuloi.
- Ftoj pjesëmarrësit që kornizat e tyre t'i varin në mur. (Mbajti të varura në mur gjatë gjithë punimit: sesionet e tjera do t'u referohen atyre.)



Bëj një vizatim të shpresës dhe ëndrrës që ke për familjen tënde.



Përshkruaja pikturën tënde të tjerëve në grup

**Koha**

45 minuta



**Prezantim** Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time: Sesioni 2**Reflektim**

Pyeti pjesëmarrësit:

- **Ndërkohë që mendonit dhe vizatonit shpresën dhe ëndrrën që keni për familjen tuaj, a ju erdhi në mendje ndonjë gjë e re? Çfarë idesh ju lindën?**

**Koha**  
5 minuta**Shënime në ditar**

Jepi secilit pjesëmarrës nga një ditar. Kërkoju që të shkruajnë emrin në kapak të ditarit. Pastaj kërkoju që të hapin ditarët dhe të lënë aty shënimin e tyre të parë.

- Thuaj: **Shkruaj një lutje apo një deklaratë kushtimi, në të cilën të shprehësh shpresat dhe ëndrrat që ke për familjen tënde.**

**Koha**  
10 minuta**Shënime për lehtësuesin**


- Jepu pjesëmarrësve kohën e përshtatshme për të ndarë pikturat me grupet e tyre të vogla.
- Nxit respekt për shpresat dhe ëndrrat e njëri - tjetrit.
- Nxiti pjesëmarrësit që të mendojnë se si shpresat, ashtu edhe ëndrrat e njerëzve të tjerë mund të gjejnë zbatim te familja e tyre.
- Krijoi një atmosferë mbështetjeje dhe nxitjeje të ndërsjellë.
- Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë të shtojca.

**Zhvillimi i workshop-it në kontekste besimesh të tjera**

Mos harro të respektosh njerëzit që vijnë nga kultura apo fe të tjera, të cilat nuk lejojnë ilustrimet me imazhe. Pjesëmarrësve, të cilët nuk ndihen rehat me vizatimet, mund t'u jepen mundësi të tjera për të lehtësuar tregimin e historisë së shpresave dhe ëndrrave që ata kanë për familjet e tyre. Për shembull, ata mund të zgjedhin një fjalë të shkruar apo një objekt për të simbolizuar shpresat dhe ëndrrat e tyre.

**Materialet e nevojshme**

- Projektor LCD
- Letër e bardhë dhe lapustila me ngjyra të ndryshme, bojëra dhjami dhe lapsa
- Tabakë letre dhe letër ngjitëse (apo një mur të përshtatshëm për përdorimin e spërkatësit ngjitës)
- Një ditar për secilin pjesëmarrës (sapo ditarët të shpërndahen, pjesëmarrësit kanë përgjegjësinë ta marrin me vete ditarin e tyre në çdo sesion)
- Kopje të kornizës së fotografisë të etiketuar “Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time” (modeli është dhënë në faqen tjetër) – nga një kopje për secilin pjesëmarrës



Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time




# Moduli I


## *Trajtimi i së shkuarës*

“Trajtimi i së shkuarës” fillon duke pasur në mendje përfundimin: Cila është shpresa dhe ëndrra që kam për familjen time? Përgjigjja ndaj kësaj pyetje cakton drejtimin dhe shtegun e udhëtimit. Përcaktimi i shpresës dhe i ëndrrave tona për familjen tonë është edhe pika e nisjes, edhe pika e përfundimit.

Pjesëmarrësit kthejnë vështrimin prapa në të shkuarën e tyre për të mësuar, për të shpenguar (për të çliruar) dhe për të festuar. Mënyra se si prindërit na kanë rritur ka një ndikim të ndjeshëm qoftë në vetëdijen, qoftë në pavetëdijen tonë, për mënyrën se si ne rrisim fëmijët tanë. Ka aspekte të së shkuarës sonë të cilat kemi nevojë t'i kremtojmë e t'i marrim me vete në udhëtimin tonë, siç ka edhe tipare të së shkuarës sonë prej të cilave na duhet të çlirohemi e të shërohemi; përndryshe, këto pjesë të së shkuarës nuk do të na lejojnë që të shikojmë përpara. Ne duhet t'i lëmë mënjane gjërat të cilat na pengojnë në udhëtimin tonë të jetës dhe të mbajmë ato gjëra që na japin jetë.

Kthimi në të shkuarën mund të sjellë si kujtime të këndshme, ashtu edhe të dhimbshme – shenja të plotësisë dhe shenja të thyerjes. Të dyja këto janë të pranishme në shtëpi. Pavarësisht faktit që ne parapëlqejmë vetëm faktorë plotësimi, ajo që do të zbulojmë nga Shkrimi si dhe nga situatat tona reale të jetës është se të dy këta faktorë janë në veprim. Atëherë, si të merremi me këtë realitet? Kështu, një nga mënyrat është të gjejmë farat e mirësisë në shtëpitë dhe në familjet tona. Historia e “djalit plangprishës” na jep një mësim të rëndësishëm që na tregon se po të përpiqemi fort, atëherë do të mund të gjejmë fara mirësie te të tjerët. Do të habitemi edhe vetë që në rrugë e sipër do të mund të gjejmë gjithashtu farën e Perëndisë te çdo person.





Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time

**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesiioni 3**Sesiioni 3: Përvoja më e paharruar nga fëmijëria ime**

Ky sesion i ndihmon pjesëmarrësit që të reflektojnë për jetën me prindërit e tyre kur ishin të vegjël. Përjetimet e tyre, që ata kujtojnë, qofshin të trishtueshme, qofshin të lumtura, kanë pasur një ndikim të paharruar në jetën e tyre. Pjesëmarrësit do të bëjnë një vizatim për të treguar me anë të tij përvojën më të paharruar të fëmijërisë në lidhje me prindërit e tyre. Nga vetë reflektimet e tyre, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të përshkruajnë se si (nga shumë anë) përvojat e së shkuarës kanë një ndikim tek e tashmja.

**Koha totale e sesionit**

90 minuta

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- menduar thellë për të shkuarën e tyre dhe për mënyrën se si ajo ka ndikuar pashlyeshmërisht në jetën e tyre;
- kuptuar mënyrën se si përvojat e tyre kanë ndikuar te zakonet se si ata rrisin fëmijët e tyre apo i trajtojnë pjesëtarët e familjes.

**Prezantim**

Prezanto sesionin duke paraqitur këto pika:

- Është e rëndësishme që të marrim kohë për të reflektuar rreth së shkuarës sonë, për shkak se ajo ka ndikim tek e tashmja – mënyra se si ne i rritim fëmijët tanë, si i trajtojmë pjesëtarët e familjes sonë, si i bëjmë zgjedhjet tona dhe si i marrim vendimet tona, madje dhe te qëndrimet dhe pikëpamjet tona ndaj jetës.
- Disa prej këtyre përvojave mund të jenë të këndshme dhe të gëzueshme, ndërkohë që të tjera mund të jenë të trishtueshme dhe të vështira. Megjithëkëtë, këto përvoja kanë ndihmuar që ne të formohemi në çka jemi tani, si dhe kanë formuar atë që ne dëshirojmë në jetë.
- Kuptimi dhe vlerësimi i së shkuarës sonë përgatit terrenin që ne të fillojmë reflektimin tonë për udhëtimin e familjes.

**Koha**

5 minuta

**Veprimtari: Përvoja ime më e paharruar nga fëmijëria**

- Ndaji pjesëmarrësit në grupe më të vogla (nëse është e mundur, pesë deri shtatë pjesëtarë për çdo grup).
- Jepi secilit pjesëmarrës nga një fletë të bardhë letre, një laps dhe bojëra dhjami.
- Kërkoju pjesëmarrësve që të vizatojnë një figurë të përvojave më të paharruara të fëmijërisë me prindërit e tyre.
- Pasi pjesëmarrësit t'i kenë përfunduar vizatimet e tyre, kërkoju që t'ia tregojnë grupit të tyre të vogël.
- Pasi të tëra grupet të kenë përfunduar diskutimet e tyre, kërko që një përfaqësues nga secili grup të bëjë përmbledhjen e përvojave të tyre përpara të gjithëve.
- Ftoj pjesëmarrësit që të varin vizatimet e tyre në mur.



Pjesëmarrësit vizatojnë përvojat e tyre më të pashlyeshme.



Pjesëmarrësit diskutojnë me njëri - tjetrin rreth vizatimeve të tyre.

**Koha**

45 minuta





**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesiioni 3**Persiatje**

Në një diskutim të të gjithë grupit, shtro pyetjet vijuese:

- **Si kanë ndikuar përvojat e së shkuarës në jetën tuaj?**
- **Si kanë ndikuar përvojat e së shkuarës te mënyra se si jeni duke rritur fëmijët tuaj dhe se si e trajtoni familjen?**

Pastaj përmbliidhni reflektimet e pjesëmarrësve.

**Koha**

15 minuta

**Mesazhe kyçe**

Trego pika të rëndësishme të lidhura me të qenurit tonë të vetëdijshëm rreth së shkuarës sonë:

- • Na ndihmon të bëjmë zgjedhje të shëndetshme.
- • Na jep mundësinë të mbështetemi te gjëra të cilat kanë pasur një ndikim të mirë te ne.
- • Na bën të aftë që të njohim e të trajtojmë kujtimet e trishtueshme apo të vështira me të cilat jemi shkëputur.
- • Është një pikënisje drejt shërimit dhe faljes, që mund të çojë në më shumë marrëdhënie të mira në shtëpitë tona si dhe ndër familjet tona.

**Koha**

15 minuta

**Shënimi në ditar dhe përmbyllja**

Përmblye sesionin duke u kërkuar pjesëmarrësve që në ditarin e tyre t'u përgjigjen fjalive të mëposhtme:

- **Shkruaj një deklaratë /dedikim apo një lutje falënderimi.**
- **Shkruaj një deklaratë apo një lutje në të cilën ti lësh pas kujtimet e vështira apo të trishtueshme.**

**Koha**

10 minuta

**Shënime për lehtësuesin**

- Thekso nevojën për ndershmëri, respekt për të tjerët si dhe mirëbesim.
- Përgatitu të trajtosh gjendje të ndryshme ndjesore, pasi disa pjesëmarrës mund të kujtojnë e të tregojnë përvoja të vështira apo të trishtueshme. Prania e një psikologu në këtë sesion mund të ndihmonte në rast se dikush përballon një situatë të vështirë emocionale.
- Mos i bëj presion askujt që të tregojë kujtimet e tij/e saj.
- Kalo nga grupi në grup, gjatë diskutimeve në grupe të vogla, për të ofruar mbështetje të mëtijshme nëse është e nevojshme.
- Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që gjendet te shtojca.

**Kryerja e workshop-it në kontekste të tjera besimi**

Mos harro të respektosh njerëzit që vijnë nga kultura apo fe të tjera, të cilat nuk i lejojnë ilustrimet me imazhe. Pjesëmarrësve që nuk ndihen rehat me vizatime, mund t'u jepen mundësi të tjera, si, për shembull, një fjalë e shkruar apo një objekt për të simbolizuar kujtimet e tyre. Ky sesion mund të bëhet dhe ne grupe të ndara gjinore duke mbajtur parasysh sidomos kulturën e fshatit. Ndoshta sesioni mund të drejtohet nga dy ndihmues nga të dyja gjinitë për të krijuar një ambient ku mund të shprehen lirshëm.

**Materialet e nevojshme**


- Lapsa dhe bojëra dhjami apo lapustilë
- Letër e bardhë (të paktën një fletë për çdo pjesëmarrës)
- Letër ngjitëse apo materiale të tjera ngjitëse
- Ditarët e pjesëmarrësve

**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesion 4**Sesioni 4: Shenja të plotësisë, shenja të thyerjes**

Ky sesion i ndihmon pjesëmarrësit që të kuptojnë dhe të shikojnë se asnjë person nuk është rritur në një familje të përsosur. Çdo familje kalon nëpër kohë të mira dhe të këqija. Pjesëmarrësit e kthejnë vështrimin prapa për të identifikuar shenja të plotësisë dhe shenja të thyerjes në familjet e tyre kur ishin të vegjël. Pjesëmarrësit udhëzohen gjithashtu që të shqyrtojnë Shkrimet, me qëllim që të gjejnë atje përvoja si të tyre.

**Koha totale e sesionit**

85 minuta

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- gjetur shenja të plotësisë dhe shenja të thyerjeve në familjet e tyre gjatë kohës kur kanë qenë të vegjël;
- identifikuar pika lidhëse si dhe marrëdhënie mes historive dhe shembujve nga Shkrimet;
- nxjerrë mësim dhe zbatime praktike nga reflektimet e tyre.

**Prezantim**

Prezanto sesionin, duke treguar këto pika:

- Një pjesë kyçe në trajtimin e së shkuarës sonë është të kuptojmë se në familjen tonë ka pasur edhe momente të lumtura, edhe momente të trishtuara.
- Çdo familje kalon nëpër kohë në të cilat ndihet e bekuar dhe e plotë, por edhe në kohë kur ndihet në dhimbje dhe trishtim.
- Si përvojat pozitive, ashtu edhe ato negative kontribuojnë në udhëtimin e familjes dhe në kujtimet që ajo lë në rrugë e sipër.
- Si përvojat pozitive, ashtu edhe ato negative kontribuojnë në udhëtimin e familjes si dhe mësimet që ajo nxjerr nga përjetimet e saj.
- Kaloni pesë minuta duke menduar rreth kuptimeve të fjalëve vijuese. Çfarë kuptojmë me fjalët vijuese:
  - shenjë;
  - thyerje;
  - plotësim;

(Shfaq faqen në prezantimin e power point-it korrespondues për secilën fjalë.)

**Koha**

10 minuta

**Veprimtaria I: Shqyrtimi i Shkrimit /Citateve të Shenjta**

- Ndaji pjesëmarrësit në grupe të vogla (po të jetë e mundur, pesë deri shtatë pjesëtarë në secilin grup).
- Jepi secilit grup një tabak letre, që të shkruajë në të përgjigjet e veta.
- Gjatë shqyrtimit të Shkrimeve, jepi përgjigje çështjeve vijuese:
  - - Rendit tre histori apo shembuj në Shkrimet apo librat e tu të shenjtë, apo histori nga trashëgimia kuturore e kontekstit tuaj që tregojnë për thyerje në familje.
  - - Rendit tre histori apo shembuj në Shkrimet apo librat e tu të shenjtë, apo histori nga trashëgimia kuturore e kontekstit tuaj që të ilustrojnë plotësinë në familje.
- Pasi të tëra grupet të kenë përfunduar listat e tyre, kërkoju përfaqësuesve të secilit grup që listën e tyre t'ia tregojnë të gjithë grupit.

**Koha**

30 minuta



**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesi 4**Veprimtaria 2: Shenja të plotësisë, shenja të thyerjes**

- Jepi secilit pjesëmarrës një letër shënimesh blu dhe një të verdhë.
- Kërkoji çdo pjesëmarrësi që t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:
  - **Tani që kthej vështrimin nga fëmijëria ime, cilat ishin disa shenja të plotësisë në shtëpinë time?** (Përgjigjet shkruaji në fletën e verdhë.)
  - **Cilat ishin shenjat e thyerjeve në shtëpinë time?** (Përgjigjet shkruaji në fletën blu.)
- Ftoj pjesëmarrësit që përgjigjet e tyre t'i afishojnë në një tabak letre të etiketuar “Shenja të plotësisë” dhe “Shenja të thyerjes”, siç tregohet më poshtë:

Shenja të plotësisë	Shenja të thyerjes



Pjesëmarrësit identifikojnë temat e zakonshme përbrenda shenjave të thyerjeve.

- Sapo të gjithë pjesëmarrësit, të cilët zgjodhën ta bënin këtë gjë, t'i afishojnë përgjigjet e tyre në tabakun e letrës, ftoj ata që të identifikojnë temat e përbashkëta.
- Kërkoji pjesëmarrësve që të krijojnë lidhje mes përvojave të tyre si dhe historive që kanë treguar nga Bibla apo librat e tyre të shenjtë.
- Kërkoji pjesëmarrësve që të krijojnë lidhje mes këtyre shenjave dhe përgjigjeve të tyre te “Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time”.

**Koha**  
30 minuta

**Mesazhet kyçe**

Bëj një përmblendje të pikave kyçe të bëra në reflektimet e pjesëmarrësve. Sigurohu që të shtosh mesazhet vijuese, nëse nuk janë përmendur nga ndokush:

- Çdo familje ka sfidat e saj. Është e rëndësishme që të kuptojmë se do të ketë gjithnjë përvoja pozitive dhe negative në familjet tona.
- Familjet përjetojnë si kohë plotësie, ashtu edhe kohë thyerjesh.
- Ne dëshirojmë t'i rrallojmë periudhat e thyerjeve dhe të shtojmë periudhat e plotësisë ndërkohë që udhëtojmë së bashku si familje.
- Ne dëshirojmë të ç'mësojmë praktikatat dhe traditat jo të shëndetshme, në mënyrë që të mund të krijojmë një mjedis të sigurt, përkujdesës dhe ushqyes në shtëpitë tona.

**Koha**  
10 minuta



**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesioni 4**Shënim në ditar dhe përfundimi**

Kërkoju pjesëmarrësve që t'u përgjigjen pyetjeve vijuese në ditarët e tyre:

- **Cilat janë disa fusha apo përvoja që mund t'i festoj?**
- **Cilat janë disa fusha apo përvoja që mund t'i shpengoj (të çlirohem)?**

**Koha**  
5 minuta

**Shënime për lehtësuesin**

Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohë për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që gjendet te shtojca.

**Zhvillimi i workshop-it në kontekstet e besimeve të tjera fetare**

Ftoj pjesëmarrësit nga besimet e tjera fetare që të përdorin librat e tyre të shenjtë kur kërkojnë për histori, të cilat kanë lidhje me thyerje dhe plotësi të familjeve.

**Materialet e nevojshme**

- Bibla dhe/ose libra të shenjtë
- Një tabak letre me dy kolona të etiketuara “Shenja plotësimi” dhe “Shenja thyerjesh”
- Një fletë shënimesh blu dhe një e verdhë (apo me dy ngjyra të tjera) për çdo pjesëmarrës
- Lapustila dhe lapsa
- Letër ngjitëse
- Ditarët e pjesëmarrësve

**Module I** Trajtimi i së shkuarës: Sesioni 5**Sesioni 5: Farat e mirësisë**

Sesioni “Farat e mirësisë” i ndihmon pjesëmarrësit të kuptojnë se çdo person ka brenda vetes fara mirësie. Pjesëmarrësit ftohen të shikojnë përtej të metave në familjet e tyre dhe të gjejnë farat e mirësisë përbrenda secilit pjesëtar të saj. Ky sesion thekson faktin që falja fillon kur ne kuptojmë se çdo person ka cilësinë e mirësisë së dhënë nga Perëndia. Duke përdorur pasazhin nga Bibla të “Luka” 15:11–32 (historia e “djalit plëngprishës”), pjesëmarrësit inkurajohen të kërkojnë cilësitë e mira të tre personazheve kryesorë të historisë: babai, djali më i madh dhe djali më i vogël. Nga fundi i sesionit, pjesëmarrësit drejtohen për të përcaktuar “gjuhët e dashurisë” së tyre (mënyrat se si ne shprehim dashurinë tonë) – një aspekt tjetër kyç i gjetjes së farave të mirësisë të pjesëtarët e familjes sonë, dhe krijimi i marrëdhënieve më të mira në shtëpi.

**Koha totale e sesionit**

75 minuta

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit:

- do të kenë reflektuar rreth parimeve të identifikuar për dallimin e farave të mirësisë të të tjerët, bazuar të “Luka” 15:11–32;
- do të bëhen të vetëdijshëm për gjuhët e dashurisë si dhe ndikimit të tyre të marrëdhëniet përbrenda familjeve;
- do të identifikojnë mënyra për të zbatuar mësimet e tyre.

**Prezantim**

Prezantoje sesionin duke kaluar nëpër çështjet e mëposhtme:

- Çfarë është e lehtë për t’u gjetur dhe e vështirë për t’u harruar? (një gabim)
- Çfarë është e vështirë për t’u gjetur dhe e lehtë për t’u harruar? (një vepër e mirë)
- Nganjëherë është e vështirë për ne që të gjejmë fara të mirësisë të pjesëtarët e familjes sonë, për shkak të rasteve që ata na kanë lënduar apo gabimeve që ata kanë bërë.
- Është e vështirë të falësh dhe të lëmë të kalojmë lëndimet tona, kështu që kjo gjë i tensionon marrëdhëniet tona.
- Një nga mënyrat se si ne mund të mësojmë të falim dhe t’i lëmë gjërat që të kalojnë, është të përpiqemi të gjejmë fara mirësie tek ata që kemi përreth, veçanërisht të pjesëtarët e familjes sonë.
- Gjetja e farave të mirësisë është pika e fillimit për kërkimin dhe ofrimin e faljes. Falja i ndihmon familjet tona të shërohen e të kenë marrëdhënie më të mira.
- Nga t’ia nisim? Me qëllim që të gjejmë fara mirësie, veçanërisht të njerëzit të cilët na kanë lënduar, ne do të shqyrtojmë Shkrimet dhe do të përdorim historinë e “djalit plëngprishës”.

**Koha**

5 minuta



**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesi 5**Veprimtaria I: Reflektim për “Lukën” 15:11–32**

- Ndaji pjesëmarrësit në tri grupe.
- Ftoj pjesëmarrësit që të hapin doracakët e tyre të historia e “djalit plëngprishës”. Caktoji secilit grup një prej personazheve kryesore të historisë: babanë, djalin e madh apo djalin e vogël.
- Kërkoji çdo grupi që të reagojë (duke u përqendruar në personazhin që i është ngarkuar). Rendit 10 cilësi të mira të ... (babait, djalit të madh, djalit të vogël).
- Kërkoji çdonjërit prej grupeve që të shkruajë listën e vet në tabakun e letrës.
- Pasi të tëra grupet të kenë përfunduar listat e tyre, kërkoji një përfaqësuesi nga secili grup të ndajë me tërë pjesëmarrësit listën e grupit të tij.
- Pasi të tëra grupet të kenë folur, pyeti pjesëmarrësit:
  - **Çfarë mendoni për këtë ushtrim?**
  - **Çfarë mësuat?**
  - **Si mund ta zbatoni atë që keni mësuar në familjen tuaj?**
- Pasuroje këtë reflektim duke ritheksuar rëndësinë e gjetjes së farave të mira të secili person, por gjithashtu duke kuptuar që çdo person ka një “farë të Perëndisë” përbrenda, dhe kjo për shkak se çdo person është krijuar në shëmbëlltërinë e Perëndisë dhe në ngjasim me Të.
- Na duhet të gjejmë dhe të ndreqim gabime, paçka se mund të mos jemi në gjendje që të fshijmë dhimbjen dhe kujtimet e këqija. Gjithsesi, ende na duhet të përpiqemi të gjejmë fara të mirësisë të të tjerët, për hir të shërimit tonë si dhe për hir të shërimit të familjeve tona. Kjo është pikënisja e udhëimit tonë drejt shërimit dhe rimëkëmbjes.

**Koha**  
45 minuta**Shënim në ditar**

Ftoj pjesëmarrësit që t'u përgjigjen në ditarët e tyre pikave të mëposhtme:

- **Mendoni për një person në familjen tuaj, të cilit nuk e keni të lehtë për t'ia gjetur gjuhën.**
- **Rendit të paktën pesë cilësi të mira (fara mirësie) që mund të identifikoni tek ai person.**




**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesioni 5**Trajtimi i së shkuarës: Sesioni 5**

- Prezanto një diskutim për gjuhët e dashurisë, duke deklaruar si më poshtë:
  - Dr. Geri Çepmën (Gary Chapman), i cili shkroi “Pesë gjuhët e dashurisë”, studioi marrëdhëniet. Ai zbuloi se ka pesë mënyra kryesore përmes të cilave ne shprehim dashurinë tonë – “pesë gjuhët tona të dashurisë”.
  - Çepmëni thotë se po të njohësh gjuhën dominuese (më të rëndësishmen) të dashurisë së njerëzve të tu të dashur, kjo do të të ndihmonte të krijoje marrëdhënie më të mira me ta.
- Pas prezantimit, kërkoji secilit pjesëmarrës t’i përgjigjet kësaj pyetjeje: **“Si e shpreh dashurinë tënde ndaj të tjerëve?”**
- Pasi të gjithë pjesëmarrësit të jenë shprehur, kërkoji t’i japin përgjigje një pyetjeje tjetër: **“Si dëshiron të marrësh dashuri nga të tjerët?”**
- Pyeti pjesëmarrësit për atë çka kanë mësuar nga ky ushtrim.
- Pasuroje edhe më tej diskutimin, duke ndarë pikat vijuese:
  - Nganjëherë mendojmë se nuk na tregohet dashuri dhe si rrjedhim edhe ne e fenojmë dashurinë tonë. Ne nuk e kuptojmë se ka mënyra të ndryshme për të shprehur dashuri.
  - Njohja e gjuhës së dashurisë të pjesëtarëve të familjes sonë na ndihmon t’i kuptojmë ata më mirë si dhe t’u tregojmë dashurinë tonë në gjuhën e dashurisë që ata kuptojmë më mirë.
  - Tani ne jemi të vetëdijshëm për gjuhën tonë të preferuar të dashurisë.

**Koha**  
20 minuta**Përmbledhje dhe përmbyllje**

Përmbyle sesionin duke i inkurajuar pjesëmarrësit që të gjejnë gjuhët e dashurisë së pjesëtarëve të familjes të tyre

**Koha**  
5 minuta**Shënime për lehtësuesin**

Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që keni te shtojca.

**Zhvillimi i trajnimit në kontekste besimesh të tjera fetare**

Në rastet e pjesëmarrjes së njerëzve nga tradita të tjera fetare, trego se të gjithë mund të mësojnë nga kjo histori. Ftoji ata të ndajnë me grupin, nga tradita e tyre fetare, histori të ngjashme që pasqyrojnë këtë parim (një histori familjare me elemente faljeje si dhe kërkimit të cilësive të mira të pjesëtarët e familjes apo te të tjerët).

**Materialet e nevojshme**

- Tri tabakë letre
- Lapustilë dhe lapsa
- Ditarët e pjesëmarrësve
- Reflektim rreth Shkrimit për “Luka” 15:11–32 (në faqen vijuese)
- Shpjegimi i gjuhëve të dashurisë (në faqen 23)

**Moduli I** Trajtimi i së shkuarës: Sesioni 5**Reflektim për Shkrimin: “Luka” 15:11–32****Shëmbëlltyra e “plëngprishësit” dhe e vëllait të tij****“Luka” 15:11–32**

Jezusi tha: “Një njeri kishte dy bij. Më i riu i tyre i tha babait: ‘Atë, më jep pjesën e pasurisë që më takon’. Dhe i ati ua ndau ç’kishte. Pas jo shumë ditësh djali më i ri mblodhi çdo gjë, shkoi larg në një vend të huaj dhe atje e prishi gjithë pasurinë, duke bërë një jetë të shtthurur. Si i shpenzoi të gjitha, në atë vend ra një zi e madhe buke dhe ai filloi të jetë nevojtar. Atëherë shkoi e iu ngjit pas një qytetari të atij vendi, i cili e çoi në arat e tij që të kulloste derrat. Ai dëshironte të mbushte barkun me lendet që hanin derrat, por askush nuk ia jepte. Atëherë erdhi në vete dhe tha: ‘Sa mëditësve të babait tim u tepron buka, kurse unë po mbaroj nga uria! Do të çohem, do të shkoj tek im atë dhe do t’i them: Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje; nuk jam më i denjë të quhem yt bir; më bëj si një nga mëditësit e tu’. U çua, pra, dhe shkoi tek i ati. Por kur ishte ende larg, i ati e pa dhe pati dhembshuri; u lëshua me vrap, iu hodh në qafë dhe e puthi. Dhe i biri i tha: ‘O atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje dhe nuk jam më i denjë të quhem biri yt’. Por i ati u tha shërbëtorëve të vet: ‘Sillni këtu rrobën më të mirë dhe vishjani, i vini një unazë në gisht dhe sandale në këmbë. Sillni viçin e majmur dhe thereni; të hamë dhe të gëzohemi, sepse djali im ishte i vdekur dhe u kthye në jetë, ishte i humbur dhe u gjet’... Dhe filluan të gëzoheshin.

Djali i tij i madh ishte në arë; kur erdhi dhe iu afrua shtëpisë, ai dëgjoji këngë e valle. Atëherë thirri një nga shërbëtorët dhe e pyeti se ç’ishte e gjitha kjo. Ai i tha: ‘Erdhi yt vëlla dhe yt atë theri viçin e majmur, sepse iu kthye djali shëndoshë e mirë’. Ai u zemërua dhe nuk desh të hynte; atëherë i ati doli dhe iu lut të hynte. Por ai iu përgjigj të atit dhe i tha: ‘Ja, ka kaç vite që po të shërbej dhe kurrë s’kam shkelur asnjë nga urdhrat e tua, e megjithatë kurrë nuk më dhe një keq që të gëzohem me miqtë e mi. Por kur erdhi ky djali yt, që prishi pasurinë tënde me kurva, ti there për të viçin e majmur’. Atëherë i ati iu përgjigj: ‘O bir, ti je gjithmonë me mua dhe gjithë të miat janë të tuat. Por duhet të festojmë dhe të gëzohemi, sepse vëllai yt ishte i vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet’.”

**Pyetje për reflektim**

Gjej 10 cilësi të mira (fara të mirësisë) në secilin prej personazheve në shëmbëlltyrë: babai, vëllai i madh dhe vëllai i vogël.

**Moduli I** Gjuhët e dashurisë: Sesioni 5**Gjuhët e dashurisë<sup>1</sup>**

Marrë nga: “Pesë gjuhët e dashurisë” nga Gary Çepmën

**I. Fjalët përgëzuese**

Nëse kjo është gjuha juaj e dashurisë, komplimentet që të bëhen vlejné sa e gjithë bota për ty. Për ty është e rëndësishme të dëgjosh fjalët “të dua”, dhe kur dëgjon edhe arsyet prapa asaj dashurie, ti gati sa nuk fluturon nga gëzimi. Fyerjet mund të të lënë të rënë moralisht dhe nuk i harron lehtë.

**II. Koha cilësore**

Të jesh pranë këtij lloj personi është tepër e rëndësishme, por të jesh me të vërtetë pranë tij/saj – me Tv-në e fikur, me pirunin dhe thikën ulur dhe të tëra punët e shtëpisë apo detyrat e tjera të lëna mënjanë – kjo e bën personin tjetër kaq të rëndësishëm për ty, sa të ndihet vërtet i veçantë dhe i dashur prej teje. Shpërqendrimet, takimet e shtyra për herë tjetër apo mosdëgjimi i tjetrit mund të jenë vërtet lënduese për të.

**III. Marrja e dhuratave**

Nëse flet këtë gjuhë, dhurata apo gjesti i përsosur tregon se ti njihesh, që ndaj teje tregohet kujdes dhe se ti çmohesh më shumë se çfarëdo sakrifice që u desh për të të sjellë dhuratën.

**IV. Veprat e shërbimit**

Çfarëdo gjëje që ti bën për të lehtësuar barrën e përgjegjësive, të cilat peshojné te personi i llojit të gjuhës: “Veprat e shërbimit”, do të nënkuptojné shumëçka. Fjalët që ai apo ajo dëshiron të dëgjojë më së shumti janë: “Lërmë të ta bëj unë atë apo këtë gjë.”

**V. Prekja fizike**

Përqaftimet, përkëdheljet në kurriz, kapja për dore dhe prekjet me kujdes të krahut, të supit apo të fytyrës, të gjitha këto mund të jenë mënyra për të treguar entuziazëm, preokupim, përkujdesje dhe dashuri. Prania fizike dhe llogaridhënia janë tepër të rëndësishme, ndërkohë që neglizhenca apo abuzimi mund të jenë të pafalshme dhe shkatërrimtare.

# Moduli 2

## *Të kuptojmë të tashmen*

Kupto, vlerëso, identifikoj, angazhohu dhe festo janë fjalë të fuqishme në modulën “Të njohim të tashmen”. Sesioni “Gëzime dhe dhimbje” i fton pjesëmarrësit t’i shikojnë gëzimet dhe dhimbjet nga dy këndvështrime: a) Çfarë më sjell gëzim apo dhimbje mua si prind? dhe b) Çfarë u sjell gëzim apo dhimbje fëmijëve të mi? Ky sesion gjithashtu do të shqyrtojë konceptet e rëndësishme të identitetit, të roleve dhe të realitetit, si dhe mënyrën se si ato kanë të bëjnë me secilin pjesëtar të familjes.

“Hapësirë për dashuri dhe hir” i kujton pjesëmarrësit që t’u ofrojnë pjesëtarëve të familjes së tyre dashurinë dhe hirin të cilin ata vetë kanë marrë falas nga Perëndia. Kur marrëdhëniet prishen, atëherë është e vështirë të ofrosh dashuri dhe hir, por kjo është e vetmja mënyrë për të arritur shërimin e tyre. Disiplina dhe caktimi i kufijve, përbrenda kontekstit të udhëzimit, mbrojtjes dhe ushqimit, janë mjete të fuqishme të cilat pjesëmarrësit do t’i shqyrtojnë nga afër. Kështu, shpresohet që ata do të krijojnë hapësirë për dashuri dhe hir në marrëdhëniet dhe shtëpitë e tyre.

“Arsye për falënderim dhe mundësi për falje” i fton pjesëmarrësit që të shqyrtojnë pikat e tyre të forta, arsyet që kanë për të qenë mirënjohës si dhe të shqyrtojnë ato fusha ku kanë nevojë të rriten, si, për shembull, kërkimi i mundësive për të kërkuar apo për të ofruar falje. Shfrytëzimi i çdo arsyeje për të falënderuar dhe kërkimi i çdo mundësie për të kërkuar apo për të ofruar falje krijojnë një bazë të shëndoshë për familjet tona, prej nga ku ato mund të merren me të tashmen dhe të përgatiten për të ardhmen. Këto dy veprimtari krijojnë mundësinë për shërim dhe rimëkëmbje në familjet tona.



**Moduli 2** Të njohim të tashmen: Sesioni 6**Sesion 6: Gëzime dhe dhimbje**

Ky sesion i fton pjesëmarrësit që të vazhdojnë në udhëtimin e tyre si familje drejt plotësisë së jetës, duke shqyrtuar ato fusha që u sjellin prindërve gëzime dhe dhimbje, si dhe ato fusha që u sjellin gëzime dhe dhimbje fëmijëve. Duke kuptuar se prindërit dhe fëmijët kanë realitete përkatëse të ndryshme nga njëri - tjetri, pjesëmarrësit bëhen të vetëdijshëm se respektimi i këtyre realiteteve është një faktor kyç për të pasur marrëdhënie të mira familjare. Një mesazh tjetër i rëndësishëm për këtë sesion është identiteti dhe rolet e prindërve si dhe të fëmijëve.

Pjesëmarrësit do të marrin njohuri të thelluara nga “Psalmi” 139 dhe atyre do t’u paraqiten pikëpamjet e fëmijëve për jetën e plotësuar. Veprimtaritë dhe reflektimet e ndryshme do t’i ndihmojnë pjesëmarrësit që të shikojnë më thellë si dhe të identifikojnë hapat praktikë drejt forcimit të marrëdhënieve familjare.

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- identifikuar fushat që u sjellin gëzim dhe dhimbje prindërve si dhe fushat që u sjellin gëzim dhe dhimbje fëmijëve;
- njohje dhe reflektim për “pikat e lidhjes” (ajo që është e përbashkët) si dhe për “pikat e shkëputjes” (çfarë nuk është e përbashkët) mes gëzimeve dhe dhimbjeve të prindërve dhe fëmijëve;
- efektuar për “Psalmin” 139 si dhe do të kenë identifikuar mënyrat se si ata mund të udhëtojnë së bashku si familje;
- një kuptim më të mirë të pikëpamjeve të fëmijëve për plotësinë e jetës.

**Koha totale e sesionit**

95 minuta

**Prezantim**

Prezantoje sesionin duke shqyrtuar pikat e mëposhtme:

- Ne kemi përfunduar modulin I, “Trajtimi i së shkuarës”. Kemi mësuar se e kaluara jonë, pra, si kujtimet dhe përvojat tona pozitive, ashtu edhe ato negative, i kanë dhënë formë asaj që jemi dhe ka ndikuar te mënyra se si ne merremi me familjet tona.
- Kemi mësuar se na duhet të jemi në gjendje që të festojmë të mirën në të shkuarën tonë dhe ta vazhdojmë atë në të ardhmen. Ne duhet që, gjithashtu, të çlirohemi prej asaj që nuk është edhe aq e mirë në të shkuarën tonë, në mënyrë që të mund të bëjmë ndryshimet e nevojshme te e tashmja jonë. Hapi tjetër në udhëtim është: “Të njohim të tashmen”. Çfarë gjëje në të tashmen tonë duhet të pranohet, të trajtohet, të festohet apo për të cilën duhet t’i jemi mirënjohës dikujt apo t’i kërkojmë të falur? Cilat janë pikat tona të forta dhe në ç’pika kemi ende nevojë të rritemi?
- Hapi i parë drejt kuptimit të së tashmes është të kuptojmë atë që sjell gëzim dhe atë gjë që sjell dhimbje. Cilat janë ato gjëra që mua më sjellin gëzim si prind? Cilat janë ato gjëra që i sjellin gëzim fëmijëve të mi? Çfarë u shkakton dhimbje atyre?

**Koha**

5 minuta

**Veprimtaria I: Gëzime dhe dhimbje**

- Krijoni një tabak letre me titujt e mëposhtëm: GËZIMET E FËMIJËVE; GËZIMET E PRINDËRVE; DHIMBJET E FËMIJËVE; DHIMBJET E PRINDËRVE (në faqen vijuese).
- Shpërnda fletët e shënimeve për të gjithë pjesëmarrësit. Secili prej tyre duhet të pajiset me një fletë të verdhë dhe një blu.
- Pyeti pjesëmarrësit: “**Çfarë mendoni se u sjell gëzim fëmijëve tuaj?**” Kërkoju atyre që t’i shkruajnë përgjigjet e tyre në fletët e verdha (fletët e verdha = gëzim).
- Pyeti pjesëmarrësit: “**Çfarë mendoni se u sjell dhimbje fëmijëve tuaj?**” Kërkoju pjesëmarrësve që përgjigjet e tyre t’i shkruajnë te fletët blu (fleta blu = dhimbje).
- Kërkoju pjesëmarrësve që përgjigjet e tyre t’i afishojnë te kuadratet e duhura.

## Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 6



### Veprimtaria 1: Gëzime dhe dhimbje

- Kërkoji një vullnetari që të lexojë me zë të lartë të gjitha përgjigjet për sesionin “Gëzimi i fëmijëve”, ndërkohë që një vullnetar tjetër shkruan temat e përbashkëta në një fletë të bardhë shënimesh. Vendoseni fletën e bardhë përbri kuadratis.
- Bëj të njëjtën gjë me përgjigjet për “Gjërat që u shkaktojnë dhimbje fëmijëve”.
- Lehtësuesi lexon pastaj me zë të lartë temat e përbashkëta.
- Plotësojini në të njëjtën mënyrë edhe dy kuadratet e tjera.
- Pyeti pjesëmarrësit: **“Çfarë të sjell ty gëzim si prind apo kujdestar?”** Kërkoju që të shkruajnë përgjigjet e tyre te fletët e verdha (fleta e verdhë = gëzim).
- Pyeti pjesëmarrësit: **“Çfarë të shkakton ty dhimbje si prind apo kujdestar?”** Kërkoju pjesëmarrësve që t’i shkruajnë përgjigjet e tyre te fletët blu (fletët blu = dhimbje).
- Kërkoju pjesëmarrësve që fletët e tyre t’i afishojnë te kuadrati përkatës.
- Kërkoji një vullnetari që të lexojë me zë të lartë të gjitha përgjigjet për “Gjëra që u sjellin gëzime prindërve”, ndërkohë që një vullnetar tjetër shkruan temat e përbashkëta në një fletë të bardhë shënimesh. Vendose fletën e bardhë përbri kuadratis përkatës.
- Bëj të njëjtën gjë me përgjigjet për “Gjërat që u shkaktojnë dhimbje prindërve”.
- Më pas lehtësuesi lexon me zë të lartë temat e përbashkëta.
- Sapo temat kyçe të jenë identifikuar për të gjitha kuadratet, kërkoju pjesëmarrësve që të reflektojnë:
  - duke analizuar me kujdes të gjitha përgjigjet e dhëna;
  - duke kërkuar për përgjigje të ngjashme mes gjërave që u sjellin gëzim prindërve, gjërave që u sjellin gëzim fëmijëve si dhe gjërave që u shkaktojnë dhimbje prindërve dhe gjërave që u shkaktojnë dhimbje fëmijëve (pikat e lidhjes);
  - duke gjetur përgjigjet të cilat mund të shikohen vetëm te kuadrati i gjërave që u sjellin gëzim prindërve, por jo fëmijëve, që u shkaktojnë dhimbje prindërve, por jo fëmijëve apo që u sjellin gëzim fëmijëve, por jo prindërve, dhe që u shkaktojnë dhimbje fëmijëve, por jo prindërve (pikat e shkëputjes)
- Ndaj me grupin sa vijon:
- Ka tre fjalë të rëndësishme, të cilat duhet t’i theksojmë, ndërkohë që reflektojmë rreth përgjigjeve tona – REALITET, IDENTITET dhe ROL.
  - Ne duhet të vlerësojmë faktin se ndërkohë që jemi një familje, secili prej pjesëtarëve të familjes ka realitetin e tij apo të saj. Fëmijët tanë kanë realitetin e tyre njëloj siç e kanë edhe prindërit të vetin. Ne nuk mund ta mendojmë njërin realitet si më të rëndësishëm se tjetrin, paçka se realitetet tona mundet që nganjëherë të kenë mbivendosje, për shkak se ato i takojnë së njëjtës familje. Për rrjedhojë është e rëndësishme për ne që të kuptojmë dhe të respektojmë realitetin e secilit individ.
  - Çdo person është krijuar në mënyrë të mrekullueshme sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë e në përngjasim me Të, por nuk ka dy persona që të jenë të njëjtë, madje edhe përbrenda së njëjtës familje. Është e rëndësishme që të vlerësojmë identitetin dhe të qenit unik të çdo personi të dhënë nga Perëndia.
  - Ashtu sikurse çdo person ka realitetin dhe identitetin e tij apo të saj, po ashtu secili ka gjithashtu një rol të veçantë në familje. Çdo prind dhe çdo fëmijë ka një rol të dhënë nga Perëndia të cilin duhet ta përmbushë. Si prindër, ne jemi kujdestarë të fëmijëve tanë dhe na duhet që t’i rrisim ata me frikën dhe njohjen e Perëndisë. Si fëmijë, ne duhet t’i nderojmë e t’u bindemi prindërve tanë, për sa kohë që kjo është në linjë me urdhëresat dhe vullnetin e Perëndisë.
- Reflektoni së bashku rreth kësaj pyetjeje: **“Si mund t’i respektojmë atëherë këto parime realiteti, identiteti dhe rolesh në shtëpitë tona?”**



Koha  
45 minuta




## Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 6



### Veprimtaria 2: Reflektim për Shkrimin: “Psalmi” 139

- Me qëllim që të thelojmë reflektimin për realitetin, identitetin dhe rolet, kërkoju pjesëmarrësve që të reflektojnë për “Psalmin” 139:13–18. (Shiko tekstin në fund të këtij sesioni.)
- Ndaji pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe kërkoju që të shqyrtojnë pasazhet e Shkrimit si dhe t’u përgjigjen pyetjeve reflektuese.
- Kërkoji secilit grup që t’i shkruajë përgjigjet e tij në tabakun e letrës
- me tri rrrathët e përgatitur për këtë qëllim. (Shiko ilustrimin nga PowerPoint.)
- Kërkoji secilit grup që të tregojë përpara të gjithëve mendimet e veta duke treguar temat e përbashkëta. Gjithashtu, lëru kohë pjesëmarrësve që t’i ndajnë njohuritë dhe zbulimet e tyre rreth pasazhit si dhe domethënies së këtyre rezultateve si familje, si prindër dhe për fëmijët e tyre.



#### Mesazhe kyçe që duhen theksuar:

- Jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme. Ne i takojmë Perëndisë i Cili na ka thirrur në emër. Ne jemi fëmijët e Perëndisë.
- Fëmijët tanë i takojnë gjithashtu Perëndisë dhe janë bërë në mënyrë unike dhe të mrekullueshme.
- Përpara Perëndisë jemi të barabartë si unë, ashtu edhe fëmijët e mi. Ne kemi të njëjtin identitet përpara Perëndisë. Ne jemi fëmijët e Perëndisë dhe jemi bërë në shëmbëlltyrën e Perëndisë dhe në ngjashmërinë me Të.
- Ndërkohë që jemi të barabartë në identitetin tonë përpara Perëndisë, ne kemi role të ndryshme.
- Ne, si prindër, kemi detyrën e shenjtë që t’i rrisim fëmijët tanë sipas planit të Perëndisë si dhe në mënyra të cilat e nderojnë dhe e kënaqin Perëndinë. Si prindër, ne jemi kujdestarë e jo “pronarë” të fëmijëve tanë.
- Si fëmijë, roli ynë është t’i nderojmë prindërit tanë dhe t’u bindemi atyre, ndërkohë që ata na rrisin në përputhje me planin dhe mënyrat e Perëndisë.
- Si prindër dhe si fëmijë kemi role të cilat duhet t’i luajmë nëse dëshirojmë ta nderojmë Perëndinë dhe të jemi prindërit apo fëmijët që Perëndia na krijoj që të jemi.

**Koha**

25 minuta



### Kontribute: Pikëpamja e fëmijës në jetën e plotësuar

- Për të siguruar një kontekst të mëtejshëm, ndaji pikëpamjet e fëmijëve për jetën e plotësuar, të marra nga një grup me në qendër fëmijët.
- Thuaj: **“Ne kemi reflektuar rreth asaj që u sjell gëzim dhe dhimbje fëmijëve. Për ta çuar më tej përvojën tonë, ne dëshirojmë të krijojmë hapësirë për dëgjimin e pikëpamjeve të tyre. 646 fëmijë nga 5 vende të ndryshme iu përgjigjën pyetjes: Jeta është e plotësuar kur..”**
- Trego një përmbledhje të pikëpamjeve të fëmijëve (duke përdorur prezantimin në PowerPoint si dhe faqet 30–31).
- Jepu kohë për të reflektuar.

**Koha**

10 minuta



### Përmbledhja dhe përmbyllja

- Përmbylle sesionin duke pyetur pjesëmarrësit: **“Bazuar te reflektimet tona nga pasazhi dhe dëgjimi i zërit të fëmijëve, çfarë kemi mësuar për mënyrën se si të kemi marrëdhënie më të mira në familje?”**
- Ftoj pjesëmarrësit që të flasin rreth reflektimeve të tyre.
- Përmbylle me lutje.

**Koha**

10 minuta





**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 6**Shënime për lehtësuesin**

- Përgatit një tabak letre, duke e ndarë atë në katër kuadrate (shiko faqe 26) me titujt vijues: GËZIMI I FËMIJËVE; GËZIMI I PRINDËRVE; DHIMBJA E FËMIJËVE; DHIMBJA E PRINDËRVE.
- Vër në pah përgjatë gjithë sesionit pikat lidhëse dhe shkëputëse (shiko veprimtarinë I të këtij sesioni), ndërkohë që pjesëmarrësit ngrihen për të treguar mendimet e grupit.
- Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që gjendet te shtojca.

**Zhvillimi i trajnimit në kontekste besimesh të tjera fetare**

Në një kontekst ku ka pjesëmarrës nga tradita të tjera besimesh fetare, lehtësuesi mund t'u kërkojë pjesëmarrësve që të tregojnë nga librat e tyre të shenjtë pjesë që reflektojnë të njëjtin mesazh apo parime që gjenden te "Psalmi" 139.

**Materialet e nevojshme**

- Stilolapsa dhe lapustilë
- Letër ngjitëse apo materiale të tjera ngjitëse
- Fletë shënimesh me ngjyra të ndryshme
- Një tabak letre
- Reflektimi nga Shkrimi për "Psalmin" 139:13–18 (në faqen vijuese)
- Prezantim në PowerPoint si dhe kopje të Përmbledhje reagimesh: "Pikëpamjet e fëmijëve për jetën e plotësuar" (faqet 30–31)

## Moduli 2 Njohja e së tashmes: Sesioni 6

### Reflektim për Shkrimin: “Psalmi” 139:13–18

#### Jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme

Po, ti ke formuar të përbrendshmet e mia,  
Ti më ke endur në barkun e nënës sime.  
Unë do të të kremtoj, sepse jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme;  
veprat e tua janë të mrekullueshme  
dhe unë e di shumë mirë këtë gjë.  
Kockat e mia nuk ishin një e fshehtë  
për ty kur u formova në fshehtësi,  
Duke u endur në thellësitë e tokës.  
Dhe sytë e tu panë masën pa trajtë të trupit tim,  
dhe në librin tënd ishin shkruar  
ditët që ishin caktuar për mua, megjithëse asnjë  
prej tyre nuk ekzistonte ende.  
Oh, sa të çmuara janë për mua mendimet e tua, o Perëndi!  
Sa i madh është i gjithë numri i tyre!  
Po të doja t’i numëroja, do të ishin më të shumta se rëra;  
kur zgjohem, jam ende me ty.

**Psalmi 139:13–18**

#### Pyetje për reflektim

1. Çfarë na thotë ky pasazh rreth asaj që është Perëndia?
2. Çfarë na thotë ky pasazh rreth asaj që ne jemi përpara Perëndisë?
3. Çfarë na thotë ky pasazh rreth asaj që fëmijët janë përpara Perëndisë?

**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 6

**Përmbledhje e përgjigjeve: Pikëpamjet e fëmijëve për plotësinë e jetës**  
(Këto deklarata vijnë nga fëmijë prej Kamboxhias, Shqipërisë, Ugandës, Nikaraguas si dhe Filipineve.)

TEMAT E ZAKONSHME	JETA ËSHTË E PLOTË KUR...
<b>Paqe</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk kemi konflikte, nuk ka sherre, nuk ka dhunë, nuk ka luftë, nuk ka rrezik, por ka harmoni.</li> <li>Fëmijët jetojnë në siguri me pjesëtarët e familjes dhe komunitetin.</li> <li>Mund të shkojmë ku të duam.</li> <li>Nuk kam probleme apo shqetësime.</li> <li>Nuk jam i shqetësuar apo i frikësuar.</li> <li>Nuk më vret ndërgjegjja.</li> <li>Zemra dhe shpirti im janë të pastër dhe përplot paqe.</li> </ul>
<b>Plotësimi i nevojave</b> (ushqim, veshje, strehë, gjumë, siguri ekonomike)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Do të ketë ushqim në tavolinë më vonë si edhe nesër.</li> <li>Ne mund të hamë shumë më tepër [duke mbushur pjatën dy herë].</li> <li>Fëmijët do të flenë mirë nën rrjeta kundër mushkonjave, që ato të mos i pickojnë dhe t'i infektojnë me malarie.</li> <li>Do të qëndrojmë në një shtëpi të rehatshme e të sigurt; do të flemë në një shtrat të rehatshëm.</li> <li>Kemi rroba të cilat nuk janë gjithmonë të përdorura.</li> <li>Kemi pasuri.</li> <li>Kushtet tona të jetesës janë shumë herë më të mira.</li> <li>Kemi para.</li> <li>Mami dhe babi kanë punë.</li> <li>Unë kam ato që më duhen për të ndihmuar të tjerët në nevojë.</li> </ul>
<b>Shëndet i mirë dhe jetë e gjatë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk kam probleme me gjymtyrët e mia.</li> <li>Kam një trup të shëndetshëm.</li> <li>Kam një familje të shëndetshme.</li> <li>Njerëzit gëzojnë shëndet të mirë, nuk janë të sëmurë.</li> <li>Fëmijët marrin një përkujdesje të mirë.</li> <li>Shërohem nga sëmundjet.</li> <li>Familja jonë është e mbrojtur nga sëmundjet.</li> <li>Të kemi jetë të gjatë; të kemi shumë vite të bekuara; të jetojmë shumë vite dhe shumë më tepër vite nga ç'mund të përfytyrohet.</li> <li>Rritem.</li> <li>Plakem/bëhem me thinja.</li> <li>Prindërit janë gjallë e kanë mundësi të kujdesen për fëmijët e tyre derisa ata të rriten.</li> </ul>
<b>Arsimim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Është dikush që më do dhe më mbështet gjatë shkollimit tim.</li> <li>[Ne] marrim libra, marrin nota të mira, dimë t'u përgjigjemi pyetjeve të mësuesit, shkolla është e pastër. Mund të lexojmë dhe të shkruajmë dhe kemi kohë të bëjmë detyrat e shtëpisë (e jo të shkojmë të punojmë).</li> <li>Fëmijët nuk përjashtohen nga shkolla për shkak të pamundësisë për të paguar tarifën shkollore.</li> <li>Mbaroj shkollën e nëse më pastaj mund të gjej një punë të mirë me rrogë të mirë... që të mund të ndihmoj prindërit e mi.</li> </ul>

**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 6

TEMAT E ZAKONSHME	JETA ËSHTË E PLOTË KUR...
<b>Marrëdhënie të mira dhe festime</b> (familja, miqtë, komuniteti)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prindërit tregojnë kujdes, na lajnë rrobat, na ushqejnë dhe na mbrojnë.</li> <li>• Familja është e bashkuar.</li> <li>• Në familje nuk ka probleme.</li> <li>• Unë dëgjoj prindërit e mi dhe ata më dëgjojnë dhe më duan mua.</li> <li>• Ne i duam prindërit tanë dhe prindërit tanë na duan ne.</li> <li>• Mundemi të luajmë me shokët/shoqet.</li> <li>• Jemi të pajtuar e nuk zihemi me shokët.</li> <li>• Shokët na ndihmojnë në momente të vështira.</li> <li>• Ka një kishë dhe një shkollë në të cilën mund të shkoj.</li> <li>• Njerëzit e respektojnë njëri - tjetrin, bashkëpunojnë, e kuptojnë dhe kanë besim te njëri - tjetri, ndajnë bekimet dhe jetojnë në harmoni.</li> <li>• Festojmë Vitin e Ri dhe ka gjithandej fishekzjarrë.</li> <li>• Luaj futboll.</li> <li>• Lindi vëllai im i vogël.</li> </ul>
<b>Marrëdhënia me Perëndinë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kam Jezusin si shpëtimtarin tim personal.</li> <li>• Njoh Krishtin dhe e mbaj atë në zemrën dhe në jetën time.</li> <li>• Adhuroj Perëndinë; qëndroj në lutje; i bindem Perëndisë dhe urdhëresave të Tij; shkoj në kishë; shmang mëkatet; i kërkoj Perëndisë të më falë; mësoj të fal të tjerët; ndaj ungjillin me të tjerët.</li> <li>• Perëndia na mbron nga e keqja dhe mëkati; kur ndiejmë që Perëndia na do e që është gjithnjë pranë nesh.</li> </ul>

Burimi: 646 fëmijë (të moshës 5–21 vjeç), me tradita të ndryshme besimi fetar, nga pesë vende të ndryshme

## Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 7



### Sesioni 7: Hapësirë për dashuri dhe hir

“Hapësirë për dashuri dhe hir” i ndihmon pjesëmarrësit që të fitojnë një kuptim më të gjerë të konceptit dhe qëllimit të disiplinës pozitive, përmes shqyrtimit të pikëpamjeve të ndryshme: 1. kuptimi i tyre bazuar te përvojat e tyre, 2. një pikëpamje biblike dhe 3. kërkime që rezultojnë në theksimin e efekteve të dëmshme të disiplinimit negativ të fëmijëve. Sesioni mbyllet duke i inkurajuar pjesëmarrësit që të identifikojnë mënyrat praktike për të caktuar kufijtë e sjelljes së pranueshme në shtëpi, duke krijuar kështu hapësirë për dashuri dhe për hir.

**Koha totale e sesionit**

105 minuta



### Objektivat

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- reflektuar rreth mënyrës se si e kuptojnë disiplinën dhe se si zbatohet ajo në shtëpi;
- studiuar pikëpamjen biblike rreth disiplinës;
- identifikuar pasojat negative të disiplinës së dëmshme të fëmijët;
- identifikuar mënyra për të caktuar kufijtë e për të zbatuar disiplinën në shtëpi.



### Prezantim

Prezantoje sesionin duke kaluar nëpër pikat e mëposhtme:

- Një nga situatat më sfiduese sot në shtëpitë tona është trajtimi i lëndimeve dhe i zhgënjimit. Në shumë raste këto çojnë në prishjen e marrëdhënieve si dhe në dhimbje dhe zemërim. Është e rëndësishme që të sqarojmë atë që presim nga të tjerët, me qëllim që të caktojmë kufijtë e të biem dakord për mënyrën se si ne e shikojmë disiplinën.
- Duhet një përkushtim si dhe një angazhim i madh që të ndjekim harmoninë familjare. Na duhet të krijojmë hapësirë për hir në shtëpinë tonë, hapësirë kjo në të cilën si fëmijët, ashtu edhe prindërit mund t'i trajtojnë gjërat e bëra gabim pa u gjykuar, si dhe mund të ndërmarrin veprimet e duhura për të ndrequr gabimet dhe për të shëruar marrëdhëniet.
- Si e përdorim disiplinën në shtëpitë tona? Si krijojmë hapësirë për hir në shtëpitë tona? Si mund t'u ofrojmë lirisht po atë hir dhe dashuri që kemi marrë falas nga Perëndia pjesëtarëve të familjes që na kanë lënduar?

**Koha**

5 minuta



### Prezantoje sesionin duke kaluar nëpër pikat e mëposhtme:

Përdor veprimtarinë në vijim ku pjesëmarrësit të shqyrtojnë se si u ushtrua disiplinë në shtëpitë e tyre:

- Tregoju pjesëmarrësve që do të shqyrtojmë një fushë me ndjeshmëri të lartë për njerëzit. Kujtoji ata që kjo është një hapësirë e sigurt, një vend në të cilin ne respektojmë mendimet e njëri - tjetrit dhe ku ndajmë me njëri - tjetrin. Sidoqoftë, për të siguruar privatësinë (intimitetin), secili pjesëmarrës do ta shkruajë përgjigjen e tij apo të saj në një copë letër dhe do ta hedhë atë brenda një kutie. Lehtësuesi do të nxjerrë përgjigjet prej aty dhe do t'i lexojë. Kështu, identiteti dhe privatësia e secilit prej shkruesve do të jenë të mbrojtura.
- Fillo duke u kërkuar pjesëmarrësve që të kujtojnë një rast kur fëmija i tyre i ka bërë të ndihen të zemëruar. Shtro pyetjen: **“Kujtoni një rast kur fëmija yt ju ka bërë të zemëroheni. Çfarë bëtë në atë moment zemërimi?”**
- Ndërkohë që mendon rreth kësaj pyetjeje, shpërnda copat e letrave. Më pas jepu kohë pjesëmarrësve që të shkruajnë përgjigjen e tyre në letër. Kujtoji që ata nuk kanë nevojë të tregojnë atë që ndodhi, por vetëm atë që ata kanë bërë si përgjigje ndaj saj.
- Pasi të tërë pjesëmarrësit të kenë hedhur fletën e tyre të letrës në kuti, një vullnetar mund t'i renditë përgjigjet në tabakun e letrës, ndërkohë që lehtësuesi i lexon ato me zë të lartë.
- Mbaje të afishuar tabakun e letrës, që të tërë pjesëmarrësit ta shikojnë dhe t'i referohen, ndërkohë që zhvillohet sesioni.

**Koha**

15 minuta



## Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 7



### Veprimtaria 2: Hulumtimi i Shkrimit

Për të filluar procesin e reflektimit, drejtoji pjesëmarrësit në studimin e fjalës disiplinë:

- Pyeti pjesëmarrësit: **“Si e kuptoni fjalën disiplinë?”** Jepu kohë që të diskutojnë me njëri - tjetrin dhe pastaj rendit përgjigjet e tyre në një tabak letre. Kujtoji pjesëmarrësit që kjo është mënyra se si ata e kuptojnë fjalën disiplinë.
- Ftoj pjesëmarrësit që të shqyrtojnë Shkrimet, me qëllim që të mësojnë kuptimin biblik për disiplinën. Ndaji pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe kërkoju atyre të gjejnë të paktën dy pasazhe nga Shkrimet apo histori të cilat janë të lidhura me pyetjen.
- Kërkoju atyre të shkruajnë vargjet nga Shkrimi në një tabak letre, ndërsa secilit grup kërkoji që gjetjet e veta t’ia paraqesë të tërë grupit të bashkuar.
- Drejtoji pjesëmarrësit përmes një kohe reflektimi në lidhje me përvojat e tyre personale dhe asaj që ata kanë mësuar nga Shkrimet që kanë gjetur. Kërkoju atyre që t’i përgjigjen pyetjes: **“Çfarë na tregon Shkrimi apo librat tanë të shenjtë rreth disiplinës në kontekstin e shtëpisë?”**

**Koha**

30 minuta



### Veprimtaria 3: Studimi i Shkrimit

- Kërkoju pjesëmarrësve që t’u referohen “Fjalëve të urta” 13:24 si dhe “Fjalëve të urta” 22:15 (në faqen 36). Kërko që dikush të dalë vullnetar për të lexuar me zë të lartë pasazhet.
- Pyeti pjesëmarrësit: **“Çfarë ju thonë këto pasazhe?”**
- Ftoj disa vullnetarë që të ndajnë mendimet e tyre personale rreth dy pasazheve të prezantuara. Pastaj jep njohuri të thelluara për dy pasazhet (duke përdorur fletën e reflektimit për Shkrimet, e cila gjendet në faqet 36–37), duke theksuar pikat që vijojnë:
  - Te Shkrimet hebraike ka tre fjalë të ndryshme të cilat janë përkthyer “shkop”. Ajo që është përdorur në pasazhet nga “Fjalët e urta”, që sapo u shqyrta, është fjala shebet.
  - Shebeti qe një bastun i gjatë që mbahej nga i pari i familjes, skeptri i mbretit apo kërraba e bariut. Një bari i mirë dhe i përgjegjshëm e përdorte këtë kërrabë për të drejtuar dhe për të mbrojtur delet e tij. Një version i shebetit mbahet nga peshkopët e sotëm, si simbol drejtimi dhe autoriteti. Mbreti David te “Psalmi” 23 tha “se shkopi (shebet) dhe kërraba e Zotit i jepnin atij ngushëllim të madh”.
  - Disiplina vjen nga e njëjta rrënjë fjale me fjalën dishepull. Ajo do të thotë të trajnosh apo të japësh mësim, me qëllim që të prodhosh një karakter apo një model sjelljeje të caktuar. Disiplinë në dritën e të qenurit një “dishepull” është një mënyrë jetese, një proces i vazhdueshëm i përshtatjes së karakterit të dikujt përgjatë jetës. Ajo fillon që herët.
- Pyeti pjesëmarrësit: **“Çfarë ju vjen në mendje kur dëgjoni fjalën dishepull?”** Kërko që dy apo tre pjesëmarrës të shprehin mendimin e tyre të peshuara mirë.
- Trego që të krishterët e shikojnë Jezusin si shembullin e mënyrës se si ta jetojnë jetën e tyre. Të gjitha takimet e dokumentuara mes Jezusit dhe fëmijëve qenë takime të këndshme, plot butësi dhe respekt. Fjalët e Tij rreth skandalizimit të fëmijëve si dhe pasojat për këtë veprim (Mat. 18:6) janë ndër më të fortat që jepen në Shkrim. Jezusi na thotë se “për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë ne duhet të bëhemi si fëmijët e vegjël” (Mat. 18:3) dhe se “kushdo që e pranon një fëmijë të vogël... në emrin e tij, pranon vetë Jezusin” (Mat. 18:5).
- Vazhdo duke treguar prezantimin në PowerPoint dhe duke renditur format e zakonshme të ndëshkimeve, të cilat nuk janë të rekomandueshme, si dhe pasojat e tyre negative të mundshme. Ky hulumtim është realizuar nga organizata “Save the Children”.

**Koha**

30 minuta



**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 7**Reflektim**

Pas prezantimit, kërkoju disa pjesëmarrësve që të ndajnë mendimet dhe reagimet e tyre bazuar tek ato që kanë dëgjuar në këtë sesion.

**Koha**  
10 minuta**Mesazhe kyçe**

Thekso mesazhet kyçe të këtij sesioni:

- Disiplina është një mënyrë jetese. Ajo fillon që herët dhe vazhdon përgjatë gjithë jetës. Ajo nuk është një ngjarje e cila zhvillohet një herë në kohë.
- Disiplina nuk duhet zbatuar në emocione e sipër, pasi mund të shkaktojë efekte të dëmshme te fëmijët. Motivimi për disiplinën është dashuria, jo zemërimi e as hakmarrja.
- Si i ndihmojmë ne familjet, përfshi edhe familjen tonë, që të administrojnë disiplinë pozitive? Këto ide mund të ndihmojnë:
  - Të identifikojmë faktorët që i japin shkas disiplinës së ashpër apo negative te familjet dhe të planifikojmë t'i ndryshojmë ato. (Ndër këta faktorë mund të jenë stresi, pezmatimi, prindërimi si prind i vetëm apo shembujt e këqij.)
  - Krijoni një strategji për t'iu adresuar rrënjëve shkaktoare të dhunës në shtëpi.
  - Puno me partnerë të një mendjeje e zemre për t'iu adresuar çështjes së disiplinimit negativ në shtëpi.

**Koha**  
10 minuta**Përmbyllja**

- Për ta përmbyllur sesionin, kërkoju pjesëmarrësve që të mendojnë rreth përgjigjes që mund të japin ndaj pyetjes: **Cilat janë mënyrat praktike me të cilat ne mund të caktojmë kufij në shtëpi?**
- Shkruaj në një tabak letre përgjigjet e personave që kanë dalë vullnetarë dhe inkurajoni pjesëmarrësit që t'i përdorin këto sugjerime si udhëzues disiplinimi në shtëpitë e tyre.

**Koha**  
5 minuta**Shënime për lehtësuesit**

- Ky sesion mund ketë ndjeshmëri shumë të lartë, kështu që është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm që pjesëmarrësit mund të përgjigjen me emocione të forta. Mund të kërkohet kohë shtesë për pjesëmarrësit që të bëjnë pyetje dhe të artikulojnë ndjenjat e tyre gjatë diskutimit në grupin e madh. Pjesëmarrësit mund të duan gjithashtu që gjatë pushimit të diskutojnë pyetje apo të ndajnë reflektimet e tyre me lehtësuesin.
- Garanto konfidencialitetin si dhe bëj që pjesëmarrësit ta dinë se ndodhen në një vend ku mund të flasin lirisht.
- Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që ndodhet te shtojca.

**Zhvillimi i trajnimit në kontekste besimesh të tjera fetare**

- Te ushtrimi i shqyrtimit të Shkrimit (veprimtaria 2) lehtësuesi mund t'u kërkojë pjesëmarrësve histori apo pasazhe të shkëputura nga librat e tyre të shenjtë si dhe të flasin rreth disiplinës në familje.
- Lehtësuesi mund të zgjedhë që ta zëvendësojë me një diskutim tjetër diskutimin për "shkopin/sherbetin". Në vend të këtij diskutimi, bëj një prezantim të thjeshtë të "Efesianëve" 6:1–4, duke i pyetur pjesëmarrësit se çfarë domethënieje kanë këto vargje për ta. Ftoji pjesëmarrësit të ndajnë pasazhe të shkëputura nga librat e tyre të shenjtë, të cilat paraqesin mesazhe të ngjashme.
- Në kontekstet në të cilat fjala *dishepull* nuk është një koncept i përhapur, lehtësuesi mund të zgjedhë të thotë diçka të tillë, si: "Nga pikëpamja e krishterë, *dishepull* do të thotë... (trego çfarë do të thotë)". Gjithashtu, inkurajoni pjesëmarrësit që të kërkojnë për fjalë apo parime të ngjashme nga besimi i tyre, të cilat paraqesin të njëjtin mesazh.



## Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 7



### Materialet e nevojshme

- Një fletë letre e bardhë për secilin pjesëmarrës
- Një kuti boshe për të mbledhur të tëra letrat
- Tri tabakë letrash
- Lapustilë
- Reflektimi për Shkrimet: “Fjalët e urta” 13:24 dhe 22:15 (në faqen në vazhdim)
- Diapozitiva nga programi PowerPoint, ku të renditen format e zakonshme të ndëshkimit si dhe efektet e tyre negative

**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 7**Reflektim për Shkrimin: “Fjalët e urta” 13:24 dhe 22:15**

Kush e kursen thuprën, urren birin e vet,  
por ai që e do, e mëson me kohë.

“Fjalët e urta” 13:24

Marrëzia lidhet me zemrën e fëmijës,  
por thupra e ndreqjes do ta largojë prej saj.

“Fjalët e urta” 22:15

Te Shkrimet hebraike ka tre fjalë të ndryshme të cilat janë përkthyer “thupër/shkop”. Ajo që është përdorur në pasazhet nga “Fjalët e urta”, e cila sapo u shqyrtua, është fjala shebet. Shebeti që një bastun i gjatë që mbahej nga i pari i familjes, skeptri i mbretit apo kërraba e bariut. Një bari i mirë dhe i përgjegjshëm e përdorte këtë kërrabë për të drejtuar dhe mbrojtur delet e tij. Një version i shebetit mbahet nga peshkopët e sotëm si simbol drejtimi dhe autoriteti. Mbreti David, te “Psalmi” 23, tha se shkopi (shebet) dhe kërraba e Zotit i jepnin atij ngushëllim të madh.

*Disiplina* vjen nga e njëjta rrënjë fjale me fjalën *dishepull*. Ajo do të thotë të trajnosh apo të japësh mësim, me qëllim që të përfutosh një karakter apo një model të caktuar sjelljeje. Disiplina në dritën e të qenurit një “dishepull” është një mënyrë jetese, një proces i vazhdueshëm i përshtatjes së karakterit të dikujt përgjatë gjithë jetës. Ajo fillon që herët.

Disiplina përfshin një gamë të gjerë qasjesh, të cilat kanë për synim zhvillimin e karakteristikave dhe sjelljeve pozitive të fëmija të tilla, si: vetëkontrolli, vlerat dhe aftësitë për jetën.

Të krishterët e shikojnë Jezusin si shembullin e mënyrës se si të jetojnë jetën e tyre. Të gjitha takimet e dokumentuara mes Jezusit dhe fëmijëve qenë takime të këndshme, plot butësi dhe respekt. Fjalët e Tij rreth skandalizimit të fëmijëve si dhe pasojat për këtë veprim (Mat. 18:6) janë ndër më të fortat që jepen në Shkrim. Jezusi na thotë se për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë, ne duhet të “bëhemi si fëmijët e vegjël” (Mateu 18:3), dhe se “kushdo që e pranon një fëmijë të vogël... në emrin e tij, pranon vetë Jezusin” (Mateu 18:5).

**Përse ndëshkimi fizik dhe emocional i fëmijëve nuk ka efektshmëri?**

Unë isha i vogël kur babai im u martua me gruan e dytë. Ajo më keqtrajtonte. Kur isha në shkollë ajo nuk më jepte bukë me vete. Gjatë moshës shkollë isha i detyruar të dilja e të shisja banane, pavarësisht moshës sime të vogël, për të çuar para në shtëpi. Për shkak të vuajtjeve që kalova, u detyrova të shkoj ushtar që fëmijë. Qëllimi që kisha për vajtjen në ushtri ishte të kryeja zborin atje dhe pastaj të kthehesha në shtëpi e të hidhja një granatë aty ku ishte babai dhe mamaja ime, për shkak të keqtrajtimit që më kishin bërë. Por, pas zborit, faleminderit Perëndisë, i kisha falur ata për gjithçka që më kishin bërë. **Që prej asaj kohe kam mësuar se në çdo kohë që fëmijët do të keqtrajtohen, ata mund të tundohen për të bërë gjërat më të tmerrshme, të cilat nuk do të kishin dashur kurrë t’i bënin.** Unë i dua shumë fëmijët dhe nuk do doja t’i shikoja të keqtrajtoheshin. Kur jam duke ngarë makinën apo duke i dhënë biçikletës dhe shikoj një fëmijë që vuan apo që keqtrajtohet, unë ndalem dhe ofroj atë ndihmë që mundem. Fëmijët i kam shumë për zemër dhe nuk dua t’i shikoj të vuajnë.

– Prind nga Uganda

Ndëshkimi trupor nuk është i efektshëm në ndryshimin e sjelljes, sepse kështu fëmijët nuk mësojnë arsytet përse duhet të sillen në mënyrë korrekte. “Të mbajmë fëmijët të sigurt” (*Keping Children Safe*), nga Jenny Myers e organizatës “Save the Children”, rendit një sërë rezultatesh të mundshme negative të ndëshkimit fizik dhe emocional.

- Kjo mund të rrisë sjelljen agresive të fëmijës dhe të çojë në një cikël agresioni fizik nga i rrituri dhe fëmija.

## Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 7

- Mund të kontribuojë në sjellje kundërvajtëse, kriminale dhe antishoqërore, për shkak se nuk i mëson fëmijës shkakun përse ajo sjellje e caktuar është e gabuar.
- Ndikon te cilësia e marrëdhënieve të rritur - fëmijë, për shkak se ndëshkimi fizik krijon frikë, ankth dhe zemërim te fëmijët, duke i nxitur që të shmangin të rriturin në fjalë.
- Ndëshkimi i rreptë është i lidhur me vetëbesimin e ulët, gjendjen e pashpresë si dhe ndjenjat e poshtërimit te fëmijët.
- Shtim të gjasave për dhunë në marrëdhënie të ngushta në të ardhmen.
- Për shumë kujdestarë, abuzimi fizik fillon me përpjekjet për të ndryshuar sjelljen e një fëmije apo për t'u "dhënë atyre një mësim". Ndëshkimi mund të çojë në abuzim.

### Pyetje reflektuese

1. Identifiko (në grupe të vogla) mënyra të tjera (pozitive) për disiplinën.
2. Ç'lidhje kanë këto me përvojat e tjera apo me gjëra të cilat ju tashmë i dini?

**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 7**Ndikimet e mundshme negative të ndëshkimit të ashpër dhe poshtërues**

- Kjo mund të rrisë sjelljen agresive të fëmijës dhe të çojë në një cikël agresioni fizik nga i rrituri dhe fëmija.
- Mund të kontribuojë në sjellje kundërvajtëse, kriminale dhe antishoqërore, për shkak se nuk i mëson fëmijës shkakun përse ajo sjellje e caktuar është e gabuar.
- Ndikon te cilësia e marrëdhënieve të rritur - fëmijë, për shkak se ndëshkimi fizik krijon frikë, ankth dhe zemërim te fëmijët, duke i nxitur ata që të shmangin të rriturin në fjalë.
- Ndëshkimi i rreptë është i lidhur me vetëbesimin e ulët, gjendjen e pashpresë si dhe ndjenjat e poshtërimit te fëmijët.
- Shtim të gjasave që dhuna të jetë një nga tiparet e marrëdhënieve të tyre të ngushta në të ardhmen.
- Për shumë kujdestarë, abuzimi fizik fillon me përpjekjet për të ndryshuar sjelljen e një fëmije apo për t'u "dhënë atyre një mësim". Ndëshkimi mund të çojë në abuzim.

**Disa forma të zakonshme ndëshkimi, të cilat nuk rekomandohen**

Gjuajtja me shuplakë	Çokat
Gjuajtja me grusht	Pickimi/thumbimi
Gjuajtja me shkelm	Djegia/përvëlimi
Përdorimi i cilitdo objekti për të ndëshkuar	Mosdhënia e ushqimit apo pijeve
Kafshimi	Ushtrimet e skajshme fizike apo ekspozimi ndaj të nxehtit apo të ftohtit
Kanosjet	Lidhjet, duke përdorur pranga apo litarë
Poshtërimi	Shkulja e flokëve apo tërheqja e veshit
Frikësimi	Mitosja/rryshfeti
Vënia e nofkave	Vërejtjet apo veprimet me karakter diskriminues
Përdorimi i fjalëve të pista	

**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 8**Sesioni 8: Arsyë për falenderim, mundësi për falje**

Ky sesion u siguron pjesëmarrësve hapësirën e nevojshme për të reflektuar rreth pikave të tyre të forta (të tanishme), duke i konsideruar ato si arsye për të qenë mirënjohës dhe për të shqyrtuar fushat ku kanë nevojë të rriten. Kjo duke i parë ato si mundësi për të ofruar hir dhe për të praktikuar faljen. Pjesëmarrësit gjithashtu do të shqyrtojnë Shkrimin, me qëllim për të përfutur një pikëpamje më të gjerë të falënderimit dhe të faljes. Si përfundim, pjesëmarrësit do të ftohen që të vënë në praktikë atë që kanë mësuar, duke identifikuar dhe duke bërë një listë të bekimeve, si dhe duke falënderuar Perëndinë për to. Po kështu, pjesëmarrësit do të ftohen që të shkruajnë letra, duke kërkuar falje apo duke ofruar vetë falje për të tjerët. Pjesëmarrësve do t'u jepet gjithashtu kohë në dispozicion për të folur për mënyra më të miramenaxhimi të konflikteve në familjen e tyre.

**Koha totale e sesionit**

90 minutes

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- identifikuar pikat e tyre të forta si dhe fushat në të cilat kanë nevojë të rriten;
- kuptuar se pikat e tyre të forta janë arsye për të qenë mirënjohës;
- kuptuar se pikat e tyre të forta mund të jenë mundësi për të ofruar si dhe për të kërkuar hir dhe falje.

**Prezantim**

- Prezantoje veprimtarinë duke trajtuar pikat e mëposhtme:
- Ndërkohë që hodhëm vështrimin prapa te jetesa në shtëpinë e prindërve kur ishim të vegjël, kuptuam se udhëtimi ka pikat e tij kulmore si edhe ato të ulëta. Udhëtimi nuk është gjithnjë pa vështirësi apo ashtu siç do të donim ne që të ishte. Gjithashtu, duke kthyer vështrimin prapa, kuptuam se ka pasur fusha të plotësisë dhe fusha thyerjesh.
- Ne shikojmë të njëjtin model në të tashmen. Ka fusha me të cilat ne do të kemi vështirësi, sikurse dhe ka edhe fusha ku ne kemi fituar forcë. Secili prej pjesëtarëve të familjes sonë ka pika të forta dhe fusha në të cilat ka nevojë që të rritet.
- Ky sesion do të na ndihmojë të kuptojmë dhe të trajtojmë si pikat e forta, ashtu edhe fushat ku kemi nevojë për t'u rritur. Rezultatet të cilat shpresojmë t'i arrijmë, do të jenë arritja e vullnetit dhe e aftësisë që: 1. t'i shikojmë pikat tona të forta si arsye për të qenë mirënjohës dhe 2. t'i shikojmë fushat në të cilat kemi nevojë të rritemi si mundësi për të ofruar apo për të kërkuar falje.

**Koha**

5 minuta

**Veprimtaria 1: Pikat e forta dhe fushat në të cilat kemi nevojë të rritemi**

- Afisho pikturat e dy trungjeve: një pemë më të "hollë", për fushat që kanë nevojë për rritje, dhe një pemë më të "trashë", për pikat e forta. (Shiko modelin më poshtë për të prerë figurat e pemëve dhe gjetheve.) Jepi secilit pjesëmarrës dy gjethe të prera: një të verdhë dhe një jeshile. Gjethja e prerë me ngjyrë të verdhë përfaqëson fusha që kanë nevojë për rritje, ndërsa gjethja e prerë me ngjyrë jeshile simbolizon pikat e forta.
- Pyeti pjesëmarrësit: **"Cila është një pikë e fortë e jotja si prind apo kujdestar? Cila është ajo fushë ku keni nevojë për rritje?"**
- Kërkoju pjesëmarrësve që përgjigjen e tyre ta shkruajnë te gjethet (e verdha = rritje; jeshile = fortësi). Kur të kenë mbaruar së shkruari, ftoj ata që secilën gjethe ta vënë te pema e duhur.
- Kur të dyja pemët të jenë mbushur me gjethe, lexo me zë të lartë përgjigjet e ndryshme që janë dhënë.
- Pjesëmarrësit tregojnë pikat e tyre të forta si dhe ato në të cilat kanë nevojë të rriten.
- Kërkoju pjesëmarrësve që të diskutojnë pyetjet e mëposhtme: **"Çfarë mund të bëjmë që të ruajmë pikat tona të forta? dhe Çfarë mund të bëjmë që të adresojmë pikat në të cilat kemi nevojë të rritemi?"**



Pjesëmarrësit tregojnë pikat e tyre të forta si dhe ato në të cilat kanë nevojë të rriten.

**Koha**

25 minuta



## Moduli 2 Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 8



### Veprimtaria 2: Arsye për të qenë mirënjohës

- Nise këtë veprimtari duke u kërkuar pjesëmarrësve që të reflektojnë për pikat e tyre të forta. Trego që pikat tona të forta janë arsye për falënderim, por në pjesën më të madhe të kohës neve nuk na shkon mendja te kjo gjë. Ne kemi prirjen t'i marrim ato si të mirëqena.
- Ne do të kalojmë këtë kohë duke i parë këto pika të forta si bekime nga Perëndia dhe për rrjedhojë si arsye për të qenë mirënjohës.
- Kërkoju pjesëmarrësve të renditin në ditarin e tyre të paktën 10 bekime për të cilat mund të japin falënderime.
- Sapo të gjithë ta kenë përfunduar veprimtarinë, ftoj vullnetarët që të ndajnë me grupin atë që kanë vënë re për pikat e tyre të forta, si dhe atë që kanë mësuar rreth të qenurit mirënjohës.
- Përfundoje veprimtarinë me një lutje falënderuese.

**Koha**  
25 minuta



### Veprimtaria 3: Mundësi për falje

- Le t'u hedhim tani një vështrim pikave tona të forta. Pikat ku kemi nevojë të rritemi janë mundësi për ne për të reflektuar dhe të ndërmarrë veprime. Ne mund t'i kthejmë pikat tona ku kemi nevojë të rritemi, në pika të forta, por, për t'ia arritur kësaj, na duhet të ndërmarrim disa hapa.
- Ka dy hapa bazë që duhet të ndërmarrim: njëri është të kërkojmë falje, ndërsa tjetri është të falim. Nëse ky proces shërimi nuk ndodh, nuk do të jemi në gjendje që ta vazhdojmë udhëtimin tonë pa rrezikuar të biem përsëri në ato gabime.
- Shpërndaji çdo pjesëmarrësi dy fletët e letrës (me dy ngjyra të ndryshme). Kërkoju pjesëmarrësve që të shkruajnë dy letra: njëra është një letër ku i kërkohet falje një personi, të cilit në të shkuarën ata i kanë bërë një padrejtësi apo e kanë lënduar; tjetra është një letër ku ata i ofrojnë falje dikujt, i cili në të shkuarën i ka lënduar apo i ka bërë një padrejtësi. Lëru pjesëmarrësve kohën e nevojshme për ta përfunduar këtë.
- Sapo të tërë të kenë përfunduar letrat e tyre, ftoj ata të ndajnë me grupin njohuritë e thelluara që kanë fituar si dhe reflektimet e tyre. Gjithashtu, ftoj pjesëmarrësit që kur të jenë gati, këto letra t'ua dërgojnë apo t'ua japin personalisht njerëzve të cilëve ato u drejtohen. Përfundoje këtë pjesë të veprimtarisë me një lutje për falje.
- Për të kaluar nga reflektimi te veprimet, kërkoju pjesëmarrësve që të bisedojnë rreth pyetjes së mëposhtme: **“Cilat janë disa mënyra të dobishme adresimi të konflikteve në shtëpitë tona?”**
- Kërko për vullnetarë që të prezantojnë disa prej sugjerimeve të grupit. Renditi këto veprime në një tabak letre dhe kujtoji pjesëmarrësit që të mendojnë dhe t'i përdorin këto ide në rastet kur në shtëpitë e tyre lind ndonjë konflikt.

**Koha**  
30 minuta



### Përmbledhje dhe përmbyllja

Përmbylle sesionin me këto mesazhe kyçe:

- Të tërë kemi pika të forta dhe fusha në të cilat duhet të rritemi. Ne duhet t'i dallojmë këto fusha në mënyrë që familjet tona të mund të vazhdojnë udhëtimin e tyre drejt jetës së plotësuar.
- Ne duhet të sigurohemi që pikat tona të forta të mos i marrim si të mirëqena. Nuk duhet të harrojmë të falënderojmë shpeshherë Perëndinë për to.
- Ne nuk duhet të lejojmë që pikat tona të forta të na ndalojnë të bëjmë përpara në udhëtimin e familjes sonë. Këto fusha ne mund t'i shikojmë si mundësi qoftë për të kërkuar falje, qoftë për të ofruar falje.
- Duke ditur si t'i trajtojmë më mirë konfliktet në shtëpitë tona, kjo do të na ndihmojë të rritemi bashkërisht si familje si dhe të reduktojmë dhimbjen dhe lëndimet.

**Koha**  
5 minuta



**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesioni 8**Shënime për lehtësuesin**


- Kur pjesëmarrësit të fillojnë të flasin rreth fushave në të cilat ata kanë nevojë të rriten, niveli i emocioneve mund të jetë i lartë. Thekso që ajo çka thotë çdo person është shumë personale dhe duhet mbajtur e fshehtë.
- Është e rëndësishme ndjeshmëria ndaj besimit tradicional të çdo pjesëmarrësi.
- Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që gjendet te shtojca.

**Zhvillimi i trajnimit në kontekste të besimeve të tjera fetare**

Në kontekste ku lutja në publik nuk është një praktikë e pranueshme, lehtësuesi mund t'u kërkojë pjesëmarrësve që thjesht të kalojnë një çast reflektimi në heshtje rreth asaj që ata kanë mësuar në këtë sesion.



**Materialet e nevojshme**

- Tabakë letre
- Lapustila apo stilolapsa me ngjyra të ndryshme
- Letër ngjitëse apo materiale të tjera ngjitëse
- Diapozitiva nga programi PowerPoint
- Projektor LCD
- Gjethe letre të prera (në faqen në vijim)
- Dy vizatime trunjesh peme: një për “pika të forta” dhe një për “fusha që kanë nevojë për rritje” (shiko ilustrimin djathtas)
- Ditari i pjesëmarrësve
- Dy fletë letër shkrimi për çdo pjesëmarrës (me dy ngjyra të ndryshme)





**Moduli 2** Të kuptojmë të tashmen: Sesi 8






## Moduli 3

# Të vizionosh të ardhmen

Seksioni “Të vizionosh të ardhmen” na tregon atë që duhet të bëjmë për t’i bërë shtëpitë tona më të forta dhe gati për të ardhmen. Për t’i bërë shtëpitë tona të forta dhe gati për të ardhmen, na duhet të reflektojmë për momente të rëndësishme si dhe përvojat nga e kaluara, të cilat i kanë formuar familjet tona në mënyrën se si janë tani. Duke reflektuar rreth këtyre përvojave të kaluara, duke menduar veçanërisht rreth asaj që na ka mbajtur gjatë kohëve të vështira, ky proces pothuajse gjithnjë do të na i shpjerë mendimet te sovraniteti dhe besnikëria e Perëndisë. Ne shikojmë se Perëndia ka qenë me ne në të shkuarën dhe do të jetë me ne si tani, ashtu edhe në brezat e ardhshëm.

Ky modul na fton që të bëjmë atë që na takon për të ardhmen. Ne do të kërkojmë për veprime shumë praktike që mund të ndërmarrim për të forcuar themelet e shtëpisë dhe të familjeve tona. Ne do të përpiqemi që t’i kryejmë këto veprime në mënyrë të pandërprerë, që fëmijët tanë të mund të ndërtojnë mbi bazën e kujtimeve të tyre vetjake.

Si prindër dhe kujdestarë, ky modul na fton që të mendojmë rreth mënyrave të sjelljes. (A e ndihmojnë sjelljet tona rritjen e fëmijëve tanë, apo e bëjnë atë edhe më të vështirë?) Ky modul na fton që të zgjedhim veprime të bazuara te mosha dhe niveli i zhvillimit të fëmijëve, të cilat jo vetëm që promovojnë rritje, por gjithashtu kultivojnë dashuri, shpresë dhe qëllim.



**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 9**Sesioni 9: Momente përcaktuese**

Sesioni “Momente përcaktuese” i fton pjesëmarrësit që të shikojnë tek udhëtimi i familjeve të tyre dhe të identifikojnë momente të rëndësishme të cilat i kanë dhënë trajtë, kanë ndikuar dhe kanë frymëzuar familjet e tyre përgjatë gjithë kohës. Pjesëmarrësit reflektojnë për këto momente dhe atë që i bëri të mbahen gjatë vështirësive që kaluan si familje. Reflektimi rreth një pasazhi nga Shkrimi do t’i udhëzojë pjesëmarrësit që të shikojnë sovranitetin, praninë dhe besnikërinë e Perëndisë. Ata do të jenë në gjendje që të shikojnë se nuk do t’i kishin kaluar vështirësitë dhe momentet sfiduese pa besnikërinë e Perëndisë.

**Koha totale e sesionit**

70 minutes

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- reflektuar dhe do të kenë identifikuar parime nga “Jozueu” 4:1–7 dhe “Jeremia” 6:16;
- identifikuar momente të rëndësishme – gurë kilometrikë – në udhëtimin e tyre si familje;
- kuptuar atë që i ka mbajtur nëpër kohët e vështira;
- vendosur të fillojnë një traditë reflektimi dhe shikimi përpara në familjet e tyre

**Prezantim**

Prezantoje sesionin duke kaluar nëpër pikat e mëposhtme:

- Çdo familje ka një udhëtim. Me kalimin e kohës, udhëtimi karakterizohet nga ngjarje të rëndësishme, të cilat i kanë dhënë trajtë dhe kanë frymëzuar reagimin e çdo familjeje ndaj këtyre ngjarjeve. Vizionimi e së ardhmes për familjen tënde do të thotë të kthesh vështrimin prapa, të identifikosh momentet e rëndësishme, të reflektosh e të mësoh prej tyre si dhe të marrësh një vendim që këtë mësim ta mbani me vete ndërkohë që udhëtoni si familje.
- Askush nuk e di të ardhmen, por mësimet nga e kaluara dhe realitetet e së tashmes mund ta ndihmojnë çdo familje që të programojë të ardhmen e saj.

**Koha**

5 minuta

**Veprimtaria 1: Reflektim për “Jozueu” 4:1–7**

Drejtoji pjesëmarrësit në reflektimin për Shkrimin “Gurë përkujtimorë”.

- Filloje reflektimin nga Shkrimi në fjalë, duke i kërkuar një vullnetari që të lexojë me zë të lartë pasazhin e Shkrimit “Jozueu” 4:1–7 (faqe 48).
- Pasi ky pasazh të jetë lexuar, paraqit sfondin e atij teksti përmes tregimit të historive, duke përdorur figurat që gjenden në prezantimin në PowerPoint.
- Përdori pikat bisedore të mëposhtme si udhëzuese për tregimin e historisë:
  - Shumë kohë më parë, Perëndia vendosi të bekojë të tërë botën përmes familjes së Abrahamit dhe Sarës. (Trego pikturën e Abrahamit dhe Sarës, që të është dhënë te prezantimi në PowerPoint.)
  - Perëndia u premtoi se do t’u jepte një tokë që gëlonte në gjëra të mira. Pastaj ata do mund të jetonin një jetë plot mirënjohje dhe bujari, që do të shikohej dhe do të përjetohej nga familjet e tjera të botës.
  - Udhëtimi drejt Tokës së Premtuar nuk qe i lehtë. Gjatë udhëtimit familja kaloi nëpër situata të vështira, si, për shembull, një kohë të gjatë në skllavëri dhe sorollatjesh në shkretëtirë, gjë që e vuri në provë besimin e tyre. (Trego pikturën e duarve të prangosura si dhe atë të shkretëtirës, që të janë dhënë te prezantimi në PowerPoint.)
  - Ky udhëtim gjithashtu u krijoi atyre mundësinë që të dëshmonin dhe të përjetonin fuqinë e madhe të Perëndisë në rastet e shumta që Perëndia i çliroi. (Trego pikturën e Moisiut dhe ndarjen e Detit të Kuq, që të është dhënë te prezantimi në PowerPoint.)

**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 9**Veprimtaria 1: Reflektim për “Jozueu” 4:1–7 (vazhdim)**

- Historia te “Jozueu” 4:1–7 zhvillohet pas 40 vjet rrugëtimi në shkretëtirë. Një brez i ri më në fund qe gati për të marrë në zotërim Tokën e Premtuar, por një lum i madh u kishte zënë rrugën. Edhe një herë tjetër Perëndia kreu një mrekulli që më së fundi populli i Tij të vendosej në atë territor – Perëndia i ndau ujërat e lumit, duke i mundësuar kësioj popullit hebre që të kalonte nëpër tokë të thatë.
- Brezi i ri u afirmua përmes dëshmisë të përmbushjes së premtimit të Perëndisë. Për shkak të mënyrës se si Perëndia e përmbushi premtimin, ata ngritën një përmendore që do t’i kujtonte brezat e ardhshëm për tri gjëra: 1) çfarë bëri Perëndia (në të shkuarën), 2) kush ishin njerëzit e Perëndisë (në të tashmen) dhe 3) se si duhet që të jetojnë njerëzit e Perëndisë (në të tashmen dhe në të ardhmen). (Trego pikturën e gurëve të bërë përg, që të është dhënë te prezantimi në PowerPoint.)

Inkurajo tre deri në pesë pjesëmarrës që të ndajnë reflektimet e tyre, duke parashtruar pyetjet e mëposhtme:

- **Çfarë u tregonin gurët fëmijëve rreth së shkuarës?**
- **Çfarë të thonë reflektimet që kemi ndarë nga pasazhi në lidhje me familjen tënde?**

**Koha**  
25 minuta

**Veprimtaria 2: Vija kohore e familjes sime**

Edhe familjet tona kanë qenë gjithashtu në një udhëtim. Neve na takon t’u tregojmë fëmijëve tanë për këtë udhëtim. Sot do të praktikojmë tregimin e historisë së familjes sonë, duke përdorur një vijë kohore – “Vija kohore e familjes sime”.

- Jepi çdo pjesëmarrësi një fletë vije kohore (modeli i saj gjendet në faqen 49). Kërkoju pjesëmarrësve që të shkruajnë datën e lindjes në fund majtas të asaj vije. Nga ana e djathtë ata duhet të shkruajnë datën e sotme.
- Kërkoju pjesëmarrësve që të mendojnë për momentet më të rëndësishme të jetës së tyre si familje.
- Kërkoju atyre që këto ngjarje apo momente t’i vënë përgjatë gjithë vijës kohore. Ngjarjet mund të jenë pozitive ose negative nga pikëpamja e tyre, por duhet të jenë ngjarje të rëndësishme të udhëtimit të tyre.
- Drejtoji pjesëmarrësit në një reflektim, duke shtruar pyetjen: **“Çfarë gjërash ju mbajtën si familje?”** Renditi përgjigjet në një tabak letre dhe trego temat e përbashkëta.
- Pyet: **“Si mund ta përgatitin këto gjëra familjen tënde për të ardhmen?”**
- Përgjigjet e tyre renditi në tabakun e letrës.



Pjesëmarrësit reflektojnë për vijën kohore të familjes së tyre.



**Koha**  
25 minuta



**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 9**Veprimtaria 3: Reflektim për “Jeremia” 6:16**

Drejtoji pjesëmarrësit në një reflektim për “Jeremia” 6:16.

- Kërkoji një vullnetari që të lexojë me zë të lartë pasazhin. Kërkoju pjesëmarrësve që të mendojnë e të ndajë mendimet e tyre rreth pyetjes: **“Çfarë të thotë ky pasazh?”** Jepu kohë për diskutime.
- Pyet: **“Çfarë domethënieje ka ky pasazh për familjen tënde ndërkohë që udhëtoni në të ardhmen?”** Jepu kohë për diskutime.
- Trego fjalë vepruese kyçe në pasazh, të cilat mund të shërbejnë si udhëzues, ndërkohë që ata mendojnë për të ardhmen. Disa fjalë të tilla janë: *qëndroj, shikoj, pyes* dhe eci.

**Koha**  
10 minuta

**Përmbledhje dhe përmbyllje**

- Inkurajoji pjesëmarrësit që të nisin një traditë familjare të dokumentimit të gurëve të tyre kilometrikë dhe “ndërtimit të gurëve përkujtimorë”. Kjo praktikë mund t’i ndihmojë fëmijët që të thellojnë kuptimin dhe vlerësimin e udhëtimit të familjes së tyre, dhe t’u japë atyre një themel të sigurt për të ardhmen. Kjo krijon një ndjenjë qëndrueshmërie dhe shprese.
- Mbajtja e shënimeve gjithashtu i kujton fëmijët për besnikërinë e Perëndisë dhe u lejon atyre mundësinë që të presin që besnikëria e Perëndisë të jetë pjesë edhe e së ardhmes së tyre.
- Për ta filluar këtë praktikë, jepi secilit pjesëmarrës nga një vijë tjetër kohore familjare boshe. Inkurajoji që këtë vijë ta marrin me vete në shtëpi e të nisin traditën e plotësimit të saj rregullisht.

**Koha**  
5 minuta

**Shënim në ditar**

Kërkoju pjesëmarrësve që të shkruajnë në ditarët e tyre një lutje falënderimi për besnikërinë e Perëndisë. Sugjero që ata të shkruajnë gjithashtu rreth mirëbesimit të tyre te Perëndia për ditët që kanë përpara.

**Shënime për lehtësuesin**

Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që gjendet te shtojca.

**Zhvillimi i trajnimit në kontekste besimesh të tjera fetare**

Në një kontekst ku ka pjesëmarrës nga tradita të tjera fetare, lehtësuesi mund të bëjë si më poshtë:




- Ta kalojë pa trajtuar “Jozueun” 4:1–7 dhe të hidhet te veprimtaria e vijës kohore familjare.
- Të përdorë prezantimin e pasazhit nga “Jeremia” 6:16, sepse ai përmban elementet kyçe të domosdoshme për këtë sesion. Sidoqoftë, lehtësuesi mund t’i ftojë pjesëmarrësit që të ndajnë pasazhe nga librat e tyre të shenjtë, të cilat kanë një mesazh të ngjashëm, pasi pjesëmarrësit të kenë ndarë reflektimet e tyre nga “Jeremia” 6:16.

## Moduli 3 Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 9



### Materialet e nevojshme

- Reflektim për Shkrimin “Jozueu” 4:1–7 (në faqen në vijim)
- Një kopje të “Jeremia” 6:16 për çdo pjesëmarrës
- Dy kopje të vijës kohore familjare për çdo pjesëmarrës
- Stilolapsa, bojëra dhjami, lapustila dhe lapsa shumëngjyrësh
- Tabak letre
- Prezantim në PowerPoint
- Ditarët e pjesëmarrësve



**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 9

## Reflektim për Shkrimin: “Jozueu” 4:1–7

### Gurë përkujtimorë

Kur i gjithë populli mbaroi së kapërcyeri lumin Jordan, ZOTI i foli Jozueut, duke i thënë: “Merrni nga radhët e popullit dymbëdhjetë burra, një për çdo fis, dhe u jepni këtë urdhër: ‘Merrni dymbëdhjetë gurë që këtej, në mes të Jordanit, pikërisht në vendin ku u ndalën këmbët e priftërinjve, i merrni me vete matanë lumit dhe i vendosni në vendin ku do të strehoheni sonte’”. Atëherë Jozueu thirri dymbëdhjetë burrat që kishte zgjedhur ndër bijtë e Izraelit, një për çdo fis, dhe u tha atyre: “Kaloni para arkës së ZOTIT, Perëndisë tuaj, në mes të Jordanit, dhe secili prej jush të mbajë në kurriz një gur, sipas numrit të fiseve të bijve të Izraelit, me qëllim që kjo të jetë një shenjë midis jush. Kur t’ju pyesin bijtë tuaj në të ardhmen, duke thënë: ‘Ç’janë për ju këta gurë?’, ju do t’u përgjigjeni kështu: ‘Ujërat e Jordanit u ndanë para arkës së besëlidhjes të ZOTIT; kur ajo kaloi Jordanin, ujërat e tij u ndanë dhe këta gurë do të jenë për bijtë e Izraelit një kujtim përjetë’”.

Jozueu 4:1–7

### Diskutim i shkurtër

Shumë kohë më parë Perëndia vendosi ta bekojë të gjithë botën përmes familjes së Abrahamit dhe Sarës. Perëndia u premtoi se do t’u jepte një tokë që gëlonte në gjëra të mira. Pastaj ata do të mund të jetonin një jetë plot mirënjohje dhe bujari, që do të shikohej e do të përjetohej nga familjet e tjera të botës.

Udhëtimi drejt Tokës së Premtuar nuk qe i lehtë. Gjatë udhëtimit familja kaloi nëpër situata të vështira, si, për shembull, një kohë të gjatë në skllavëri dhe sorollatjesh në shkretëtirë, gjë që e vuri në provë besimin e tyre. Ky udhëtim gjithashtu u krijoi atyre mundësinë që të dëshmonin dhe të përjetonin fuqinë e madhe të Perëndisë në rastet e shumta në të cilat Perëndia i çliroi.


Pasi Perëndia kreu një mrekulli, duke i vendosur ata në tokën që u kishte premtuar, ata ngritën një përkujtimore për t’u kujtuar brezave të ardhshëm tri gjëra: 1) atë që Perëndia bëri (në të shkuarën), 2) kush ishin njerëzit e Perëndisë (në të tashmen) dhe 3) si duhet të jetojnë njerëzit e Perëndisë (në të tashmen dhe në të ardhmen).

### Pyetje për reflektim

Lexo pasazhin nga Shkrimi. Mendo për kontekstin e historisë së shkruar, pastaj reflekto rreth pyetjeve vijuese:

1. Çfarë u tregonin gurët fëmijëve për të shkuarën?
2. Çfarë të thonë reflektimet që kemi ndarë nga pasazhet më lart në lidhje me familjen tënde?





DATA E SOTME

Vija kohore e familjes sime

**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 10**Sesioni 10: Ndërtues të mençur**

“Ndërtues të mençur” u jep mundësinë pjesëmarrësve të reflektojnë për “Mateun” 7:24–27, si shëmbëlltyra që bën fjalë për njeriun e mençur, i cili e ndërtoi shtëpinë e vet mbi shkëmb, si dhe për njeriun e pamend, i cili e ndërtoi shtëpinë e vet mbi rërë. Duke reflektuar për Shkrimin, pjesëmarrësit ftohen që të identifikojnë në shtëpitë dhe familjet e tyre gjërat të cilat formojnë një themel të fortë (shkëmb) si dhe gjërat të cilat formojnë një themel të dobët (rërë). Më pas atyre u kërkohet që të identifikojnë një apo më shumë veprime që mund të ndër marrin për ta bërë të fortë themelin e shtëpisë së tyre.

**Koha totale e sesionit**

85 minuta

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- ndarë reflektimet dhe njohuritë e tyre të thelluara për “Mateun” 7:24–27;
- identifikuar pjesët e dobëta (rërë) dhe të forta (shkëmb) në themelin e shtëpive të tyre;
- renditur veprime praktike që ata mund të bëjnë për të ndërtuar apo për të rindërtuar shtëpitë dhe familjet e tyre.

**Prezantim**

- Nëse është e mundur, prezanto sesionin me videoklipin “Ndërtues të mençur e të pamend” (të shkarkuar nga <http://www.max7.org>).
- Kërkoji një vullnetari të lexojë me zë të lartë nga Shkrimi pasazhin “Mateu” 7:24–27 (faqe 53). Bëj një paraqitje të shkurtër të kontekstit të këtij pasazhi nga Shkrimi. Përdor si udhëzime sa më poshtë:

Shkrimi krahason dy burra, të cilët po ndërtonin nga një shtëpi. “I mençuri” e ndërtoi shtëpinë e vet mbi një shkëmb, një themel që nuk lëkundet kollaj. Stuhitë e jetës erdhën, por shtëpia vazhdoi të qëndronte e fortë, duke u mbijetuar sprovave dhe sfidave të jetës.

Ndërtuesi tjetër, “i pamend”, e ndërtoi shtëpinë e tij mbi rërë – një themel i dobët. Stuhitë e jetës erdhën dhe shtëpia u rrënuar, sepse nuk qe në gjendje t’i bënte ballë forcës së stuhisë.

Gjatë kohës kur u tregua kjo shëmbëlltyrë, njerëzve u pëlqente t’i ndërtonin shtëpitë e tyre në lugina lumenjsh me brigje rëre, për shkak të pamjes që ato ofronin si dhe lehtësisë së gërmimit në rërë për të hedhur themelin. Megjithëkëtë, kur stuhitë sillnin shira të rrëmbyeshëm, këto lugina lumenjsh mbusheshin me ujë. Shtëpitë shkatërroheshin dhe merreshin përpara nga uji.

Mendo për shtëpinë në të cilën jeton vetë. Po të të kërkoja të ma përshkruaje shtëpinë tënde, ka shumë mundësi që ti do të më tregoje se ku ndodhet, ç’ngjyrë ka, modelin, madhësinë, sa oborr ka, numrin e dhomave të gjumit e kështu me radhë. Megjithëkëtë, ka shumë mundësi që ju nuk do të më tregonit për themelin e saj. Ndoshta ti nuk di asgjë për themelet e shtëpisë tënde. Megjithëkëtë, themelet e shtëpisë janë ato që bëjnë ndryshimin.

Kjo histori bën një lidhje midis ilustrimit të ndërtimit të një shtëpie me ndërtimin e një jete. “Rëra” dhe “shkëmbi” na ndihmojnë të kuptojnë ndryshimin mes një themeli të “fortë” dhe një themeli të “dobët”.

**Koha**

15 minuta



## Moduli 3 Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 10

### Veprimtaria 1: Rrë dhe shkëmb


- Ndaji pjesëmarrësit në grupe të vogla. Duke iu referuar reflektimit për “Mateun” 7:24–27, kërkoju atyre të reflektojnë mbi këto dy pyetje në grupet e tyre të vogla:
  - Çfarë e bën të dobët themelin në shtëpinë tënde (rrë)?
  - Çfarë e bën të fortë themelin në shtëpinë tënde (shkëmb)?
- Kur të kenë mbaruar së foluri, kërko që nga çdo grup të dalë një vullnetar, i cili të renditë në një tabak letre përgjigjet.
- Sapo grupet të jenë gati, kërkoji një vullnetari nga çdo grup të lexojë me zë të lartë përgjigjet. Ndërkohë që grupet dëgjojnë përgjigjet e dhëna, ata duhet të vendosin një shenjë dalluese përbri përgjigjeve në tabakun e letres së tyre, tashmë të afishuar. Kur të jetë radha e tyre për të prezantuar, ata duhet të lexojnë me zë të lartë vetëm përgjigjet që nuk janë dhënë tashmë nga grupet e tjera.



Pjesëmarrësit renditën përgjigjet e tyre për veprimtarinë “Rrë” dhe “Shkëmb”.

RËRË	SHKËMB

- Përgjigjet shkruaji në një kartë të cilën vendose tek ilustrimi i një shtëpie. (Shiko shembullin djathtas.) Kjo tani reflekton temat e përbashkëta.
- Ftoj pjesëmarrësit që të qëndrojnë pranë ilustrimit të shtëpisë dhe t’u hedhin një sy veprimeve të “tullat”.
- Kërkoju pjesëmarrësve që të bëjnë lidhjet me sesionet e mëparshme të “Gëzime dhe dhimbje” dhe “Shenja plotësie, shenja thyerjesh.”



**Koha**

35 minuta

### Veprimtaria 2: Tulla ndërtimi

- Jepi secilit pjesëmarrës një kartë drejtkëndore. Karta simbolizon një “tullë” në shtëpi.
- Kërkoju pjesëmarrësve të shkruajnë një hap veprimi, të cilin ata mund ta ndërmarrin për të forcuar shtëpinë e tyre.
- Kujtoji pjesëmarrësit që të mendojnë për një veprim praktik, diçka që ata me të vërtetë mund ta bëjnë, dhe jo një deklaratë të përgjithshme. Për shembull, në vend që të thuash: “Unë do të kaloj më shumë kohë me familjen time”, thuaj: “Çdo të premte, unë do të gatuj një darkë të veçantë në shtëpi, në mënyrë që së bashku si familje të hamë një vakt të veçantë”
- Pasi pjesëmarrësit të kenë menduar për një veprim praktik dhe ta kenë shkruar atë në kartë, kërkoju atyre që t’i lexojnë veprimet e tyre me zë të lartë dhe t’i ngjisin kartat e tyre në hapësirat e lëna për “tullat” në pikturën e shtëpisë së madhe.



Shtëpia që përmban “tullat” e pjesëmarrësve.

**Koha**

25 minuta

**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 10**Përmbledhje dhe përmbyllje**

- Pasi të tërë pjesëmarrësit të kenë mbaruar me shkrimin e veprimeve të tyre dhe të kenë afishuar kartat, kërkoju që të mblidhen rreth “shtëpisë” së përfunduar. Pas një kohe të shkurtër të vështrimit të shtëpisë dhe “tullave” të saj, ftoji pjesëmarrësit që të flasin rreth reflektimeve të tyre.
- Përmbylle sesionin me lutje.

**Koha**  
10 minuta**Shënim në ditar**

Kërkoju pjesëmarrësve që të shkruajnë në ditarin e tyre veprimin që ata kanë kryer (tullën).

**Shënime për lehtësuesin**


Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që gjendet te shtojca.

**Zhvillimi i workshop-it në kontekste besimesh të tjera fetare**

- Në një kontekst kur ka pjesëmarrës nga tradita të tjera fetare, lehtësuesi mundet që thjesht të parafranojë shembëlltyrën e ndërtuesve të mençur (Mateu 7:24–27).
- Lehtësuesi mundet gjithashtu t'i ftojë pjesëmarrësit që të flasin për një pasazh apo për një thënie nga tradita e tyre e besimit, e cila flet për atë që e bën të fortë një familje.
- Në kontekste ku lutja në publik nuk është një praktikë e pranueshme, lehtësuesi mund t'u kërkojë pjesëmarrësve që thjesht të kalojnë një çast në heshtje dhe të reflektojnë rreth asaj që kanë mësuar gjatë këtij sesioni.

**Materialet e nevojshme**

- Stilolapsa, bojëra dhjami dhe lapustila shumëngjyrësh
- Videoklip i shkarkuar nga max7.org
- Letër ngjitëse apo materiale të tjera ngjitëse
- Karta drejtkëndore me ngjyra të ndryshme (me madhësinë e drejtkëndëshave të figurës së shtëpisë), nga një për çdo pjesëmarrës
- Tabak letre
- Piktura e një shtëpie të madhe (shiko ilustrimin djathtas)
- Reflektim rreth Shkrimit për “Mateun” 7:24–27 (në faqen vijuese)
- Ditarët e pjesëmarrësve



**Moduli 3**

## Vizionimi e së ardhmes: Sesioni 10

## Reflektim për Shkrimin: “Mateu” 7:24–27

### Ndërtues të mençur

Kushdo, pra, që i dëgjon fjalët e mia dhe i bën do ta krahasoj me një njeri të mençur, që e ka ndërtuar shtëpinë e vet mbi shkëmb. Dhe ra shiu, dhe erdhën lumenjtë, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; dhe nuk ra, sepse ishte themeluar mbi shkëmb. Kushdo që i dëgjon fjalët e mia dhe nuk i bën, do të krahasohet me një njeri budalla, që e ka ndërtuar shtëpinë e vet mbi rërë. Dhe ra shiu, dhe erdhën lumenjtë, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; dhe ajo ra, dhe rënia e saj qe e madhe”.

**Mateu 7:24–27**

### Diskutim i shkurtër

Shkrimi krahason dy burra të cilët po ndërtonin secili nga një shtëpi.

“I mençuri” e ndërton shtëpinë e vet mbi një shkëmb, një themel që nuk lëkundet kollaj. Stuhitë e jetës erdhën, por shtëpia vazhdoi të qëndronte e fortë, duke u mbijetuar sprovave dhe sfidave të jetës.

Ndërtuesi tjetër, “i pamend”, e ndërtoi shtëpinë e tij mbi rërë – një themel i dobët. Stuhitë e jetës erdhën dhe shtëpia u rrënuar, sepse nuk qe në gjendje t’i bënte ballë forcës së stuhisë. Shkrimi na tregon se rënia dhe shkatërrimi i tyre qe i madh.

Këto janë dy ilustrime shumë të gjalla dhe praktike të mënyrës se si duhet të ndërtohen shtëpitë tona. Le ta përdorim këtë tregim për të ndërtuar apo për të rindërtuar shtëpitë tona.

### Pyetje për reflektim

(Përdor pikturën e shtëpisë për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve.)

1. Çfarë e bën të dobët themelin në një shtëpi (rërë)?
2. Çfarë e bën të fortë themelin në një shtëpi (shkëmb)?

**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni I I**Sesioni I I: Përcaktimi i hapave tanë**

Ky sesion u siguron pjesëmarrësve mundësi për të reflektuar, për të shqyrtuar dhe për të identifikuar sjellje të cilat ata duhet të rreshtin së bëri, apo të fillojnë ose të vazhdojnë t'i bëjnë ndërkohë që rrisin fëmijët e tyre. Kjo i lejon pjesëmarrësit të studiojnë atë që fëmijët mund të bëjnë në secilën fazë të fëmijërisë si dhe që të mësojnë gjëra me të cilat mund t'i rrisin dhe t'i mbështesin fëmijët e tyre më me efikasitet.

**Koha totale e sesionit**

135 minuta

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- shqyrtuar sjelljet që ata – si prindër apo kujdestarë – kanë nevojë të rreshtin së bëri, të fillojnë t'i bëjnë apo të vazhdojnë t'i bëjnë;
- filluar të bëhen të vetëdijshëm për fazat e zhvillimit të fëmijëve;
- identifikuar mënyra të reja mësimore, bazuar në këto faza zhvillimore;
- të ndërgjegjësohen për fazat e zhvillimit të prindërve dhe të kujdestarëve.

**Prezantim**

Prezantoje sesionin duke kaluar nëpër këto çështje:


- Ne kemi parë kujtimet dhe ngjarjet e së shkuarës tonë si dhe kemi reflektuar rreth faktit se si kjo gjë ndikon te mënyra se si i rrisim fëmijët tanë. Kemi identifikuar gjithashtu pikat tona të forta dhe fushat në të cilat kemi nevojë të rritemi, dhe jemi zotuar që të ndërmarrim veprime bazuar në njohuritë tona për këto fusha. Kemi pasur mundësi që të diskutojmë mënyra të cilat do të na ndihmojnë të rritim fëmijët tanë.
- Ndërkohë që mendojmë rreth së ardhmes, kemi identifikuar gjithashtu atë gjë që krijon një themel të fortë për shtëpitë tona. Kemi identifikuar “blloqe ndërtimi”, të cilat do të na ndihmojnë të krijojmë një shtëpi të fortë dhe ushqyese për fëmijët tanë.
- Kemi mësuar shumë. Tani është koha që të vendosim për hapat që do të na ndihmojnë të ecim përpara në udhëtimin tonë si familje.

**Koha**

5 minuta

**Veprimtaria I: Semafori**

- Ndaji pjesëmarrësit në gjashtë grupe bazuar te mosha (apo fazat e zhvillimit) e fëmijëve të tyre:
  - nga zero deri në 18-muajsh,
  - 19-muajsh deri në 2 vjeç,
  - 3 deri në 5 vjeç,
  - 6 deri në 11 vjeç,
  - 12 deri në 17 vjeç,
  - 18 deri në 21 vjeç e lart.
- Nëse nuk ka pjesëmarrës të mjaftueshëm në një apo më shumë prej këtyre gjashtë grupeve, përqendrohu tek ato grupe që kanë pjesëmarrës.
- Jepi secilit grup një tabak letre, që përmban foton e një semafori (faqe 55). Shpjego që ngjyrat e semaforit simbolizojnë veprimet apo sjelljet të cilat ne duhet t'i rreshtim së bëri, të vazhdojmë t'i bëjmë apo të fillojmë t'i bëjmë (e kuqe = ndal, e verdhë = vazhdo, jeshile = fillo).



Pjesëmarrësit i vënë përgjigjet e tyre në veprimtarinë “Semafori”.


**Koha**

45 minuta



**Moduli 3** Vizionimi e së ardhmes: Sesioni I I**Veprimtaria 1: Semafori (vazhdim)**

- A i janë përgjigjur pjesëmarrësit pyetjes: **“Ndërkohë që rritim fëmijët tanë, çfarë veprimesh apo sjelljesh specifike duhet të ndalojmë, të vazhdojmë apo të fillojmë?”** Kërkoju pjesëmarrësve që përgjigjet e dhëna t'i shkruajnë në një fletë letre dhe më pas mendimet e tyre t'i ndajnë me të tjerët në grupin e tyre të vogël.
- Kërko nga një vullnetar në secilin grup të vogël që të renditë përgjigjet në tabakun e letrës.
- Pasi të tëra grupet e vogla të kenë përfunduar, ndaji me të gjithë grupin listat e plotësuara prej tyre

**Koha**

45 minuta

**Veprimtaria 2: Fazat e zhvillimit**

Kjo veprimtari përqendrohet në fazat zhvillimore të fëmijëve si dhe tek ajo që prindërit kanë nevojë, me qëllim që të jenë të frytshëm në çdo fazë të zhvillimit të fëmijëve të tyre (shiko dokumentet në faqet 56–71).

- Kërkoju pjesëmarrësve që të kthehen te të njëjtat grupe të vogla, në të cilat ishin për veprimtarinë e parë.
- Kërkoju pjesëmarrësve që të gjejnë fazat e zhvillimit në doracakun e tyre. Udhëzoji ata që t'i lexojnë dhe t'i diskutojnë sesionet për grup-moshën e fëmijëve që i është caktuar grupit të tyre.
- Kërkoji secilin grup të renditë pesë gjëra që kanë mësuar rreth grup-moshës që u është caktuar.
- Bashkujini përsëri grupet e vogla dhe kërkoji secilin grup të raportojë ato që mësuan. Për ta nxitur më shumë diskutimin, lehtësuesi mund të ofrojë më shumë shpjegime apo të japë shembuj të tjerë.

**Koha**

40 minuta

**Shënim në ditar**


Kërkoju pjesëmarrësve që të shkruajnë në ditarët e tyre një koncept kyç që ata kanë mësuar dhe të cilin kanë planifikuar ta zbatojnë menjëherë në shtëpinë e tyre.

**Shënime për lehtësuesin**

Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që gjendet te shtojca.

**Materialet e nevojshme**

- Lapustila
- Fletë letre për secilin pjesëmarrës
- Stilolapsa me ngjyra
- Gjashtë tabakë letre (një për secilin grup të vogël) me nga një fletë ku tregohet një semafor (shiko djathtas) dhe një fletë bosh
- Fletët e fazave të zhvillimit (faqet 56–71)
- Ditarët e pjesëmarrësve



## Fazat zhvillimore Foshnjëria: zero deri në 18-muajsh

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
0–4 muajsh	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dëgjon tinguj dhe zëra.</li> <li>Qan qëllimisht për të kërkuar ndihmë.</li> <li>Veç të qarës, fillon të bëjë edhe tinguj të tjerë (gugat).</li> <li>Reagon ndaj objekteve dhe kthen kokën nga ato kur lëvizin.</li> <li>Fillon të përqendrohet.</li> <li>Eksploron duke futur objekte në gojë.</li> <li>I pëlqen të përsërisë veprimet e pëlqeshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lëviz kokën nga njëra anë në tjetrën.</li> <li>Ngre kokën dhe pjesën e sipërme të trupit mbi duar kur është në një pozicion përmbys ose kur mbahet çuar i kapur nga shpatullat.</li> <li>Pjesët e sipërme të trupit janë më aktive: përplas duart mbi fytyrë, tund krahët andej-këtej, zgjatet për të kapur objekte.</li> <li>Lëvizjet janë të mëdha dhe me hope.</li> <li>Reflekset e gjetjes së thithkës së gjirit dhe thithjes janë të zhvilluara mirë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Reagon ndaj mosrehatisë apo dhimbjes.</li> <li>Njeh zërin (e të tjerëve) me të cilin është familjarizuar.</li> <li>Krijon kontakt me sy.</li> <li>Shoqërizohet me këdo, por njeh mamanë ose kujdestarin kryesor.</li> <li>Qetësohet kur merret hopa veçanërisht nga prindi apo nga të njohur të tjerë.</li> <li>Buzëqesh apo qesh si reagim ndaj gudulisjes apo lojërave që bëjnë të rriturit me të.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I vëmendshëm ndaj nevojave të fëmijës, kështu që mirëbesimi do të krijohet që herët.</li> <li>Luan me butësi.</li> <li>I qetë, veçanërisht kur fëmija qan, krijon ndjenjën e sigurisë.</li> <li>Përkujdesës.</li> <li>Tregon shprehje pozitive fytyre.</li> <li>E qetëson fëmijën duke i kënduar, duke e marrë hopa apo duke i folur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Flet dhe mban hopa foshnjën.</li> <li>I jep fëmijës gjëra interesante që t'i shikojë.</li> <li>Luan “kapsi bupsi” apo lojëra të tjera argëtuese me gishta.</li> <li>Sjell lodra jo të rrezikshme dhe që mund të lahen, në mënyrë që fëmija t'i shikojë e t'i kafshojë.</li> <li>Vendos lodra afër apo sipër foshnjës, që ta inkurajojë fëmijën të rrotullohet për t'i parë më mirë.</li> </ul>
5–8 muajsh	<ul style="list-style-type: none"> <li>Luan me këmbë.</li> <li>Njeh dhe përgjigjet ndaj emrit të vet.</li> <li>Studion me vëmendje objektet.</li> <li>Gugat në mënyrë spontane.</li> <li>Mëson tinguj nga gjuha amtare.</li> <li>Mund të tregojë me gisht pjesët e trupit.</li> <li>Bën “da-da” me dorë.</li> <li>Imiton tinguj dhe veprime të thjeshta.</li> <li>Bën gjeste për të komunikuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrotullohet.</li> <li>Pështyn.</li> <li>Kalon më shumë kohë në pozicion ngritur.</li> <li>Mëson të ecë këmbadoras.</li> <li>Fillon koordinimi sy-dorë.</li> <li>Transferon lodrat nga njëra dorë te tjetra.</li> <li>Merr, tund dhe peshon objekte.</li> <li>Vështron pothuajse gjithçka me shikim të mirë.</li> <li>Fillon të hajë ushqime pureje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Qan ose tregon mungesë rehatie në prani të një të panjohuri.</li> <li>Merr pjesë në lojëra të thjeshta si “ku-ku” apo “këtu ka, këtu nuk ka”.</li> <li>Shfaq ndjenja sigurie kur mbahet hopa apo kur i flitet.</li> <li>Shpreh kënaqësi.</li> <li>Mund të krijojë lidhje të ngushtë me një objekt të veçantë.</li> <li>Bëhet më shumë mirëbesues kur të qarat e tij marrin përgjigje.</li> <li>Mund të fillojë të lidhet fort me kujdestarin kryesor të tij/të saj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Luan në një mënyrë më aktive.</li> <li>Flet më shumë, i hareshëm dhe fjalaman.</li> <li>Këndon apo reciton vjersha të thjeshta.</li> <li>Reagon ndaj nevojave të ngutshme të fëmijës.</li> <li>Përgatit mjedisin që të jetë i sigurt për t'u eksploruar.</li> <li>E qetëson fëmijën, por edhe e lë më vete për të inkurajuar pavarësinë.</li> <li>E informon fëmijën kur largohet, po ashtu edhe kur kthehet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I bie instrumenteve muzikore dhe flet për këto instrumente.</li> <li>Përdor pasqyra në mur dhe dyshe për të treguar foshnjën dhe pjesët e trupit.</li> <li>I mëson lojëra të thjeshta me gishta e duar.</li> <li>Luan “xhia-kaloo” duke tundur lehtë lart e poshtë foshnjën e ulur te gjunjët e të rriturit.</li> <li>I vesh çorape me ngjyra për ta inkurajuar fëmijën që të zgjatet për të prekur këmbët.</li> </ul>



## Fazat zhvillimore Foshnjëria: zero deri 18 - muajsh

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
9–12 muajsh	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen objekte të fshehura.</li> <li>Mbledh lodrat bashkë me saktësi.</li> <li>Krijon pritshmëri rreth ngjarjeve familjare.</li> <li>Reagon siç duhet ndaj disa fjalëve specifike.</li> <li>Thotë disa fjalë të kuptueshme.</li> <li>Diskriminon mes prindërve dhe të tjerëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çohet dhe ulet ndenjur.</li> <li>Ecën këmbadoras, tërhiqet për t'u ngritur në këmbë.</li> <li>Përkulet dhe ngrihet prapë drejt.</li> <li>Fillon të lëvizë dhe si përfundim të ecë.</li> <li>Fillon të kacavirret.</li> <li>Hedh gjëra qëllimisht përtokë.</li> <li>Zhvillon koordinimin sy-dorë.</li> <li>Shihet një vendosje më e dukshme e gishtit të madh kundrejt të tjerëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I pëlqen të jetë me fëmijë të tjerë.</li> <li>Ka një shtysë të rritur për pavarësi.</li> <li>Shpreh zemërim në mënyrë më dramatike.</li> <li>Ka frikë nga të panjohurit.</li> <li>Është i vetëdijshëm për aprovimin apo mosaprovimin social.</li> <li>Vepron që të bjerë në sy të të tjerëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E inkurajon fëmijën që të provojë lëvizje të reja aktive si dhe të gjejë lodra të reja.</li> <li>Fizikisht aktiv pranë fëmijës.</li> <li>I qetë dhe i përmbajtur edhe kur fëmija rrëzohet apo bën gabime.</li> <li>I duruar për t'i kujtuar në mënyrë të përsëritur fëmijës gjërat që janë të duhura.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Luan “ku-ku” duke mbuluar fytyrën apo lodrën me një copë.</li> <li>Vë mobilie të sigurta dhe që nuk lëkunden.</li> <li>Vendos gjëra interesante përreth, në mënyrë që fëmija të dojë t'i kapë ato.</li> <li>Luan lojë e pasqyrave, duke e inkurajuar fëmijën që të imitojë veprime apo shprehjet e fytyrës së të rriturit.</li> </ul>
9–12 muajsh	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën zgjidhje problemesh përmes provës/gabimit.</li> <li>Tregon me gisht drejt objekteve si përgjigje ndaj pyetjeve gojore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka ende dorë të preferuar për të përdorur.</li> <li>Fillon të kapë objekte duke përdorur pëllëmbën dhe gishtërinjtë.</li> <li>Mund të vetushqehet me ushqime që kapen me gishta.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krenohet me arritjet personale.</li> <li>Luan vetëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fut fëmijën në shoqërinë e të tjerëve dhe e mbështet atë.</li> <li>I jep fëmijës mundësinë për të bërë gjëra në mënyrë të pavarur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E inkurajon fëmijën që të hedhë objekte të vogla në një kuti.</li> <li>Brohoret kur foshnja përpiket të lëvizë barkas apo të ecë.</li> <li>Vë copa ushqimi të butë në tavolinë, në mënyrë që foshnja, e ulur te karrigia e lartë, të praktikohet me kapjen e ushqimit.</li> </ul>

Marrë nga:

[www.acetonline.org/child\\_dev\\_milestone.pdf](http://www.acetonline.org/child_dev_milestone.pdf)

[uppu.org](http://uppu.org)

[unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf)

[en.wikipedia.org/wiki/Child\\_development\\_stages](http://en.wikipedia.org/wiki/Child_development_stages)

[www.dphhs.mt.gov/cfsd/](http://www.dphhs.mt.gov/cfsd/)

## Fazat zhvillimore Fëmijëria e hershme: 18-muajsh deri në 2 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
18–23 muajsh	<ul style="list-style-type: none"> <li>Deri në moshën dyvjeçare përdor më shumë se 200 fjalë.</li> <li>Bën fjali të thjeshta dyfjalëshe.</li> <li>I referohet vetes në emër, i flet vetes gjatë lojës.</li> <li>Imiton sjelljen e të rriturve.</li> <li>Mëson duke ndihmuar.</li> <li>Mëson koncepte të tilla, si: madhësia, forma dhe pesha, ndërkohë që ai apo ajo lëviz dhe luan me objektet përreth.</li> <li>Përdor gjeste për të komunikuar.</li> <li>Përsërit fjalë që ai apo ajo ka dëgjuar më tepër.</li> <li>Mban mend tekstat e këngëve si dhe lëvizjet shoqëruese të vjershave dhe këngëve.</li> <li>Fillon të bëjë gjëra qëllimisht.</li> <li>Mund të gjejë objekte të fshehura edhe poshtë më shumë sesa një shtrese.</li> <li>Gjen vendndodhjen e objekteve të njohura kur i kërkohet (po qe se e di vendndodhjen përpara kërkesës).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të ecë vetëm.</li> <li>Vrapon mirë, por mund të rrëzohet kur ndalon.</li> <li>Shtyn dhe tërheq lodrat kur ecën.</li> <li>Ngjit shkallët me fillimin e pavarësisë.</li> <li>Mund të zbrësë shkallët, duke u mbajtur për dore.</li> <li>Qëndron në tra ekuilibri.</li> <li>Rri me një këmbë duke u mbajtur.</li> <li>Shkelmon, rrotullon dhe hedh topin.</li> <li>Ulet galiç për të ngritur objekte nga dyshemeja.</li> <li>Shkelmon përpara dhe mbrapa.</li> <li>Përdor një kapje delikate si me darë për objekte të vogla.</li> <li>Mban një laps boje dhjami, duke e kapur në mënyrë primitive, me tre gishta, dhe shkarravit.</li> <li>Ul dorezat e dyerve.</li> <li>Pëlqen të hipë në lodra me rrota të vogla.</li> <li>Ndihmon në veshje dhe zhveshje.</li> <li>Heq këpucët.</li> <li>Mund të përdorë një lugë.</li> <li>Pi me pipë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ka nocionin e të qenurit veçan – egocentrik.</li> <li>E ka pak të zhvilluar konceptin e ndarjes së gjërave me të tjerët, por e ka të fortë ndjenjën “e imja”.</li> <li>Shfaq ndrojtje para të panjohurve.</li> <li>Nuk pëlqen ndryshimet në rutinë, por mund t’u rezistojë apo të refuzojë bashkëworkshop-in në rutina të cilat dikur ishin të pëlqyeshme.</li> <li>Fillon të mësohet me vajtjen në tualet.</li> <li>Fillon të ketë shpërthime zemërimi kur nevrikoset, pezmatohet apo kur është i lodhur/i uritur.</li> <li>Fillon të përdorë me raste fjalë mirësjelljeje (të lutem, faleminderit).</li> <li>Përfshihet në lojëra imagjinare.</li> <li>Vë në provë skajet e sjelljes.</li> <li>U komunikon nevojat e tij të rriturve (dëshiron ujë, ka nevojë të urinojë apo të shkojë në banjë etj.).</li> <li>Tregon ankth apo qan kur mamaja apo kujdestari kryesor mban në krahë një fëmijë tjetër.</li> <li>Pëlqen shoqërinë e fëmijëve të tjerë, por ende nuk luan në grup.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I njëtrajtshëm në rutina dhe gjëra të cilat duhen bërë edhe nëse fëmija reziston.</li> <li>I qetë, por i prerë.</li> <li>Kupton llojet e ndryshme të së qarës; kupton dhe shmang atë lloj të qare që kërkon vetëm të tërheqë vëmendje.</li> <li>Siguron më shumë se një alternativë për gjëra të caktuara përdërisa ndarja me të tjerët është e vështirë në këtë moshë.</li> <li>E inkurajon fëmijën që të “tregojë” aftësitë.</li> <li>I komunikueshëm dhe bisedues; përdor shprehje të mirësjelljes si dhe fjalë të sjellshme.</li> <li>E lejon fëmijën që të luajë jashtë në hapësira të mëdha, për t’u zhvilluar fizikisht.</li> <li>E lë fëmijën që të ndërveprojë me persona të tjerë të rëndësishëm, veçanërisht me ata që nuk janë pjesë e shtëpisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E lejon fëmijën që të ndihmojë në detyra të thjeshta, si, për shembull, në përgatitjen e një vakti të ndërmjetëm, në kalimin e harxheve nga njëri vend në tjetrin, në marrjen e një objekti e kështu me radhë.</li> <li>E zgjeron fjalorin duke shtuar fjalë ndaj asaj që fëmija është duke thënë. (Po qe se një fëmijë çapitës thotë “qen”, thuaj “po, ky është një qen i vogël bojëkafë!”)</li> <li>Mbushe zonën e krijimtarisë artistike me shumë bojëra dhjami, letra si dhe materiale të tjera të riciklueshme.</li> <li>Inkurajo shkarravitjet, vizatimet si dhe projektet e tjera të bëra me duar.</li> <li>Jepi një valë duartrokitjesh edhe për suksese të thjeshta, përfshi këtu edhe mësimin e vajtjes në banjë.</li> <li>Cakto data loje apo vizitash të të afërmit.</li> </ul>
2 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdor fjalë kyçe, por lë pa përdorur fjalët lidhëse.</li> <li>Nuk është ende i/e familjarizuar me përemrat më të shpeshtë, por përdor apo kupton parafjalët e thjeshta (në, mbi, jashtë e kështu me radhë).</li> <li>Përdor ca fjalë në shumës.</li> <li>Shpreh fjali në mohore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të anashkalojë pengesat dhe të ecë me trupin më drejt.</li> <li>Vrapon më shpejt dhe në një mënyrë më të drejtuar.</li> <li>Ulet galiç për periudha të gjata, ndërkohë që luan.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pëlqen shoqërinë e fëmijëve të tjerë, por ende ngurron t’i ndajë lodrat me të tjerët.</li> <li>Mund të shfaqë preokupim kur një fëmijë tjetër është i mërztur.</li> <li>Përfshihet në lojë paralele (pranë të tjerëve).</li> <li>Vazhdon të jetë egocentrik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpërfill manipulimin dhe e shpërqendron fëmijën, duke përdorur gjëra pozitive në mjedis.</li> <li>Luan “shtëpiash” për të prezantuar apo për të forcuar aftësi dhe koncepte të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdor pjesët e lojërave formuese për të zhvilluar koordinimin sy-dorë, aftësitë e imëta motorike si dhe mendimin logjik.</li> <li>Gjen lojëra kombinimesh për të mprehur kujtesën dhe gjithashtu për të zhvilluar gjuhën, ndërkohë që prindi flet për objektet dhe e udhëzon fëmijën përmes orientimeve gojore.</li> </ul>

## Fazat zhvillimore Fëmijëria e hershme: 18-muajsh deri në 2 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
2 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numëron deri në dhjetë.</li> <li>Ka njohuri fillestare të formave dhe ngjyrave.</li> <li>Mund të japë informacione të tilla, si: emri, moshë, adresa e përgjithshme, pjesëtarët e familjes e kështu me radhë.</li> <li>Bën zgjedhje të thjeshta si, për shembull, çfarë të hajë, çfarë të veshë, veprimtari që duhen bërë.</li> <li>Bën lëvizje më të mira sy-dorë: mund të mbërthejë objekte, mund t'i zbërthejë ato; mund të vërë objekte të mëdha në dërrasën me vrima.</li> <li>Fillon të përdorë objekte për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë bërë.</li> <li>Ndan mbi bazën e një kriteri (të tëra të kuqe, të tëra të rrumbullakëta e kështu me radhë).</li> <li>Pëlqen të kuptojë situatat.</li> <li>Përfshihet në veprimtari të vetëzgjedhura për periudha më të gjata kohore.</li> <li>Zbulon lidhjen shkak-pasojë.</li> <li>Di se ku duhet të jenë personat e njohur dhe vëren mungesën e tyre.</li> <li>Kupton, shpreh dhe përcakton vendin ku i dhemb.</li> <li>Tregon për objekte dhe ngjarje jo të drejtpërdrejta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ngjit shkallët pa ndihmë (por jo duke alternuar këmbët që në fillim); ka nevojë për ndihmë në zbritjen e shkallëve.</li> <li>Mban ekuilibrin me një këmbë (për pak çaste), hidhet lart e poshtë, por mund të rrëzohet.</li> <li>Ngjitet në karrige, rrotullohet dhe ulet.</li> <li>Përdor këmbët për të ngarë lodrat me rrota.</li> <li>Hedh një top të madh për tokë pa humbur drejtpeshimin.</li> <li>Ndërton një kullë me gjashtë blloqe.</li> <li>Përdor një lugë për vetushqyerje.</li> <li>Vesh këpucët.</li> <li>Mban një kupë apo safë të vogël në një dorë.</li> <li>Zbërthen komçat e mëdha, përdor zinxhirët e mëdhenj.</li> <li>Hap dyert duke lëvizur dorezat.</li> <li>Mban me grusht bojërat e mëdha të dhjamt; shkarravit.</li> <li>Vizaton rrathë dhe bën pika.</li> <li>Fillon të përdorë dorën e preferuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bëhet i qëndrueshëm emocionalisht, por është ende pre e ndryshimeve të humorit.</li> <li>Mëson të ndahet nga kujdestari për periudha të shkurtra kohore.</li> <li>Një identitetin e vet.</li> <li>Bëhet i vetëdijshëm për kufizimet që ka; thotë shpesh “jo”.</li> <li>Krijon një ndjenjë të veçantë pozitive të vetes përmes shqyrtimit të vazhdueshëm të mjedisit.</li> <li>Vazhdon të zhvillojë aftësi komunikuese si reagim ndaj përgjigjeve gjithnjë e më të mëdha të të tjerëve.</li> <li>I paduruar; e ka të vështirë të presë për t'i bërë gjërat me radhë.</li> <li>Pëlqen të “ndihmojë” me punët e shtëpisë; imiton veprimtari të përditshme (mund të përpiqet të çojë në banjë një lodër, të ushqejë një kukull).</li> <li>Sillet si “shef” me prindërit dhe kujdestarët; u jep atyre urdhra, bën kërkesa dhe pret që t'i plotësohen menjëherë nga të rriturit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Siguron materiale dhe përvoja për ta angazhuar fëmijën në mësimin e koncepteve të hershme si format, ngjyrat e kështu me radhë.</li> <li>Luan lojëra që përdorin topa; sjell triçikle si dhe lodra të tjera që inkurajojnë zhvillimin motorik.</li> <li>Përfshihet në veprimtari të cilat përmbajnë mbajtjen e radhës.</li> <li>I lë fëmijës “kohë më vete” për të krijuar pavarësi si dhe për të pakësuar ankthin e ndarjes.</li> <li>Beson se fëmija do të ndjekë rregullat, por mbetet i duruar kur fëmija i harron ato.</li> <li>E mëson dhe e lejon fëmijën që të zhvillojë aftësi vetëdihmuese (veshja, ushqimi, punët e shtëpisë).</li> <li>I komunikueshëm dhe bisedues; përdor gjuhën për të lexuar, për të kënduar e kështu me radhë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbush kova dhe legenë të mëdhenj me ujë; u jep fëmijëve lugë dhe kupa mase, shishe plastike si dhe sfungjerë, për të luajtur me to në ujë.</li> <li>Nëse fëmija lejohet që të shikojë TV, sigurohu që një i rritur të jetë i pranishëm dhe të ndërveprojë me fëmijën për ta bërë shikimin e TV-së një përvojë më aktive.</li> <li>Shko në një park, në një fushë apo një vend tjetër ku fëmija mund të vrapojë, të luajë me top, të kacavirret dhe të përdorë trupin e tij/e saj.</li> </ul>

Marrë nga:  
[www.acetonline.org/child\\_dev\\_milestone.pdf](http://www.acetonline.org/child_dev_milestone.pdf)  
[uppu.org](http://uppu.org)  
[unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf)  
[en.wikipedia.org/wiki/Child\\_development\\_stages](http://en.wikipedia.org/wiki/Child_development_stages)  
[www.dphhs.mt.gov/cfsd/](http://www.dphhs.mt.gov/cfsd/)  
[www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk](http://www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk)  
<http://www.ncc.org/Curriculum/play.activities.html>  
<http://www.livestrong.com/article/98760-language-development-activities-two-year-olds/>  
<http://littlechildren.wordpress.com/2007/11/29/cognitive-development-activities-for-3-to-5-year-olds/>

## Fazat zhvillimore

Mosha e lojës: 3 deri në 5 vjeç

Mosha	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
3 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kopjon rrrathë e kryqe; vizaton njerëz me kokë.</li> <li>Zgjeron me shpejtësi fjalorin, përfshin fjalë në shumës.</li> <li>Zhvillon biseda të thjeshta.</li> <li>Pëlqen përsëritjet e historive të preferuara.</li> <li>Jep komente përkatëse gjatë historive, veçanërisht gjatë atyre historive që janë të lidhura me ngjarje të shtëpisë dhe të familjes.</li> <li>I pëlqen të shikojë librat dhe mund të hiqet sikur po u “lexon” të tjerëve apo të hiqet se po u “shpjegon” pikturat.</li> <li>I pëlqejnë historitë me gjëgjëza, hamendësime dhe me të papritura.</li> <li>Kupton madhësinë.</li> <li>Fillon të kuptojë sekuencat e kohës (p.sh., përpara drekës).</li> <li>Numëron dhe rregullon objekte.</li> <li>Fillon të mendojë rreth pasojave.</li> <li>Përqendrohet për periudha më të gjata kohore.</li> <li>Jep përgjigje të përshtatshme.</li> <li>Ndjek udhëzime me dy hapa.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Qëndron në këmbë dhe ecën në majë të gishtërinjve.</li> <li>Ngjit dhe zbrit në mënyrë të pavarur shkallët.</li> <li>Mund të ecë mbrapsht.</li> <li>Mund ta gjuajë topin me bindje në vetvete.</li> <li>Hidhet nga shkallë të ulëta.</li> <li>Pedalon një triçikël.</li> <li>Hap një nga një faqet e librit.</li> <li>Mund të vizatojë një fytyrë.</li> <li>Ndërton ura me blloqe kur i tregohet se si.</li> <li>Zbërthen komça.</li> <li>Hap e mbyll zinxhirët.</li> <li>Bën vargje me gogla të mëdha.</li> <li>Pikturon me një furçë të madhe; pret me gërshërë.</li> <li>Mund të ruajë ekuilibrin duke qëndruar me një këmbë.</li> <li>Mban siç duhet gërshërët.</li> <li>Përdor kapje treshe (dy gishtat e parë dhe gishtin e madh) kur mban bojëra dhjami apo stilolapsa.</li> <li>Pëlqen të luajë me plastelinë; e shtyp, e rrotullon dhe e shtrydh atë.</li> <li>Mund të fillojë të tregojë se cilën dorë preferon të përdorë.</li> <li>Zakonisht arrin kontrollin e plotë të urinimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon vetëdije më të madhe shoqërore.</li> <li>Luan në dyshe apo treshe duke ndarë ide; lojë në grup.</li> <li>Mund të ketë shokë/shoqe të ngushtë.</li> <li>Tregon në mënyrë spontane ndjenja të ngrohta për shokët me të cilët luan zakonisht.</li> <li>Shpreh një gamë të gjerë emocionesh.</li> <li>Fillon që të mbajë radhën në lojë apo rutina të ndryshme.</li> <li>Zhvillon shumë lojëra me shokë e shoqe, pa dallim.</li> <li>Forcon ndjenjën e identitetit gjinor.</li> <li>Rrit pavarësinë, por ende ka nevojë për mbështetje nga të rriturit.</li> <li>Ka frikë se mos humbet kujdestarët.</li> <li>Është i qëndrueshëm dhe i sigurt emocionalisht.</li> <li>Mund të tregojë më pak ankth në lidhje me ndarjen prej të rriturve të njohur për të.</li> <li>Mund të tregojë nevojë për një objekt sigurie.</li> <li>Ka një ndjenjë të fortë përkatësie të sendeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Imagjines dhe krijues; mendjehapur në mbështetjen e këndvështrimit artistik të fëmijës.</li> <li>Miqësor; shpalos cilësinë e të qenurit një mik i mirë.</li> <li>I dhembshur në drejtime të ndryshme: fjalë, veprime, ide krijuese.</li> <li>Mendon përpara se të veprojë, veçanërisht kur zemërohet apo nevrikoset, pasi kjo mund të kuptohet gabim nga fëmija si mënyra e duhur për të reaguar.</li> <li>E lejon fëmijën që të zhvillojë aftësi vetëndihmuese dhe të kujdeset për veten.</li> <li>Beson se fëmija do t'i ndjekë rregullat, por tregohet i duruar kur fëmija i harron.</li> <li>Dëgjon pyetjet e fëmijës dhe i përgjigjet me sinqeritet.</li> <li>E lë fëmijën të krijojë histori imagjinare, por e korrigjon butësisht, sipas nevojës (p.sh., nëse këto histori fëmija po i përdorur për të mbuluar gabime).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Siguron kukulla dhe mjete skenike të thjeshta, si kupa dhe pjata, për të inkurajuar imagjinatën dhe dramalizimet.</li> <li>Siguron veprimtari krijimi vargësh, prerjeje dhe ngjitjeje, për të përmirësuar aftësitë e vogla motorike.</li> <li>Luan lojëra të cilat kërkojnë drejtpeshim trupor.</li> <li>E ndihmon fëmijën që të mbërthejë perçina dhe të hapë e të mbyllë zinxhirin e rrobave të tij/të saj.</li> <li>Lexon libra apo materiale të tjera me fëmijën – e lë fëmijën që të “lexojë” apo të flasë rreth disa prej pjesëve.</li> <li>Rrit kohën e lojës pa prindin apo me prindin jo shumë afër.</li> <li>Luan “gjeje” apo “çfarë do të bëje sikur ...” si dhe lojëra të tjera me fjalë.</li> <li>E përfshin fëmijën në krijimin e programeve apo caktimin e ngjarjeve të rëndësishme në kalendar.</li> <li>Ndan rrobat e palara (sipas ngjyrës, llojit apo të zotit të tyre).</li> </ul>

## Fazat zhvillimore

Moshë e lojës: 3 deri në 5 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
4 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të dallojë që disa fjalë të caktuara tingëllojnë në mënyrë të përafërt.</li> <li>Gjen 18 deri 20 germa shtypi; shkruan “fjalë” e nganjëherë edhe emrin e vet.</li> <li>Fillon të lexojë libra të thjeshtë, si libra alfabeti me vetëm pak fjalë në faqe dhe shumë piktura (vetëm pak fëmijë e bëjnë këtë).</li> <li>I pëlqejnë historitë rreth mënyrave se si rriten gjallesat apo se si funksionojnë gjërat.</li> <li>Kënaqet shumë me lojëra fjalësh, duke krijuar një gjuhë fëmimore.</li> <li>Kupton koncepte, si: “më e larta”, “më e madhja”, “e njëjta” dhe “më shumë”; përzgjedh pikturën që ka “më shumë shtëpi” apo “qentë më të mëdhenj”.</li> <li>Numëron përmendësh deri në 20 apo më shumë.</li> <li>Numëron në një mënyrë më logjike dhe racionale deri në 10.</li> <li>Kupton sekuencën e ngjarjeve të përditshme: “Kur ngrihem në mëngjes, vishemi, hamë mëngjesin, lajmë dhëmbët dhe shkojmë në shkollë”.</li> <li>Mund të njohë dhe të identifikojë pjesët që mungojnë (të njerëzve, të makinave, të kafshëve, objekteve) kur shikon pikturat.</li> <li>Është shumë i zoti në tregimin e historive.</li> <li>Ndjek udhëzimet me dy apo tre hapa të dhënë individualisht apo në grup.</li> <li>Fillon të përdorë kohën e shkuar të foljeve, paçka se jo gjithmonë saktësisht nga gramatikore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të marrë nishan, të hedhë dhe të kapë një top të madh.</li> <li>Ecën mbrapsht dhe drejt.</li> <li>Mund t'i lajë vetë dhëmbët.</li> <li>Mbërthen dhe zberthen rrobat.</li> <li>Mund të bëjë një lojë formuese me 12 pjesë.</li> <li>Përdor gërsërë; pret sipas konturit.</li> <li>Hidhet dhe qëndron me një këmbë deri në pesë sekonda.</li> <li>Ngjitet lart dhe zbrit poshtë shkallëve pa ndihmë.</li> <li>Gjuan topin përpara.</li> <li>Vizaton një person me dy apo katër pjesë trupore.</li> <li>Vizaton rrrathë dhe katrorë.</li> <li>Fillon të kopjojë disa germa të mëdha shtypi.</li> <li>Hipën në një parmak pa pasur nevojë për ndihmë, ecën vetë mbi të, por nuk mund të zbrësë vetë prej tij.</li> <li>Mund të mbajë gotën pa e derdhur, po që se ecën shumë ngadalë.</li> <li>Mund të kopjojë disa forma dhe germa.</li> <li>Pedalon dhe mban me vetëbesim timonin e një lodre me rrota; merr kthesa, shmang pengesa dhe “trafikun” që has përpara.</li> <li>Ngjit shkallët portative, pemët, pajisjet e këndit të lojërave.</li> <li>Kërcen përmbi objekte 12 cm deri në 15 cm të larta dhe bie me të dyja këmbët të bashkuara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I lëvizshëm, miqësor dhe nganjëherë më shumë entuziast se ç'duhet.</li> <li>Gjendja e humorit ndryshon me shpejtësi dhe në mënyrë të paparashikueshme, qesh në një minutë, qan në tjetrën.</li> <li>Mund të ketë shpërthime zemërimi për mërzitje të vogla (për një strukturë blloqesh të cilën nuk po e bën dot të qëndrojnë); mund të varë buzët sepse ka mbetur jashtë loje.</li> <li>Janë të zakonshëm shokë apo bashkëluajtës imagjinare; zhvillon bashkëbisedime dhe ndan emocione të forta me këtë shok të padukshëm.</li> <li>Mburret, ekzagjeron dhe del jashtë të vërtetës me histori të sajara, por me pretendime trimërie; vë në provë kufijtë me të folur “të pistë”.</li> <li>Bashkëpunon me të tjerët.</li> <li>Merr pjesë në veprimtari grupi.</li> <li>Shfaq krenari për arritjet; kërkon aprovim të shpejtë nga të rriturit.</li> <li>Shfaqet shpeshherë egoist, por pret radhën nën disa kushte të caktuara; merret me llafë me fëmijët e tjerë.</li> <li>Këmbëngul dhe përipiqet t'i bëjë gjërat vetë, por mund të pezmatohet deri në pikën e shpërthimeve të zemërimit.</li> <li>I pëlqejnë dramatizimet dhe veprimtaritë gjoja të vërteta.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Siguron përvoja konkrete mësimore për të mbështetur mësimin akademik.</li> <li>Ka durim në dhënien e ndihmës ndaj fëmijës, për t'i mësuar informacione të tilla, si: numrat, germat e emrave dhe tingujt.</li> <li>Nuk zemërohet me fëmijën dhe e lejon atë të bëjë gabime; jep dhe rijep mësim.</li> <li>Flet dhe shpjegon me butësi ndryshimin mes faktit dhe sajësës.</li> <li>Shmang identifikimin e gënjeshtrave të fëmijës për shkak se fëmija mund të mos jetë i vetëdijshëm për atë që po thotë.</li> <li>Siguron materiale shkrimi dhe artistike në mënyrë që fëmija të mos eksperimentojë me shkrimin në vende të papërshtatshme.</li> <li>E inkurajon fëmijën që të luajë me fëmijë të tjerë.</li> <li>Jep mësim dhe jep shembullin në karakteristikat e të qenurit një shok i mirë.</li> <li>Nuk merr menjëherë anën e fëmijës, por e udhëheq atë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e situatave kur ai është në konflikt me të tjerët.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përgatit ushqime të thjeshta të ndërmjetme së bashku me fëmijën ose e përfshin fëmijën gjatë gatimit.</li> <li>Loja me rërë dhe ujë mund të jetë e rrëmujshme, por ajo është një mënyrë konkrete për ta ndihmuar fëmijën të kuptojë kufijtë dhe rregullat.</li> <li>Lojërat me blloqe dhe ato ndërtuese e ndihmojnë fëmijën të kuptojë parimet fillestare të inxhinierisë dhe të arkitekturës.</li> <li>Loja me plastelinë rrit krijimtartinë dhe zhvillimin e imët motorik (ka receta të thjeshta për krijimin në shtëpi të plastelinës).</li> <li>Hiq një vizë me shkumës në tokë dhe lëre fëmijën të ecë mbi të a thua se është një urë apo një litar ekuilibri cirku.</li> <li>Këndo apo recito vjersha me gjuhë fëmimore (p.sh. , “Një, dy, tre, Maria bën kafe, te spitali numër tre!”).</li> <li>Krijon një libër apo album fotografik që përmban numra, germa dhe fjalë për të rritur të mësuarin.</li> </ul>

## Fazat zhvillimore

Mosha e lojës: 3 deri në 5 vjeç

Mosha	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
4 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshon tonin e zërit dhe strukturën e fjalisë për t'iu përshtatur nivelit të kuptimit të dëgjuarit, si: ndaj vëllait të vogël: “E mbarove qumështin?”; mamasë: “A e piu vëllai të tërë qumështin e vet?”</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Niset, vrapon, ndalet dhe lëviz me lehtësi përreth pengesave.</li> <li>Ndërton një kullë me dhjetë apo më shumë blloqe.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shfaq (shumicën e kohës) agresivitet me fjalë e jo fizik; për të realizuar diçka mund të ulërijë me zemërim, por jo të godasë; kërcënon: “Nuk do të të thërras te ditëlindja ime!”</li> <li>Përdor nofka dhe tallje si mënyra për të përjashtuar fëmijët e tjerë.</li> <li>Krijon marrëdhënie të ngushta me shokët e lojës; fillon të ketë shokë “të ngushtë”.</li> </ul>		
5 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Formon piktura me forma bazë.</li> <li>Kupton konceptin e së njëjtës: e njëjta formë, e njëjta madhësi.</li> <li>Ndan objektet mbi bazën e dy kritereve, si ngjyra dhe forma.</li> <li>Ndan një larmi objektesh në mënyrë që të tëra gjërat në grup të kenë një tipar të përbashkët (p.sh., të tëra janë artikuj ushqimorë apo transporti, apo kafshë).</li> <li>Kupton konceptet e më të voglave apo më të shkurtrave; i vë objektet sipas rendit të madhësisë dhe të gjatësisë.</li> <li>Identifikon objektet përmes pozitës së tyre: i pari, i dyti, i fundit.</li> <li>Numëron përmendësh deri në 20 e lart; shumë fëmijë numërojnë deri në 100.</li> <li>Njeh numrat nga 1 deri në 20 dhe numëron në mënyrë të arsyeshme deri në 20.</li> <li>Kupton konceptin e “më pak se”.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pret me gërhërë sipas kontureve të objektit.</li> <li>Vizaton një person me trup, objekte me pjesë.</li> <li>Riprodhon shumë forma dhe germa.</li> <li>Shfaq një kontroll të mirë të lapsit apo lapustilit; fillon të ngjyrosë përbrenda kontureve.</li> <li>Dora që përdoret më shumë është përcaktuar mjaft mirë.</li> <li>Mund të bëjë një lojë formuese me 20 pjesë.</li> <li>Vishet dhe zhvishet pa ndihmë.</li> <li>Përdor pirunin, lugën dhe nganjëherë një thikë tavoline.</li> <li>Zakonisht i kryen vetë nevojat personale.</li> <li>Ecën së prapthi ose duke vendosur thembrën e njërës këmbë fill pas gishtërinjve të këmbës tjetër.</li> <li>Ngjit dhe zbret pa ndihmë shkallët duke përdorur të dyja këmbët.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I pëlqejnë shokët dhe zakonisht ka një ose dy shokë të ngushtë.</li> <li>Luan në grup, është bujar, pret radhën, ndan lodrat me të tjerët.</li> <li>Merr pjesë në lojëra në grup dhe veprimtari të përbashkëta me fëmijët e tjerë; sugjeron ide imagjinare dhe të përpunuara loje.</li> <li>Tregon ndjenja të ngrohta dhe përkujdesje ndaj të tjerëve, veçanërisht ndaj atyre që i konsideron “poshtë” vetes apo që janë në dhembje (në nevojë).</li> <li>Përgjithësisht i bindur ndaj kërkesave të prindit apo të kujdestarit.</li> <li>Ka nevojë për ngushëllim dhe përkrahje prej të rriturve, por është shumë më pak i hapur ndaj ngushëllimit.</li> <li>Ka vetëkontroll më të mirë mbi emocionet.</li> <li>I pëlqen t'i argëtojë e t'i bëjë njerëzit të qeshin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Angazhon fëmijën në bashkëbisedim me të dhe me fëmijët e tjerë sa më shpesh që të jetë e mundur.</li> <li>I thotë fëmijës se kur do të ndodhin gjërat, si dhe çfarë të presin në situatat që do të vijnë.</li> <li>Njofton përpara mbarimit të kohës; fillon të përdorë orën e murit si një mjet informues vizual.</li> <li>Jep mësim rreth parasë dhe përdorimit të duhur të saj.</li> <li>I lejon fëmijës të jetë i pavarur në praktikën e aftësive vetëndihmuese me kufij të përkufizuar qartësisht (p.sh., cilat rroba janë të përshtatshme për në kishë, sa duhet të zgjasë larja e dhëmbëve).</li> <li>Luan “shtëpiash” për të treguar skenarë të mundshëm dhe se si mund të përballlet me to.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Inkurajo lojë dramatizuese me kukulla teatrale, me veshjen e rrobave e kështu me radhë.</li> <li>Veprimtarive të përjavshme shtoi veprimtari të tipit “shfaq dhe ndaj” (apo trego dhe thuaj).</li> <li>Siguro ose krijo lojëra formuese. Ndihmoje fëmijën gjatë përpjekjes së parë për zgjidhjen e formueses së re.</li> <li>Zhvillo aftësitë matematikore, duke përdorur para lodër, duke ndarë lodrat në kategori si dhe duke përdorur makina llogaritëse.</li> <li>Krijo një tabelë rutine; kërkoji fëmijës të vendosë nga një grremç apo shenjë tjetër pas çdo pune të mbaruar.</li> <li>Jep mësim (apo kërkoji një personi tjetër të japë mësim) mënyrën e duhur për t'u kredhur në ujë apo për kollotumba.</li> </ul>



## Fazat zhvillimore

Mosha e lojës: 3 deri në 5 vjeç

Mosha	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
5 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kupton termat errësirë, dritë dhe herët: “U ngrita herët, përpara se të çoheshin të tjerët. Qe ende errësirë.”</li> <li>Bën lidhjen e kohës së orës me programin ditor; disa fëmijë mund të tregojnë sa është ora (jo me minuta).</li> <li>Di për çfarë shërben kalendari.</li> <li>Kupton dhe identifikon monedhat; fillon të numërojë dhe të kursejë para.</li> <li>Njeh alfabetin dhe gërmat e vogla dhe të mëdha të shtypit.</li> <li>Kupton konceptin e gjysmës.</li> <li>Ngre pyetje të panmërta, si: Përse? Çfarë? Ku? Kur?</li> <li>I zellshëm për të mësuar gjëra të reja.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ngrihet, ecën dhe zbret vetë nga trau i ekuilibrit.</li> <li>Përdor këmbën e preferuar.</li> <li>Hidhet, bën kullotumba, kolovitet, ngjitet.</li> <li>Kap një top të hedhur nga 1 m larg.</li> <li>I jep një triçikle apo një lodre me rrota me shpejtësi dhe aftësi në timon; disa mësojnë t’u japin biçikletave, por zakonisht me rrota mësimore.</li> <li>Hidhet apo kërcen përpara dhjetë herë rresht pa u rrëzuar.</li> <li>Ruan drejtpeshimin, duke qëndruar me secilën këmbë me kontroll të mirë për dhjetë sekonda.</li> <li>Ndërton struktura tridimensionale me blloqe të vogla, duke ndjekur shembullin e një vizatimi apo modeli.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krenohet me arritjet.</li> <li>Përfshihet tërësisht në veprimtari.</li> <li>Ka frikë nga fantazmat, gjërat poshtë krevatit.</li> <li>Merakoset se mos të tjerët nuk e pëlqejnë.</li> <li>Zhvillon një ndjenjë të mirë vetëdijeje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjen kohë të dëgjojë fëmijën t’i tregojë se si e kaloi ditën e tij/e saj apo për mendimet dhe idetë që ka.</li> <li>E çon fëmijën nëpër vende të ndryshme për të ushtruar dhe për të zhvilluar aftësitë motorike.</li> <li>Është miqësor dhe i sjellshëm me të tjerët.</li> <li>Flet dhe shpjegon me butësi dallimet mes fakteve dhe të paqenave.</li> <li>Nuk zemërohet dhe e lejon fëmijën që të bëjë gabime; jep dhe rijep mësim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gatimi mund të jetë një mënyrë konkrete se si t’i mësojmë fëmijës që të presë; lëre fëmijën që t’i provojë perimet e supës përpara dhe pasi të jenë gatuar, për të bërë krahasimin e shijes së tyre.</li> </ul>

Marrë nga:

[www.acetonline.org/child\\_dev\\_milestone.pdf](http://www.acetonline.org/child_dev_milestone.pdf)[upppua.org](http://upppua.org)[unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf)[en.wikipedia.org/wiki/Child\\_development\\_stages](http://en.wikipedia.org/wiki/Child_development_stages)[www.dphhs.mt.gov/cfsd/](http://www.dphhs.mt.gov/cfsd/)[www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk](http://www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk)<http://www.nncc.org/Curriculum/play.activities.html><http://www.livestrong.com/article/98760-language-development-activities-two-year-olds/><http://littlechildren.wordpress.com/2007/11/29/cognitive-development-activities-for-3-to-5-year-olds/>

## Fazat zhvillimore

Moshë shkollë: 6 deri në 12 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
6–7 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund ta ketë të vështirë të kalojë nga gjysmë dite qëndrim në kopsht te një ditë e plotë në klasën e parë.</li> <li>Dallon të djathtë nga e majta.</li> <li>Përdor krahasime (“më e madhe sesa një makinë”).</li> <li>Dëshiron të dijë se si foshnja u fut në mitrën (uterusin) e s’ëmës dhe si do të dalë prej andej.</li> <li>Di të thotë sa është ora.</li> <li>Kupton që vdekja është përfundimtare dhe që edhe ai/ajo do të vdesë një ditë.</li> <li>Tregon më shumë aftësi për të përshkruar përjetimet dhe flet për mendimet dhe ndjenjat e veta.</li> <li>Mund të shkruajë së prapthi disa germa shtypi.</li> <li>Pëlqen të planifikojë dhe të ndërtojë.</li> <li>Zgjeron fjalorin e folur dhe të dëgjuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lidh dhe zgjidh këpucët.</li> <li>Mund të bëjë fletën apo kollotumba.</li> <li>Realizon kërcime më të gjata e më të larta me lëvizje më të koordinuara trup-këmbë.</li> <li>Lëviz krahët, këmbët dhe trupin për t’iu përshtatur një muzike me ritëm të shpejtë.</li> <li>I pëlqen të provojë forcën muskulore dhe aftësitë.</li> <li>Pëlqen kapërcimet, t’i japë biçikletës, të rrëshqasë me patina dhe të bëjë patinazh.</li> <li>Shtyn objekte të vogla (p.sh., peta guri) ndërkohë që luan posta-bizi.</li> <li>Kap një top të vogël që i pasohet.</li> <li>Lëvizjet e imëta motorike janë të mirëkoordinuara; shkruan pastër me germa shtypi dhe kopjon figura të ndërlikuara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E di që ndjekja e rregullave është e rëndësishme, por dëshiron që të fitojë dhe mund të jetë i gatshëm të bëjë hile për këtë qëllim.</li> <li>Luan edhe me djem, edhe me vajza.</li> <li>Mund të ketë frikë prej kafshëve, insekteve apo zjarrit dhe të refuzojë t’u afrohet atyre; një frikë tjetër mund të jenë imagjinare, si, për shembull, fantazmat dhe shtrigat.</li> <li>Ndihmon në punët e shtëpisë.</li> <li>Nënqesh kur flitet rreth temave seksuale.</li> <li>Shpesh shqetësohet kur mendon që prindërit mund t’i vdesin.</li> <li>Ka një kuptim më të fortë të së duhurës dhe të gabuarës.</li> <li>Fiton më shumë pavarësi nga prindërit dhe familja.</li> <li>Fillon të përqendrohet më pak te vetja dhe tregon më shumë preokupim për të tjerët.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktiv fizikisht, mbështet nevojën e fëmijës për t’u përgatitur për sporte konkurruese apo që luhen mbi bazën e rregullave.</li> <li>I lejon fëmijës që t’i ndajë mendimet dhe emocionet; nuk i etiketon dhe as nuk i konsideron ato si “të parëndësishme”.</li> <li>I qetë dhe i përmbajtur kur fëmija tregon për frikën që ka; nuk transferon energjinë e vet të frikës te fëmija.</li> <li>Dëgjon me kujdes pyetjet e fëmijës si dhe e ndihmon fëmijën që të gjejë përgjigjet.</li> <li>Siguron veshje të cilat do t’i bëjnë të mundur fëmijës që të praktikojë zhvillimin e imët motorik.</li> <li>Ka besim tek ajo që fëmija mund të bëjë si dhe te kompetencat e fëmijës për të kuptuar udhëzimet.</li> <li>I njëtrajtshëm në zbatimin e rregullave.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viziton librari, muze si dhe vende të tjera mësimore.</li> <li>Krijon rregulla të përbashkëta; sigurohet që ato të jenë specifike dhe që fëmija i kupton; i shpreh rregullat me shkrim si një kujtesë vizuale ndaj fëmijës.</li> <li>I fton miqtë dhe të afërmit për lojëra të thjeshta në grup (p.sh., stafetë, raqi raqi kikiko e kështu me radhë (suvenirët apo çmimet për fituesin mund t’i bëjnë lojërat më të zjarrta).</li> <li>Etiketo objekte në shtëpi; fillo duke vënë emrin e fëmijës te gjërat e veta; pastaj kërkon ndihmën e fëmijës në etiketimin e gjërave në shtëpi (kripë, sheqer, kafe e kështu me radhë)</li> </ul>
8–9 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Leximi mund të kthehet në një interes kryesor.</li> <li>Aftësi e shtuar për zgjidhjen e problemeve.</li> <li>Ka interes për magjinë dhe truket e ndryshme.</li> <li>Hapësirë kohore më e gjatë përqendrimi.</li> <li>Pëlqen të krijojë koleksione të ndërlikuara.</li> <li>Fillon të kuptojë idenë e kalimit të kohës si dhe konceptet e ditës, datës dhe kohës të lidhura me numrat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Koordinim i përmirësuar dhe reagim në kohë.</li> <li>Vetëpërfshihet në sporte konkurruese.</li> <li>Përmirëson aftësi fizike të cilat janë zhvilluar tashmë.</li> <li>Rafinon kontrollin e gishtërinjve.</li> <li>Rritet qëndrueshmëria; mund të vrapojë apo të notojë më larg.</li> <li>Mund të fillojë pubertetin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dëshiron të pëlqehet dhe të pranohet.</li> <li>Qëndrimi me shokët bëhet gjithnjë e më shumë i rëndësishëm.</li> <li>I interesuar në rregulla dhe rituale.</li> <li>Vajzat dëshirojnë të luajnë më shumë me vajza, djemtë me djem.</li> <li>Rolet shoqërore kuptohen më mirë.</li> <li>Mund të ketë një shok të ngushtë si dhe një armik.</li> <li>Ka dëshirë të fortë për të performuar mirë, për t’i bërë gjërat siç duhet.</li> <li>Fillon t’i shikojë gjërat nga këndvështrimi i një fëmije tjetër, por vazhdon të jetë i mjaft i përqendruar te vetja.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E lë fëmijën të ndërveprojë si dhe të kujdeset për një fëmijë më të vogël.</li> <li>Është aktiv në shkollë, në kishë si dhe në vende të tjera në komunitet, në të cilat fëmija zhvillon miqësi.</li> <li>Flet me fëmijën rreth presionit nga bashkëmoshatarët.</li> <li>Dëgjon me kujdes dhe diskuton rreth shokëve dhe rezultateve shkollë të fëmijës.</li> <li>Jep mësim rreth kostove si dhe rëndësisë së kursimit për një qëllim të caktuar.</li> <li>Tregon arsyen përse disa gjëra janë të duhura, ndërsa disa të tjera të gabuara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndihmoje fëmijën që të fillojë mbajtjen e një ditari të mendimeve dhe pyetjeve të tij/ të saj. Bjer dakord që njëri prej prindërve mund t’i lexojë ato që ai/ajo shkruan atje (në prani të fëmijës).</li> <li>Jepi fëmijës një sirtar apo kuti në të cilën të mbajë sendet vetjake.</li> <li>Përfshije fëmijën në blerjen e rrobave të veta apo materialeve shkollë; trego se sa mund të shpenzosh për këto gjëra.</li> <li>Organizo një mbrëmje ku disa fëmijë mund të flenë në shtëpinë tënde ose lejoje fëmijën që të luajë te shtëpia e një fëmije tjetër. Trego për gjërat që duhen bërë dhe për ato që nuk duhen bërë në shtëpinë e tjetrit</li> </ul>



## Fazat zhvillimore

Mosha shkollare: 6 deri në 12 vjeç

Mosha	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
8–9 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fillon mendimin logjik: nuk pranon thjesht diçka që është perceptuar si e vërtetë, por fillon të zbatojë njohurinë dhe përvojën personale për të përcaktuar nëse diçka ka apo jo kuptim.</li> <li>Kupton dhe vë në zbatim koncepte matematikore.</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>E ka të vështirë të përballet me kritika apo dështime.</li> <li>I shikon gjërat ose të bardha, ose të zeza; ose të drejta, ose të gabuara; ose të mrekullueshme, ose të tmerrshme, me pak zonë gri ndërmjet.</li> <li>Kërkon një ndjenjë sigurie në grup, sportet e organizuara dhe nëpër klube shkollare.</li> <li>Në përgjithësi pëlqen të kujdeset për fëmijë më të vegjël si dhe të luajë me ta.</li> <li>Mund të mërzitet kur nuk i kushtohet vëmendje sjelljes së mirë apo rezultateve të tij/të saj në shkollë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I besueshëm, e kupton nevojën e fëmijës për intimitet (privatësi) dhe për të mbajtur të fshehta.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E regjistron fëmijën në veprimtari jashtëshkollore të tilla, si: sportive, artistike apo muzikore.</li> </ul>
10–12 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>I zoti në konceptet kohore.</li> <li>Mund të planifikojë dhe të kuptojë më shumë shkakun dhe pasojën, me racionalitet më të lartë si dhe me aftësi logjike.</li> <li>I aftë për të kuptuar koncepte pa pasur përvojë në terren.</li> <li>I interesuar në leximin e historive të fantashkencës, revistave si dhe manualeve ndërtuese të projekteve të ndryshme.</li> <li>Mund të krijojë një interes të veçantë për koleksione apo hobe të ndryshme.</li> <li>Shfaq një interes të madh në diskutimin e një karriere të ardhshme.</li> <li>Fantazon dhe sheh ëndrra me sy hapur për të ardhmen.</li> <li>Vërehet përdorimi i shtuar i një lloj gjuhe të ndikuar prej bashkëmoshatarëve.</li> <li>Mund të zbatojë informacion nga një situatë të tjetra.</li> <li>Preferencë gjithnjë e më e madhe për tema të caktuara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vajzat janë përgjithësisht deri dy vjet përpara djemve në pjekurinë fizike.</li> <li>Rritet forca trupore dhe zhërvjelltesia e dorës.</li> <li>Përmirëson koordinimin dhe kohën e reagimit.</li> <li>Zhvillon proporcione trupore të ngjashme me ato të një të rrituri.</li> <li>Fillon puberteti – zhvillim i dukshëm seksual, menstruacione, ndryshim i zërit e kështu me radhë.</li> <li>Shtimi i erës së trupit është i zakonshëm.</li> <li>Vajzat mund të përjetojnë një vërshim energjie.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Toleron më mirë pezmatimin.</li> <li>Ka nevojë për ndjenja të ngrohta dhe mbështetje nga të rriturit, paçka se shmang ngushëllimin fizik.</li> <li>Ka mendim të përqendruar me një ndjenjë të fortë të drejtësisë.</li> <li>Fillon të shikojë konfliktet mes vlerave të bashkëmoshatarëve si dhe vlerave të prindërve.</li> <li>Fillon t'i shikojë prindërit si dhe figurat autoritare si qenie njerëzore të gabueshme; mund të nënvlerësojnë apo të kundërshtojë hapur autoritetin e të rriturit.</li> <li>Ritualet, rregullat, kodet e fshehta dhe gjuha e sajuar janë të zakonshme.</li> <li>Pëlqen të qenurit anëtar i një klubi shkollor.</li> <li>Ka një interes të shtuar në sportet konkurruese.</li> <li>Shpërthimet e zemërimit janë më të rralla.</li> <li>Vërehet aftësi e shtuar për t'u përfshirë në konkurrim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E lejon fëmijën që të dalë me shokët ndërkohë që ndodhet në të njëjtën zonë, por jo detyrimisht me ta.</li> <li>Siguron udhëzime të qarta dhe pritshmëri rreth kufijve (koha, vendet ku të shkojë, shokët, veprimtaritë që do të zhvillojë).</li> <li>E bën shtëpinë një vend të sigurt, miqësor dhe akomodues për fëmijët e tjerë, që mund të vijnë për vizitë.</li> <li>Njeh prindërit e lagjes si dhe prindërit e shokëve të fëmijës.</li> <li>Mendjehapur dhe i informuar rreth drogave, alkoolit, pirjes së duhanit si dhe shtatzënisë së adoleshentëve; i lë fëmijët të shprehin ndjenjat e tyre për këto probleme.</li> <li>I besueshëm dhe i parashikueshëm, në mënyrë që fëmija të ushqejë mirëbesim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zëvendëson ca nga koha e Tv-së me biseda familjare; shikon së bashku me fëmijën programe të Tv-së, të cilat inkurajojnë diskutime të shëndetshme familjare.</li> <li>Gatuan biskota apo jep mësim për receta tradicionale familjare.</li> <li>Jep mësim për lojëra pozitive me letra apo me kuti, të cilat fëmija mund t'i luajë me shokët.</li> <li>Inkurajon lojën në natyrë (p.sh., me litar, patina, topa).</li> <li>I jep fëmijës përgjegjësi për një kafshë shtëpiake të familjes. E kujton fëmijën për detyrat e ngarkuara.</li> <li>E mëson fëmijën se si të notojë e të qëndrojë në ujë apo e regjistron në kurse.</li> <li>Shkon në kamping apo për ekskursion.</li> <li>Krijon tradita familjare (shkëmben dhurata, surpriza për ditëlindje, ushqime për pushime e kështu me radhë).</li> </ul>

**Fazat zhvillimore**

Moshë shkollore: 6 deri në 12 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
10–12 vjeç			<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillon dhe vë në provë vlerat dhe besimet të cilat do të kanalizojnë sjelljen e tanishme si dhe atë të ardhshme.</li> <li>Ka një identitet të fortë grupi; e përkufizon gjithnjë e më shumë veten përmes bashkëmoshatarëve.</li> <li>Fiton një ndjenjë arritjeje të bazuar mbi një forcë fizike dhe vetëkontroll më të madh.</li> <li>Përkufizon konceptin për veten pjesërisht mbi bazën e suksesit në shkollë.</li> <li>Fillon të ndjejë tërheqje ndaj një personi të rëndësishëm për të.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fal kur fëmija dështon dhe kërkon ndjesë kur e ka zhgënjyer fëmijën.</li> <li>Jep mësim rreth respektit, duke dhënë shembullin personal.</li> <li>Gëzohet për çdo arritje të fëmijës dhe ka besim për të ardhmen e tij/e saj.</li> <li>Siguron udhëzime, por nuk këmbëngul, a thua se çdo situatë ka vetëm një zgjidhje të mundshme</li> </ul>	

Marrë nga:

[www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk](http://www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk)[www.ncc.org/curriculum/play.activities.html](http://www.ncc.org/curriculum/play.activities.html)[www.nrcfppp.org](http://www.nrcfppp.org)[www.todayparent.com](http://www.todayparent.com)[www.cdc.gov/ncbddd/childdevelopment](http://www.cdc.gov/ncbddd/childdevelopment)[http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial\\_ChildDevelopment\\_Milestones.pdf](http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial_ChildDevelopment_Milestones.pdf)[www.greatschools.org/special-education/health/903-developmental-milestones-your-8-year-old-child.gs](http://www.greatschools.org/special-education/health/903-developmental-milestones-your-8-year-old-child.gs)[calswec.berkeley.edu](http://calswec.berkeley.edu)

## Fazat zhvillimore Adoleshenca: 12 deri në 18 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
12–14 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ka më shumë aftësi për të menduarin kompleks si dhe rregullsi më të madhe të menduari.</li> <li>Është më shumë i aftë për të shprehur ndjenja përmes të folurit.</li> <li>Është kryesisht i interesuar në të tashmen dhe në të ardhmen e afërt.</li> <li>Ka mundësi më të madhe për të punuar.</li> <li>Të mësuarit bëhet i qëllimshëm, jo vetëm për të tashmen, por gjithashtu për të ardhmen.</li> <li>Vë në zbatim aftësi themelore për subjekte më komplekse.</li> <li>Ka një interes të vazhduar për ide, vlera, çështje shoqërore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Puberteti ka filluar apo është arritur; me rritjen e re mund të shfaqen paqartësi dhe dyshime të vetja.</li> <li>Eksperimenton dhe bëhet kureshtar për përmbushjen e kënaqësive personale si dhe seksualitetin.</li> <li>Femrat: <ul style="list-style-type: none"> <li>Dalin plotësisht qimet tek organet gjenitale.</li> <li>Qimet e sqetullave janë në sasi të moderuar.</li> <li>Vazhdon rritja e gjoksit.</li> <li>Menstruacionet janë në funksionim të rregullt.</li> <li>Rënie e rritjes së gjatësisë.</li> <li>Ka ovulim (lindshmëri).</li> <li>Rritje e moderuar muskulore si dhe rritje e aftësive motorike.</li> </ul> </li> <li>Meshkujt: <ul style="list-style-type: none"> <li>Qimet tek organet gjenitale marrin ngjyrë, përdridhen.</li> <li>Qimet e sqetullave fillojnë të dalin pas qimeve tek organet gjenitale.</li> <li>Penisi, testikujt dhe qesja e herdheve vazhdojnë të rriten.</li> <li>Merr hov rritja e shtatit.</li> <li>Lëshim i farës.</li> <li>Timbri i zërit ulet ndërkohë që laringu zgjerohet.</li> <li>Dalin mustaqet.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Preokupim më i madh për imazhin trupor, paraqitjen e jashtme dhe rrobat.</li> <li>Përqendrimi te vetja me kalime të shpeshta mes pritshmërive të larta dhe mungesës së vetëbesimit.</li> <li>Luhatje emocionale.</li> <li>Ka më tepër interes dhe ndikohet më shumë nga presioni i ushtruar prej bashkëmoshatarëve.</li> <li>Tregohen më pak ndjenja të ngrohta ndaj prindërve; nganjëherë i sertë dhe nevrrik.</li> <li>Ka ankth nga shtimi i vështirësive të detyrave shkollore.</li> <li>Vë në sprovë kufizimet dhe gjykimet e prindit.</li> <li>Dëshiron të jetë më shpesh me bashkëmoshatarët.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Merr pjesë në veprimtari fizike dhe e inkurajon adoleshentin/adoleshentën që të stërvitet, të hyjë në një skuadër apo të merret me një sport individual.</li> <li>Cakton pritshmëri për punët e shtëpisë.</li> <li>Tregon interes të mirëfilltë në shkollën dhe në jetën shoqërore të adoleshentit/të adoleshentes.</li> <li>E ndihmon adoleshentin/adoleshentën që të ndërmarrë zgjedhje të shëndetshme, ndërkohë që e inkurajon atë të marrë vendimet e veta.</li> <li>Respekton opinionet, mendimet dhe ndjenjat e adoleshentit/e adoleshentes.</li> <li>Vë rregulla të qarta për kohën që adoleshenti/adoleshentja është vetëm në shtëpi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Takon dhe nje shokët e adoleshentit/e adoleshentes; i lejon ata të kalojnë kohë produktive në shtëpinë tënde (gatim, sporte, punë prodhuese e kështu me radhë).</li> <li>E mban aktiv adoleshentin/adoleshentën në sporte ekipore apo individuale si dhe në punë shtëpie më komplekse.</li> <li>Përdor kohën e ngrënies së vakteve ushqimore për ta ndihmuar adoleshentin/adoleshentën të mësojë të ndërmarrë zgjedhje të mira rreth ushqimeve, të promovojë një peshë të shëndetshme si dhe të sigurojë kohë për biseda ndër pjesëtarët e familjes.</li> <li>Si familjar (apo si ortakëri prind-fëmijë), dil vullnetar në veprimtari shoqërore apo civile që janë brenda interesit të adoleshentit (p.sh., te liqeni i qytetit, libraria publike, jetimorja).</li> </ul>

## Fazat zhvillimore

Adoleshenca: 12 deri në 18 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
15–16 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fiton kapacitetin për të menduarit abstrakt (ndryshe nga ai konkret); kthehet në të menduarin konkret kur është në stres.</li> <li>• Në të menduarin abstrakt ndërhyjnë ankthi si dhe shpërqendrime madhore.</li> <li>• Kuptohet lidhja shkak-pasojë.</li> <li>• Shumë i përqendruar te vetja.</li> <li>• Ka shprehur punë më të rregullta.</li> <li>• Zbaton njohuritë në situatat e tanishme dhe të ardhshme, si dhe për çështje më të gjera (preokupime sociale, studime akademike).</li> <li>• Aftësi e përmirësuar për të përdorur të folurën për shprehjen e vetes.</li> <li>• Ka një pikëpamje më realiste dhe të qëndrueshme për natyrën e problemeve dhe është më i zoti në zgjidhjen e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arrin 95 për qind të lartësisë së trupit të personit të rritur.</li> <li>• Është më pak i preokupuar për ndryshimet fizike, por shfaq një interes të shtuar në të qenurit personalisht tërheqës.</li> <li>• Ka periudha të gjata veprimtarie fizike e alternuar kjo me letargji.</li> <li>• Ka karakteristika dytësore seksuale.</li> <li>• Vajzat arrijnë shtatlartësinë e plotë; djemtë mund të vazhdojnë të rriten.</li> <li>• Aftësitë e mësuara zhvillohen dhe përsosen.</li> <li>• Djemtë mund të përjetojnë një hov rritjeje.</li> <li>• Femrat: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ka zhvillim të plotë të gjoksit dhe të qimeve të sjetullës.</li> <li>- Ka rënie e rritjes së gjatësisë (për pjesën më të madhe merr fund në moshën 16-vjeçare).</li> </ul> </li> <li>• Meshkujt: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ka qime fytyre dhe trupi.</li> <li>- Ka qime më të dendura tek organet gjenitale dhe tek sjetullat.</li> <li>- Zëri bëhet më i thellë.</li> <li>- Testikujt, penis dhe qesja e herdheve vazhdon të rritet.</li> </ul> </li> <li>• Eksperimentim me trupin (masturbim).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet trupore mund të lëkundin vetëvlerësimin.</li> <li>• Ka nevojë të përballet me ndryshimet e kalimit në moshën e pjekur.</li> <li>• Dëshiron të kalojë më shumë kohë me shokët sesa me familjen.</li> <li>• Presioni nga bashkëmoshatarët ka një ndikim të ndjeshëm.</li> <li>• Vë në provë rregullat dhe kufizimet; konfliktet me prindërit mund të shtohen.</li> <li>• Është kureshtar dhe mund të eksperimentojë me cigare, marijuhanë, alkool etj.</li> <li>• Shokë të së njëjtës gjini dhe veprimtari në grup.</li> <li>• Shfaq ndrojtje, skuqje nga ndrojtja dhe modesti.</li> <li>• Cilësi për të rënë në sy.</li> <li>• Interes më i madh për privatësi.</li> <li>• Preokupim për të qenurit normal.</li> <li>• Vështirësi me ndjenjën e identitetit.</li> <li>• Ka më shumë të ngjarë që të shprehë ndjenja nëpërmjet veprimeve sesa nëpërmjet fjalëve.</li> <li>• Fitojnë rëndësi miqësitë e ngushta.</li> <li>• Kërkon, krahas prindërve, njerëz të rinj për t'i dashur.</li> <li>• Ka prirje për t'u kthyer në sjellje fëmijërore, të luftuara nga veprimtari të tepruara.</li> <li>• Ka një nevojë të vazhdueshme për të shënuar arritje dhe për të qenë i njohur për to.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Flet për çështje të tilla, si: të ftuarit e shokëve në shtëpi, përballja me situata jo të sigurta (emergjencat, zjarri e kështu me radhë) si dhe për kryerjen e detyrave shkollore apo punëve të shtëpisë.</li> <li>• Është i sinqertë dhe i drejtpërdrejtë kur flet rreth temave të ndjeshme si, për shembull, droga, pija, pirja e duhanit dhe seksi.</li> <li>• Ruan një qëndrim plot respekt ndaj zgjedhjeve dhe vendimeve të adoleshentit/adoleshentes, por ende udhëzon dhe shpreh qëndrime nga pozita e prindit.</li> <li>• Shmang përqeshjen e sjelljeve me hope të adoleshentit/adoleshentes.</li> <li>• Inkurajon përvojat me një larmi njerëzish – më të rinj, më të vjetër, nga kultura të ndryshme.</li> <li>• I jep kurajë adoleshentit/adoleshentes, veçanërisht kur vihet nën trysni nga pikëpamjet shoqërore rreth strukturës së turpfit, bukurisë, sjelljes e kështu me radhë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bëj prova të sjelljes që pritet të ketë adoleshenti kur del në takime; shijojë aktivitetin dhe shmang qëndrimin tepër kritik.</li> <li>• Organizoj një mbrëmje familjare me ushqim, që zakonisht nuk shërbehet për darkë, dhe pastaj organizoj një veprimtari të cilën pjesëtarët e familjes e kanë qejf (shikimin e një filmi apo një emisioni të veçantë në Tv, lojëra kutie e kështu me radhë).</li> <li>• Ji i njëtrajtshëm në kryerjen e veprimtarive familjare, si për shembull ngrënie vonë të mëngjesit të dielave, vajtjen në kishë së bashku; lejo disa kohë të caktuara në të cilat fëmijët mund të ftohen që të bashkohen me këto veprimtari tradicionale.</li> <li>• Krijoj një “stendë vizioni” që përmban qëllimet e adoleshentit si dhe hapat që duhen ndërmarrë për t'i realizuar ato.</li> </ul>

## Fazat zhvillimore Adoleshenca: 12 deri në 18 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
17–18 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vë në pikëpyetje burimet e informacionit.</li> <li>Në përgjithësi bëhet më i vetëdijshëm.</li> <li>Ka preferencë të qartë për artet apo shkencat.</li> <li>Shqyrton zgjedhjet në lidhje me arsimimin dhe karrierën e ardhshme.</li> <li>Aftësitë e shtuara për mendime abstrakte dhe për zgjidhje problemesh praktike vihen gjithnjë e më shumë në provë nga kërkesat e lidhura me lirinë dhe/ apo arsimim më të lartë.</li> <li>Mund të ketë mangësi në informacionin për vetësigurinë rreth aftësive dhe mundësive personale.</li> <li>Seriozisht i preokupuar për të ardhmen; fillon të integrojë njohurinë që çon në vendime për të ardhmen.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Femrat</li> <li>Mitra (uterusi) zhvillohet plotësisht aty rreth moshës 18–21-vjeçare.</li> <li>Përfundojnë procese të tjetra pjekjeje fizike.</li> <li>Meshkujt.</li> <li>Zhvillim i plotë i tipareve parësore apo dytësore seksuale.</li> <li>Zhvillimi i muskujve apo i qimeve mund të vazhdojë.</li> <li>Pjekja fizike në thelb e përfunduar; tiparet fizike marrin trajtë dhe tashmë janë fiksuar.</li> <li>Probabiliteti i veprimit mbi bazën e dëshirave seksuale, është shtuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Është pjesërisht apo plotësisht i papërmbytur; shpesh ka vështirësi në kontrollin e emocioneve.</li> <li>Shfaq rënie të preokupimit për autonomi dhe preokupim të shtuar për burime materiale.</li> <li>Gjen vendosmëri ose përpiqet të largohet nga konfliktet në marrëdhëniet familjare.</li> <li>Vazhdon ta drejtojë vëmendjen për nga bashkëmoshatarët dhe vetidentiteti.</li> <li>Është i përshtjelluar dhe i zhgënjyer për mospërputhjet mes vlerave të deklaruara dhe sjelljeve aktuale të familjes dhe të shokëve.</li> <li>Mund të jetë i interesuar për seks si reagim ndaj shtysave fiziko-emocionale dhe si një mënyrë për të marrë pjesë në botën e të rriturve (por jo domosdoshmërisht si një shprehje e intimitetit të arrirë).</li> <li>Mund të shfaqet i lëkundur emocionalisht, i zemëruar, i vetmuar, impulsiv, egoist, i përshtjelluar dhe kokëfortë.</li> <li>Del aktivisht në takime; mund të ndihet në siklet ose t'i pëlqejë veprimtaritë me njerëz të gjinisë tjetër.</li> <li>Mund të jetë i përfshirë kryekëput në një marrëdhënie të vetme romantike; mund të flasë për martesë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vë në pah dhe përgëzon për pjekurinë fizike.</li> <li>Jep informacione të sakta për pasojat e veprimtarisë seksuale.</li> <li>Inkurajon bisedat rreth së ardhmes dhe planifikimin për të.</li> <li>I respektueshëm dhe miqësor; nuk i fut hundët atje ku nuk i takon.</li> <li>Kupton dhe pranon nivelin e tanishëm të interesit për seksin e kundërt.</li> <li>Shmang mosaprovimet; në vend të kësaj diskuton për nevojat dhe pritshmëritë për kohën kur të jetë në një marrëdhënie.</li> <li>I gatshëm për të folur dhe për të dëgjuar.</li> <li>Pranon ndjenjat: nuk ka një super reagim; cakton kufij në bashkëpunim me adoleshentin dhe nuk i kthehet kufizimeve të kohës së fëmijërisë.</li> <li>Pranon nevojën që adoleshenti ka për ndarje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çoje për një vizitë te mjeku. Inkurajo nevojën për kontrolle të rregullta fizike (në fund synohet që adoleshenti të shkojë vetë te doktori).</li> <li>Shkoni për pushime si familje. Jepi fëmijës përgjegjësi për këtë udhëtim.</li> <li>Vër një stendë në shtëpi për gjërat që duhen mbajtur mend, në mënyrë që ngacmimet të cilat çojnë në konflikt të mund të shmangen.</li> <li>Inkurajoje adoleshentin/ adoleshenten të ndërmarrë veprimtari apo kurse profesionale të cilat do të jenë për të të dobishme nga ana praktike në të ardhmen.</li> </ul>

Marrë nga:

[www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk](http://www.pearsonschoolsandcolleges.co.uk)

[www.ncc.org/curriculum/play.activities.html](http://www.ncc.org/curriculum/play.activities.html)

[www.nrcfcppp.org](http://www.nrcfcppp.org)

[www.cdc.gov/ncbddd/childdevelopment](http://www.cdc.gov/ncbddd/childdevelopment)

[http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial\\_ChildDevelopment\\_Milestones.pdf](http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial_ChildDevelopment_Milestones.pdf)

[wcpds.wisc.edu/childdevelopment/resources/TeenplusDetails.pdf](http://wcpds.wisc.edu/childdevelopment/resources/TeenplusDetails.pdf)

[http://www.education.com/reference/article/Ref\\_Child\\_Guide\\_Sixteen/](http://www.education.com/reference/article/Ref_Child_Guide_Sixteen/)

## Fazat zhvillimore

Fillimi i moshës së pjekur: 18 deri në 21 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
18–21 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> <li>Interesi për shkollën rritet ose bie në varësi të perspektivës për nevojat e ardhshme.</li> <li>Kalon në role dhe përgjegjësi të rriturish dhe mund të mësojë një zanat, të fillojë punë dhe/ose të ndjekë arsimin e lartë.</li> <li>Kupton plotësisht koncepte abstrakte dhe është i vetëdijshëm për pasojat e kufizimeve personale.</li> <li>Identifikon synimet për karrierë dhe përgatitet për t'i arritur ato.</li> <li>Siguron autonomi dhe ndërton e teston aftësi vendimmarrëse.</li> <li>Zhvillon aftësi të reja, hobe dhe interesa të rriturish.</li> <li>Është i zhvilluar mirë të menduarit abstrakt; është në gjendje të kuptojë, të planifikojë dhe të ndjekë qëllime afatgjata.</li> <li>Është filozofik dhe idealist.</li> <li>Ka një preokupim i shtuar për të ardhmen në lidhje me pyetjen: Çfarë të bëj në jetë?</li> <li>Ka një kapacitet më të madh për të përdorur njohuri të thella.</li> <li>Pavarësia financiare është më e dukshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi hormonal dhe i trurit vazhdon.</li> <li>Përfundon procesi i formimit të plotë fizik, zakonisht me arritjen e lartësisë së plotë të njeriut të rritur.</li> <li>Karakteristika dytësore seksuale, të tilla si madhësia e penisit dhe e gjoksit, përfundojnë.</li> <li>Pjekja fizike dhe rritja riprodhuese ngadalësohet dhe përfundon.</li> <li>Vërehet një ndjenjë më e fortë e identitetit seksual.</li> <li>Veprimtaritë fizike ndikohen nga ekspozimi apo mungesa e ekspozimit ndaj tyre (p.sh., disa aftësi të veçanta sportive, ushtrimet e zakonshme).</li> <li>Aftësitë motorike kanë përdorime më praktike (për punë me pagesë apo për punë shtëpie, si për shembull zdrukthëtaria, kopshtaria e kështu me radhë).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetet më shumë të bashkëmohatarët për ngrohtësi shpirtërore dhe aprovim.</li> <li>Formohet identiteti individual; kërkon pavarësi.</li> <li>Prindërit dhe familja janë ende të rëndësishëm dhe të domosdoshëm.</li> <li>Vizionimi për të ardhmen dhe besimi te vetja janë thelbësorë.</li> <li>Kalon në marrëdhënie të rriturish me prindërit.</li> <li>E konsideron grupin e bashkëmohatarëve si më pak të rëndësishëm në përcaktimin e sjelljes.</li> <li>Është i ndjeshëm.</li> <li>Ka aftësi më të mëdha intimiteti.</li> <li>Plotëson strukturën e vlerave.</li> <li>Vazhdon të ruajë disa ndjenja pathyeshmërie.</li> <li>Krijon imazhin trupor.</li> <li>Hyn në marrëdhënie intime seksuale dhe emocionale.</li> <li>Kupton orientimin e vet seksual (paçka se mundet të vazhdojë të eksperimentojë).</li> <li>Kupton seksualitetin si të lidhur me përkushtimin dhe planifikimin për të ardhmen.</li> <li>E kalon theksin nga vetja te të tjerët.</li> <li>Përjeton seksualitet më intensiv.</li> <li>Fillon ndarja nga familja/kujdestari.</li> <li>Ndihet më i qetë në kërkimin për këshilla nga të rriturit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mban hapur linjat e komunikimit dhe e pranon që ky i ri apo e re hyn tani te moshë e pjekur jo te fëmijëria.</li> <li>Ofron zgjedhje, pranon përgjegjësi dhe shmang diktimin ndaj të tjerëve.</li> <li>Vazhdon të ofrojë afrimitet fizik dhe emocional, por respekton nevojën për intimitet apo privatësi dhe pavarësi.</li> <li>Vlerëson pikat e forta si dhe cilësitë e të riut apo të resë.</li> <li>Mundëson vajtjen e të riut apo të resë në qendrat e kujdesit seksual dhe riprodhues.</li> <li>Vazhdon që të ofrojë udhëzime dhe ndarjen e vlerave.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E përfshin të riun apo të renë në hartimin e buxhetit familjar dhe në pazaret e familjes. Kjo i jep atyre një pamje më të qartë të vendimeve financiare që atij apo asaj do t'i duhet të marrë për të tjerët.</li> <li>Zhvillon bashkë veprimtari fizike: dilni për vrap, merruni me sporte apo merrni pjesë në veprimtari në komunitet, të cilat promovojnë ushtrimet fizike (aerobi, gjimnastikë e të tjera si këto).</li> <li>Shkoni bashkë në një zyrë shtetërore. Drejtoje dhe inkurajoje të riun apo të renë që të bëjë pyetje dhe t'i plotësojë vetë formularët.</li> <li>E lejon të riun apo të renë që të marrë përsipër administrimin e shtëpisë për një ditë apo përgjatë fundjavës. Përqendrohet tek aftësitë menaxhuese e jo te punët e shtëpisë.</li> </ul>

## Fazat zhvillimore

Fillimi i moshës së pjekur: 18 deri në 21 vjeç

Moshë	Fëmija			Kompetenca e prindërve	Veprimtari
	Njohuria	Aftësia	Qëndrimi		
18–21 vjeç			<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkëmoshatarët janë të rëndësishëm, por tani i riu mundet të vlerësojë ndikimin dhe opinionet e tyre pa i pranuar detyrimisht ato me gjithë zemër dhe pa i peshuar paraprakisht.</li> <li>Vlerëson marrëdhëniet intime.</li> <li>Pranon përgjegjësitë e të rriturve e madje edhe ato që kanë të bëjnë me martesën dhe prindërimin.</li> </ul>		

Marrë nga:

[www.ncc.org](http://www.ncc.org)

[www.nrcfcp.org](http://www.nrcfcp.org)

[www.canadianparents.org](http://www.canadianparents.org)

[http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial\\_ChildDevelopment\\_Milestones.pdf](http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial_ChildDevelopment_Milestones.pdf)


<http://www.education.com>

<http://www.scyoungadults.org/>

## Moduli 4

# *Të ndjekim ëndrrat tona*

“Ndjekja e ëndrrave tona” ka të bëjë me një besëlidhje si dhe me kërkimin për bekimin nga Perëndia. Ajo ka të bëjë me një premtim që Perëndia na ka bërë të tërëve (Isaia 49:15–16), premtim të cilin ne e bëjmë tonin për familjet dhe shtëpitë tona. Kjo na fton që të shikojmë shembullin e Perëndisë, që ka një dashuri të përjetshme dhe domethënies që kjo gjë ka për ne, ndërkohë që udhëtojmë drejt plotësisë së jetës për familjen tonë. Praktikimi me bekimin e familjes sonë është hapi i fundit i programit “Të festojmë familjet”. Kjo i fton pjesëmarrësit që të reflektojnë për “Isaia” 54:2–3, të kërkojnë për kuptimin e saj dhe të bëjnë deklarata bekimi bazuar te këto kuptime. Thënia e bekimeve përbën një kujtesë të fuqishme të dashurisë së Perëndisë për ne. Kjo gjithashtu na kujton përgjegjësinë tonë të shenjtë për ta dashur familjen tonë e për t’u kujdesur për të.





**Moduli 4** Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 12**Sesioni 12: “Të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të mia”**

Ky sesion i fton pjesëmarrësit që të reflektojnë për “Isaia” 49:15–16. Këtu tregohet besëlidhja midis Perëndisë dhe fëmijëve të Perëndisë, dhe mënyra se si kjo duhet pasqyruar në marrëdhëniet përbrenda familjeve. Pjesëmarrësve u jepet mundësia që të shkruajnë një mesazh dashurie dhe përkushtimi ndaj fëmijëve të tyre.

**Koha totale e sesionit**

65 minuta

**Objektivat**

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- reflektuar për “Isaia” 49:15–16, për të gjetur atë lloj marrëdhënieje që familjet e kanë të nevojshme për të pasur mbarësi;
- mesazhe të shkruara dashurie dhe përkushtimi ndaj fëmijëve të tyre.

**Prezantim**

Prezantoje sesionin duke kaluar nëpër pikat e mëposhtme:

- T'i bëjmë realitet ëndrrat që kemi për familjet tona, do të thotë të krijojmë marrëdhënie dashurie përbrenda familjes. Ushqimi i marrëdhënieve në familje mund të jetë i vështirë, por çdo familje ka nevojë të ketë një vendosmëri të lartë, shumë e ngjashme kjo me një besëlidhje, që do ta mbajë familjen të bashkuar nëpër uljet dhe ngritjet e shumta të udhëtimit.
- Shkrimi e përshkruan këtë marrëdhënie besëlidhjeje.
- “Isaia” 49:15–16 flet për dashurinë dhe përkushtimin e Krijuesit për krijesën. Për ta treguar këtë dashuri dhe përkushtim, pasazhi paraqet një mama dhe një fëmijë -një lidhje e fortë tashmë- dhe deklaron se ekziston një dashuri që është edhe më e fortë se kjo lidhje, për më tepër, ajo është e përjetshme.
- Pasazhi gjithashtu flet për gdhendjen e emrave tanë në duart e Perëndisë, që simbolizon qëndrimin atje. Ne dëshirojmë po këtë përkushtim dhe qëndrueshmëri për familjet tona.

**Koha**

5 minuta

**Veprimtaria 1: Hulumtimi i Shkrimit**

- Referoju reflektimit për “Isaia” 49:15–16 (faqe 76). Kërkoju pjesëmarrësve që të ndajnë mendimet e tyre si përgjigje ndaj pyetjeve të mëposhtme: **“Çfarë domethënieje ka kur Perëndia thotë se emrat tanë janë gdhendur në pëllëmbët e duarve të Tij?”**
- Përgjigjet shkruaji në një tabak letre dhe ftoji pjesëmarrësit që t'i diskutojnë ato.

**Koha**

25 minuta



**Moduli 4** Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 12**Veprimtaria 2: Lidhja e një besëlidhjeje**

- Jepi secilit pjesëmarrës nga një fletë të ngjyrosur si dhe një laps apo stilolaps. Kërkoju pjesëmarrësve që të vënë përsipër letrës dorën e tyre e të vizatojnë konturin përfaqëues.
- Ftoj pjesëmarrësit që të shkruajnë një mesazh të gjatë dashurie drejtuar fëmijëve të tyre te pëllëmba e dorës së vizatuar.
- Kërko vullnetarë që t'i tregojnë të gjithë grupit mesazhin e tyre.
- Inkurajoni pjesëmarrësit që këtë “dorë” t’ua japin fëmijëve të tyre kur të shkojnë në shtëpi.



Një pjesëmarrës vizaton konturin e dorës për veprimtarinë “Lidhja e besëlidhjes”.



Pjesëmarrësit shkruajnë mesazhe dhe lutje ndaj Perëndisë për fëmijët apo anëtarët e familjes së tyre.

**Koha**  
25 minuta

**Përmbyllja**

Përmbylle sesionin duke u kërkuar pjesëmarrësve që ta mbajnë pranë zembrës vizatimin e tyre apo dorën lart, ndërkohë që i drejtojnë Perëndisë një lutje përkushtimi. Lehtësuesi mund t’u kërkojë gjithashtu pjesëmarrësve që të luten ashtu si t’u vijë, po qe se e lejon konteksti.

**Koha**  
10 minuta

**Shënime për lehtësuesin**

Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që ndodhet te shtojca.

**Zhvillimi i trajnimit në kontekste besimesh të tjera fetare**

- Lehtësuesi duhet të kuptojë kontekstet e tjera fetare të pjesëmarrësve. Nëse pjesa më e madhe e pjesëmarrësve nuk i takojnë besimit të krishterë, lehtësuesi duhet të flasë rreth idesë së gdhendjes dhe për lidhjen që kjo ka me krijimin e një besëlidhjeje.
- Ji i ndjeshëm ndaj kontekstit. Nëse trajnimi kryhet me pjesëmarrjen e besimeve të tjera fetare, Shkrimi mund të citohet pa referencë dhe/apo pa kërkuar leje për të lexuar pasazhin. Gjithashtu pjesëmarrësit nga besime të tjera fetare mund të ftohen që të lexojnë një tekst nga librat e tyre të shenjtë, i cili të pasqyrojë të njëjtën ide apo parim.
- Nëse pasazhi nga Shkrimi (Isaia 49:15–16) nuk mund të përdoret aspak, lehtësuesi mund të zgjedhë të përdorë mesazhe të tjera kyçe rreth përkushtimit dhe besëlidhjes, dhe thjesht të vazhdojë me veprimtarinë e lidhjes së besëlidhjes.

Lehtësuesi mund të zgjedhë të përdorë veprimtari të tjera, për të lehtësuar përvojën e “ndërtimit të besëlidhjes” me pjesëmarrësit, veçmas veprimtarisë së vizatimit të konturit të dorës. Për shembull, pjesëmarrësit mund të shkruajnë një mesazh përkushtimi apo besëlidhjeje për fëmijët e tyre në një letër të prerë në formë zemre në vend të vizatimit të konturit të dorës.

## Moduli 4 Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 12



### Materialet e nevojshme

- Një fletë letre me një ngjyrë të hapur për çdo pjesëmarrës
- Tabak letre
- Stilolapsa, lapsa, lapustila
- Reflektimi rreth Shkrimit për “Isaia” 49:15–16 (faqe 76)

**Moduli 4** Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 12

## Reflektim për Shkrimin: “Isaia” 49:15–16

“Të kam gdhendur në pëllëmbët e duarve të mia”

**“A mundet një grua ta harrojë foshnjën e gjirit dhe të mos i vijë keq për fëmijën e barkut të saj? Edhe sikur ato të harrojnë, unë nuk do të të harroj. Ja, unë të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të Mia; muret e tua më rrinë gjithnjë para syve.”**

Isaia 49:15–16

### Diskutim i shkurtër

Zoti shpreh dashurinë e Tij për izraelitët 49:15–16, duke e krahasuar atë me dashurinë e një mamaje për foshnjën e saj të gjirit. Edhe nëse një mama me foshnjën në gji, për një arsye apo për një tjetër do ta harronte foshnjën e saj, Zoti do të na kujtonte gjithnjë. Perëndia kurrë nuk do të na harrojë. Për të bërë një përvijim të kësaj marrëdhënieje, Zoti u thotë izraelitëve që ata janë “gdhendur në pëllëmbët e duarve të Tij”. Kjo tregon që lidhja e Zotit me ne është e përhershme.

Fëmijët dhe prindërit kanë gjithashtu një marrëdhënie të përhershme, pavarësisht faktit nëse e kuptojnë apo jo atë. Nganjëherë veprimet tona nuk e pasqyrojnë këtë marrëdhënie.

Ilustrimi i një mamaje me një fëmijë në gji tregon se sa të brishtë jemi përpara Perëndisë si fëmijët e Tij. Kjo gjithashtu tregon se çka është në gjendje të bëjë Perëndia për të na mbrojtur.

Perëndia i bekon prindërit dhe fëmijët dhe pret që prindërit t'i rritin dhe t'i mbrojnë fëmijët e tyre me dashuri të madhe. Zoti dëshiron që prindërit dhe fëmijët të kenë një marrëdhënie përkujdesjeje të përhershme me njëri - tjetrin.

### Pyetje për të reflektuar

1. Çfarë do të thotë për ju të dëgjoni Perëndinë të thotë se emrat tanë janë gdhendur në pëllëmbët e duarve të Tij?
2. Çfarë besëlidhjeje mund të bëjmë me fëmijët tanë për të shprehur kujdesin dhe marrëdhënien e përhershme mes nesh?

## Moduli 4 Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 13



### Sesioni 13: Të themi bekime

Ky është sesioni përfundimtar i modulit të fundit. Moduli 4, “Të flasim bekime”, i fton pjesëmarrësit që të reflektojnë për “Isaia” 54:2–3 dhe domethënien e tij për familjet e tyre. Ndërkohë që pjesëmarrësit reflektojnë për këtë pasazh dhe kërkojnë të fitojnë njohuri të thella rreth tij, do të kenë mundësinë që të thonë bekime për familjet dhe shtëpitë e tyre.

**Koha totale e sesionit**

65 minuta



### Objektivat

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- reflektuar bashkërisht për “Isaian” 54:2–3 dhe do të kenë diskutuar domethënien e këtij pasazhi;
- formuluar deklaratat e tyre të bekimeve;
- identifikuar mënyra se si të zbatojnë të mësuarin e tyre për familjet dhe shtëpitë e tyre.



### Prezantim

Prezantoje sesionin duke kaluar përmes çështjeve të mëposhtme:

- Thënia e bekimeve për pjesëtarët e familjes sonë është një veprim i fuqishëm, që mund të na ndihmojë të vëmë në jetë premtimet që kemi bërë. Thënia e bekimeve na jep më shumë forcë dhe shpresë për të besuar se me bekimin e Perëndisë, ne mund të kemi jetë të plotësuar për familjet tona.
- Gjatë tri ditëve të kaluara, ne kemi ndarë me njëri – tjetrin mënyrën se si familjet tona janë përballur me kohët më të vështira; kemi mësuar të kërkojmë për fara mirësie të kushdo; kemi kuptuar se kemi arsye për të qenë mirënjohës si dhe mundësi për t’u ofruar të tjerëve hir dhe falje.
- Kemi reflektuar së bashku dhe kemi kuptuar që na duhet të përmbushim rolin tonë, me qëllim që familjet tona të kenë mbarësi. Ne jemi zotuar që ta bëjmë këtë.
- Sot ne themi bekime për familjen tonë.
- “Isaia” 54:2–3 ka të bëjë me atë që Perëndia pret prej nesh. Kur jetët tona përmirësohen, ne nuk duhet të harrojmë ata që kanë nevojë për ndihmë dhe përkujdesje. Ne dëshirojmë që edhe jeta e tyre të jetë më e mirë, në mënyrë që edhe ata të mund të kujdesen për të tjerë dhe të marrin bekimin që vjen nga të vepruarit kështu.

**Koha**

10 minuta



### Veprimtari: Deklaratat bekuese

Si të shkruajmë një deklaratë bekuese?

- Shkruaj deklaratat e mëposhtme në shtatë tabakë letrash (një pjesë të pasazhit për çdo tabak). Ndaj pjesëmarrësit në shtatë grupe. Secilit grup caktoj një pjesë nga pasazhi: **1. zgjero vendin e çadrës sate, 2. Pëlhurat/kunjat e banesave të tua le të shtrihen, 3. pa kursim, 4. zgjati litarët e tu, 5. përforco kunjat e tua, 6. do të shtrihesh në të djathtë dhe në të majtë, 7. pasardhja jote do të zotërojë kombet.**
- Kërkoju grupeve që të reflektojnë për frazën që u është caktuar. Në lidhje me familjet tona: **“Çfarë do të thotë të zgjerojmë vendin e çadrës tonë në shtëpitë dhe familjet tona?”; “Çfarë do të thotë të shtrijmë pëlhurat e banesave tona?”; “Çfarë do të thotë të zgjasim litarët?”** e kështu me radhë.
- Duke përdorur kuptimet që pjesëmarrësit gjejnë në pjesën e tyre të pasazhit, kërkoji secilit grup që të krijojë një deklaratë bekuese. Për shembull, përdor vargun 4 nga “Isaia” 54, *“Mos u frikëso, sepse nuk do të ngatërrohesh”*. Kjo mund të nënkuptojë se je më i besueshëm në raport me familjen tënde. Një bekim bazuar te kjo mund të jetë: *“E bëftë Perëndia shtëpinë dhe familjen tonë një vend ku ne kemi besim te njëri-tjetri.”* Kjo është një deklaratë bekimi.
- Kërkoji secilit grup të krijojë një bekim të bazuar te kuptimet e gjetura në vargun që u është ngarkuar.
- Secili grup duhet të shkruajë te tabakët e letrave, poshtë pjesës së caktuar nga shkrimi biblik, deklaratën e tij të bekimit, për ta përdorur në veprimtarinë përmbyllëse.

**Koha**

45 minuta



## Moduli 4 Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 13

### Përmbyllje

- Kërkoju pjesëtarëve të grupit të parë të dalin në pjesën e përparme të sallës dhe të shtrijnë duart e tyre drejt të tërë grupit. Kërkoju pjesës tjetër të pjesëmarrësve që të ngrihen, me fytyrë nga grupi që ka dalë përpara, dhe të hapin krahët e tyre për të marrë bekimin.
- Pjesëtarët e grupit e lexojnë së bashku deklaratën e tyre të bekimit në tabakun e tyre të letrës, duke shpallur një bekim për të gjithë të pranishmit në sallë.
- Përsërite këtë derisa të gjitha grupet të kenë thënë deklaratat e tyre të bekimit.
- Përmbyle sesionin duke lexuar së bashku bekimin gaelik (faqe 80).



Pjesëmarrësit marrin bekimin.

**Koha**  
10 minuta

### Shënime për lehtësuesin



- Mblidh deklaratat e bekimit nga të tërë tabakët e letrave. Shtypi dhe printoju ato, në mënyrë që një kopje t'ia japësh si dhuratë secilit pjesëmarrës për ta marrë me vete në shtëpi.
- Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë të shtojca.

### Zhvillimi i trajnimit në kontekste besimesh të tjera fetare

- Pjesëmarrësit mund të zgjedhin një pasazh nga librat e tyre të shenjtë, me qëllim që të thurin deklaratat e tyre të bekimit.
- Mos lexo pasazhin nga "Isaia", por përmend vetëm pjesët e tij, si, për shembull, "**zgjero vendin e çadrës sate**". Kjo mund të përdoret për të biseduar për ndërtimin e shtëpive, forcimin dhe mbrojtjen e shtëpive tona si dhe për përkujdesjen ndaj të tjerëve.
- Pyeti pjesëmarrësit se si janë bekuar fëmijët dhe familjet në traditat e tyre të besimit fetar.
- Mund të jetë e rëndësishme që të përmendim se në disa tradita fetare vetëm pastori apo drejtuesit fetarë mund të japin një bekim. Trego që kjo veprimtari nuk ka për qëllim të zëvendësojë bekimet që janë shpallur nga drejtuesit e tyre fetarë. Përkundrazi, qëllimi është prezantimi i një parimi apo nisja e një tradite, të cilën ne mund ta zbatojmë në jetën tonë të përditshme.

### Materialet e nevojshme

- Shtatë tabakë letre me temat e mëposhtme të printuara në to: 1. zgjero vendin e çadrës sate, 2. pëlhurat e banesave të tua le të shtrihen, 3. pa kursim, 4. zgjati litarët e tu, 5. përforco kunjat e tua, 6. do të shtrihesh në të djathtë dhe në të majtë, 7. pasardhja jote do të zotërojë kombet.
- Fletë ngjitëse shënimesh apo karta dhe letër ngjitëse apo materiale të tjera ngjitëse
- Stilolapsa apo lapsa
- Një kopje e "Isaia" 54:2–3 për çdo pjesëmarrës (faqja 79)
- Një kopje e lutjes së bekimit gaelik për çdo pjesëmarrës (faqja 80)



**Zgjero vendin e çadrës sate, pëlhurat e banesave të tua le të shtrihen, pa kursim; zgjati litarët e tu, përforco kunjat e tua; do të shtrihesh në të djathtë dhe në të majtë; pasardhja jote do të zotërojë kombet.**

**“Isaia” 54:2-3**

**Të vaftë rruga mbarë. Era të fryftë  
gjithnjë nga prapa krahëve. Qoftë  
dielli i ngrohtë në fytyrën tënde dhe  
shiu rëntë i butë në arat e tua derisa  
të takohemi sërish.  
Të mbajtë Perëndia në pëllëmbë të  
dorës.**

Një lutje gaelike bekimi



## Moduli 4 Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 14



### Sesioni 14: Të mësojmë një plan zbatimi

Ky sesion i fton pjesëmarrësit të reflektojnë rreth asaj që kanë mësuar gjatë trajnimit. Kjo i ndihmon ata të identifikojnë mënyra zbatimi të asaj që kanë mësuar në jetën e tyre personale dhe profesionale. Pjesëmarrësit ftohen të krijojnë një “plan zbatimi mësimor” me ata që janë pjesë e organizatës së tyre, zyrës kombëtare apo programeve zhvëllimore në zonë (PZHZ-së), me qëllim që të mendojnë qartë rreth hapave që duhet të ndërmerren në udhëtimin e tyre në vendin e tyre të punës.

**Koha**  
75 minuta



### Objektivat

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të kenë:

- reflektuar për atë që kanë mësuar si dhe për hapat që duhet të ndërmerren për t'i zbatuar këto mësimet në shtëpitë e tyre;
- do të kenë plotësuar një formular mësimor zbatimi për organizatën apo për zyrën e tyre, ku të kenë identifikuar këta hapa, duke caktuar një kornizë kohore dhe duke identifikuar personin apo personat përgjegjës për secilin hap.



### Prezantim

- Kur filluar këtë udhëtim të përbashkët, diskutuam rëndësinë e të mësuarit të këtij materiali, së pari, për të përmirësuar veten dhe familjet tona dhe pastaj për të pajisur dhe trajnuar të tjerët.
- Ne dëshirojmë të krijojmë tani një hapësirë për të reflektuar rreth asaj që do të zbatohet në shtëpi.
- Më pas ne do të flasim rreth hapave që na duhet të zbatohet në programin “Të festojmë familjet” në vendin tonë të punës.

**Koha**  
5 minuta



### Veprimtaria 1: Veprime SMART (të mençura)

- Kërkoju pjesëmarrësve të shkruajnë në ditarët e tyre dy veprime SMART (**S**pecifike, të **M**atshme, të **A**rritshme, **R**ealiste, **T**amam në kohë), të cilat ata do t'i kryejnë kur të shkojnë në shtëpi.
- Pasi të gjithë të kenë përfunduar së shkruari, fto disa vullnetarë që t'u tregojnë të gjithëve synimet e tyre.

**Koha**  
15 minuta



### Veprimtaria 2: Plani të zbatimit të mësimit

- Udhëzoji pjesëmarrësit që të formojnë grupe të vogla me punonjës të tjerë të zyrës së tyre kombëtare, PZHZ-në apo organizatat partnere.
- Shpërnda një kopje të tabelës (faqe 83) për secilin grup.
- Kërkoju pjesëmarrësve që të punojnë së bashku, për 30 minuta, rreth një plani mësimor zbatimi për zyrën e tyre, PZHZ-në apo organizatën (duke përdorur formularin). Do t'u duhet të përcaktojnë hapat, kornizën kohore për secilin hap, si dhe personin apo personat përgjegjës.
- Kërkoji secilit grup të përzgjedhë një person i cili të raportojë për planin që ai grup ka përpara të gjitha grupeve së bashku. Gjatë prezantimit lejohen vetëm ato pyetje që kanë të bëjnë me saktësimin e kuptimit.

**Koha**  
50 minuta



### Përmbyllja

Përmbylle me lutje drejtuar Perëndisë.

**Koha**  
5 minuta



## Moduli 4 Ndjekja e ëndrrave tona: Sesioni 14



### Shënime për lehtësuesin

- Sigurohu që t'u bësh të qartë pjesëmarrësve se ndërkohë që secili grup i vogël është duke prezantuar planin e tij të mësimit të zbatimit, roli i pjesës tjetër të të gjithë grupit është të dëgjojë, ta vlerësojë prezantimin e bërë dhe jo të diskutojë apo të kritikojë.
- Në fund të sesionit, ju lutem merrni kohën e nevojshme për të plotësuar modelin e përshtatshmërisë që ndodhet te shtojca.



### Materialet e nevojshme

- Stilolapsa, lapsa
- Ditarët e pjesëmarrësve
- Formulari *Mësimi i zbatimeve* për secilin grup (faqe 81)

**PLANI I MËSIMIT TË ZBATIMIT**

Zyra kombëtare, PZHJ-ja apo organizata: \_\_\_\_\_

HAPAT E TJERË	KORNIZA KOHORE	PERSONI apo PERSONAT PËRGJEGJËS

# *Shtojcat*



## Bibliografia

### Referencat

Chapman, Gary D. 2004. *Pesë gjuhët e dashurisë: Sekreti për një dashuri që zgjat (The Five Love Languages: The Secret to Love That Lasts)*. Chicago: Northfield Publishing. Myers, Jenny. 2007. *Të mbajmë fëmijët të sigurt: Mjetet e punës së trajnimit (Keeping Children Safe: Training Toolkit)*. UK: The Keeping Children Safe Coalition (KCS).

#### Materiale të disponueshme në internet

- Departamenti i Burimeve Njerëzore. 2010. ACT. *Gurët kilometrikë të zhvillimit të fëmijës (A Child's Developmental Milestones)*. <[www.acetonline.org/child\\_dev\\_milestone.pdf](http://www.acetonline.org/child_dev_milestone.pdf)>
- Destefanis, Joyce, MA, dhe Nancy Firchow, MLS. 2012. *Gurët kilometrikë të zhvillimit: Fëmija yt 8-vjeçar (Developmental Milestones: Your 8-year-Old Child)*. <[www.greatschools.org/special-education/health/903-developmental-milestones-your-8-year-old-child.gs](http://www.greatschools.org/special-education/health/903-developmental-milestones-your-8-year-old-child.gs)>
- Education.com. *Udhëzuesi për zhvillimin e fëmijës 16-19-vjeçar (Child Development Guide 16–19 Years)*. 2012. <[http://www.education.com/reference/article/Ref\\_Child\\_Guide\\_Sixteen/](http://www.education.com/reference/article/Ref_Child_Guide_Sixteen/)>
- Kersey, Katharine C. 2006. *101 Parimet pozitive të disiplinës (The 101 Positive Principles of Discipline)*. Norfolk, VA: Old Dominion University. <<http://ww2.odu.edu/~kkersey/101s/101principles.shtml>>
- Lawrence, Carissa. 2010. *Veprimtari për zhvillimin e gjuhës për 2-vjeçarët (Language Development Activities for 2-Year-Olds)*. <<http://www.livestrong.com/article/98760-language-development-activities-two-year-olds/>>
- Max 7.org. *Ndërtues të mençur dhe ndërtues të pamend (Wise and Foolish Builders)*. <<http://www.max7.org/resource.aspx?id=8ac8e077-b534-4917-bece-10adf46f6b90&creatinguser=1>>
- Miller, Laurie. National Network for Child Care. 1995. *Veprimtari loje për fëmijët nga zero në nëntë vjeç (Play Activities for Children Birth to Nine Years)*. <<http://www.nncc.org/Curriculum/play.activities.html>>
- Akademia e Trajnimeve e Kalifornisë së Veriut (Northern California Training Academy) (rishtypur nga CalSWEC Berkeley). Pa datë botimi. *Gurët kilometrikë të zhvillimit të fëmijës (Child Development Milestones)*. <[http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial\\_ChildDevelopment\\_Milestones.pdf](http://calswec.berkeley.edu/CalSWEC/SuppMaterial_ChildDevelopment_Milestones.pdf)>
- Personality Café. 2012. *Pesë gjuhët e dashurisë (The Five Love Languages) Të shpjeguara (Explained)*. <<http://personalitycafe.com/articles/112444-five-love-languages-explained.html>>
- Riddlej. Blogu: Jeta me fëmijët e vegjël (Life with Little Children). 2007. *Veprimtari për zhvillimin kognitiv për 3 deri 5-vjeçarët (Cognitive Development Activities for 3 to 5 Year Olds)*. <<http://littlechildren.wordpress.com/2007/11/29/cognitive-development-activities-for-3-to-5-year-olds/>>
- Schifferdecker, Stacey. 2006. *Disiplinë pozitive (Positive Discipline)*. Siti i internetit More4Kids. <<http://www.more4kids.info/290/positive-discipline/>>
- Njësia për Bashkëworkshop-in me UNICEF-in dhe PUB--në. 1984. *Karakteristika zhvillimore të fëmijës së vogël nga Filipinet (Developmental Characteristics of the Young Child of the Philippines)*. <[unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0005/000586/058624eb.pdf)>
- Qendra Amerikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (US Center for Disease Control and Prevention). 2012. *Zhvillimi i fëmijëve (Child Development)*. <[www.cdc.gov/ncbddd/childdevelopment/](http://www.cdc.gov/ncbddd/childdevelopment/)>
- Departamenti i Shtetit të Washington-it për Shërbime Sociale dhe Shëndetësore (Washington State Department of Social and Health Services). Rishikuar 2009. *Udhëzuesi mbi zhvillimin e fëmijës: 16-19-vjeçar (Child Development Guide: 16–19 Years)*. <[http://www.education.com/reference/article/Ref\\_Child\\_Guide\\_Sixteen/](http://www.education.com/reference/article/Ref_Child_Guide_Sixteen/)>

## Bibliografia

Wikipedia. *Fazat zhvillimore të fëmijës (Child Development Stages)*. 2009. <[en.wikipedia.org/wiki/Child\\_development\\_stages](http://en.wikipedia.org/wiki/Child_development_stages)>

Sistemi i Trajnimit i Wisconsin-it për Mirëqenien e Fëmijës (*Wisconsin Child Welfare Training System*). Pa datë botimi. Efektet e abuzimit dhe shpërfilljes: Fokusi në zhvillimin tipik (*Effects of Abuse and Neglect: A Focus on Typical Development*) <[wcpds.wisc.edu/childdevelopment/resources/TeenplusDetails.pdf](http://wcpds.wisc.edu/childdevelopment/resources/TeenplusDetails.pdf)>

## Materiale burimore të rekomanduara

Allen, Holly Catterton. 2008. *Zhvillimi i botës shpirtërore të fëmijëve: Pikëpamjet e krishtera si dhe praktikat më të mira (Nurturing Children's Spirituality: Christian Perspectives and Best Practices)*. Eugene, OR: Cascade Books.

Barna, George. 2003. *Transformimi i fëmijëve në kampionë shpirtërorë (Transforming Children into Spiritual Champions)*. Ventura, CA: Regal Books. Becky, Bailey. 2002. *E lehtë ta duash, e vështirë ta disiplinosh (Easy to Love, Difficult to Discipline)*. New York: HarperCollins.

Berryman, Jerome. 2009. *Fëmijët dhe teologët (Children and the Theologians)*. New York: Moorehouse. Buckland, R. 2001. *Fëmijët dhe Ungjilli (Children and the Gospel)*. Gosford, NSW: Scripture Union. Coles, R. 1990. *Jeta shpirtërore e fëmijëve (The Spiritual Life of Children)*. Boston: Houghton Mifflin.

Faber, Adele dhe Elaine Mazlish. 2012. *Si të flasim në atë mënyrë që fëmijët të dëgjojnë, e si të dëgjojmë në atë mënyrë që fëmijët të flasin (How to Talk So Kids Will Listen and Listen So Kids Will Talk)*. New York: Scribner.

Fowler, James. 1995. *Fazat e besimit (Stages of Faith)*. New York: HarperCollins.

Garland, Diana. 2010. *Familje të forta përbrenda (Inside Out Families)*. Waco, TX: Baylor University Press.

Hay, David, dhe Rebecca Nye. 2006. *Shpirti i fëmijës (The Spirit of the Child)*. Rishikuar. London: Jessica Kingsley Publishers. Healy, Jane. 2004. *Mendja në rritje e fëmijës tënd (Your Child's Growing Mind)*. New York: Broadway Books. Hyde, B. 2008. *Fëmijët dhe bota shpirtërore (Children and Spirituality)*. London: JKP.

Jenson, D. 2005. *Në pozita të dobëta, por me hir (Graced Vulnerability)*. Cleveland: Pilgrim Press.

McConnell, Douglas, Jennifer Orona dhe Paul Stockley, red. 2007. *Të kuptojmë atë që Perëndia ka në zemër për fëmijët: Drejt një suaze biblike (Understanding God's Heart for Children: Toward a Biblical Framework)*. Colorado Springs, CO: Authentic and World Vision.

## Bibliografia

- Miller, Judy. 2003. *Asnjëherë tepër i ri: Ja se si të rinjtë mund të marrin përgjegjësi dhe vendime (Never Too Young: How Young People Can Take Responsibility and Make Decisions)*. UK: Save the Children. Mountain, V. 2008. *Hulumtim mbi mënyrën se si fëmijët perceptojnë lutjen (Research into Children's Perception of Prayer)*. Saarbrücken, Germany: VDM.
- Nye, Rebecca. 2009. *Bota shpirtërore e fëmijëve: Si është dhe përse është e rëndësishme (Children's Spirituality: What It Is and Why It Matters)*. Norfolk, VA: Church House Publishing.
- Nye, Rebecca, Peter Privett dhe Alison Seaman. 2010. *Lojë e Perëndishme: Hyrje dhe doracaku i fillestarit (Godly Play: An Introduction and Starter's Handbook)*. Norwich, UK: Canterbury Press Norwich.
- Ratcliff, Donald, red. 2004. *Bota shpirtërore e fëmijës: Perspektivat e krishtera, hulumtimet dhe zbatimet (Children's Spirituality: Christian Perspectives, Research, and Applications)*. Eugene, OR: Cascade Books.
- Roehlkepartain, Eugene C., red. 2006. *Doracaku i zhvillimit shpirtëror në fëmijëri dhe adoleshencë (The Handbook of Spiritual Development in Childhood and Adolescence)*. Thousand Oaks, CA: SAGE Publications.
- Segura, Harold C. 2006. *Un Nino los Pastoreara: Niñez, Teología y Misión*. Botimi spanjisht. Spain: Editorial Mundo Hispano.
- Siegel, D., dhe Mary Hartzell. 2004. *Prindërim nga përbrenda (Parenting from the Inside Out)*. New York: Jeremy P. Tarcher/Penguin Press. Smalley, Gary, dhe John Trent. 1986. *Bekimi (The Blessing)*. New York: Pocket Books.
- Stonehouse, Catherine dhe Scottie, May. 2010. *Të dëgjojmë fëmijët gjatë udhëtimit shpirtëror: Udhëzues për ata të cilët japin mësim dhe mbarërrisin (Listening to Children on the Spiritual Journey: Guidance for Those Who Teach and Nurture)*. Grand Rapids, MI: Baker Academic.
- Yust, Karen-Marie. 2006. *Ushqimi shpirtërisht i fëmijës dhe i adoleshentit: Pikëpamje nga traditat e feve botërore (Nurturing Child and Adolescent Spirituality: Perspectives from the World's Religious Traditions)*. Lanham, MD: Rowman and Littlefield Publishers.

## Lista e plotë e materialeve të nevojshme

- Një kopje e printuar e “Festojmë familjen” për çdo pjesëmarrës
- Dokumentet me prezantimet në Powerpoint
- Laptop
- Projektor LCD
- Ekran projektimi
- Aparat fotografik për dokumentimin e workshop-itsi dhe për të bërë fotot e pjesëmarrësve
- Gërshërë
- Letër e printuar (letër boshe e bardhë)
- Kuti bojërash dhjami, lapsa dhe lapustila shumëngjyrësh
- Lapustila për tabakë letre (me ngjyra të ndryshme)
- Stilolapsa me majë të rrumbullakët
- Letër ngjitëse
- Letra shënimesh me ngjitëse nga mbrapa
- Tabelë për tabakët e letrave (nga një për çdo grup të vogël)
- Letër për tabelat e tabakëve të letrave
- Ditarë (nga një për çdo pjesëmarrës)
- Bibla dhe/apo libra të tjerë të shenjtë
- Kartela indeksi ngjyrë blu dhe të verdhë (apo me dy ngjyra të tjera)
- Kartela drejtkëndore në disa ngjyra të ndryshme
- Një kuti apo një tas i vogël bosh
- Figura gjetesh letre të prera me ngjyrë të verdhë ose jeshile
- Kopje të artikujve vijues, nga një për çdo pjesëmarrës:
  - Një kornizë fotografie e titulluar “Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time” (faqe 12)
  - Teksti për “Isaia” 54:2–3 (faqe 79)
  - Teksti i bekimit gaelik (faqe 80)
  - Formulari i mësimit të zbatimit (faqe 83)
  - Modeli i përditshëm i përshtatshmërisë të sesionit
  - Vlerësimi për përfundimin e workshop-it (faqe 91–92)
  - Dokumentimi i ndikimit të historisë (faqe 93–94)
- Dy kopje të “Vija kohore familjare” (faqe 47) për çdo pjesëmarrës
- Vizatim apo fotografi e një shtëpie të madhe në një tabak letre për veprimtarinë “Rërë” dhe “Shkëmb”
- Një tabak letre me dy kolona të etiketuara: “Shenja plotësie” dhe “Shenja thyerjeje”
- Dy ilustrime trungjesh peme në tabakë letre të veçantë, njëra e etiketuar “Pika të forta”, ndërsa tjetra “Fusha për rritje”
- Gjashtë tabakë letre (nga një për secilin grup të vogël) me një vizatim ilustrues të një semafori (faqe 55)
- Shtatë tabakë letre me një prej titujve të mëposhtëm të shkruar në të me germa shtypi: 1. zgjero vendin e çadrës sate, 2. pëlhurat e banesave të tua le të shtrihen, 3. pa kursim, 4. zgjati litarët e tu, 5. përforco kunjat e tua, 6. do të shtrihesh në të djathtë dhe në të majtë, 7. pasardhja jote do të zotërojë kombet.



**Festojmë familjen**

## Modeli i përshtatshmërisë të sesionit

Skuadra e ZHSHF-së është e përkushtuar ndaj cilësisë së trajnimit si dhe materialeve burimore të saj për ndërtimin e kapaciteteve. Komenti juaj do të bëjë të mundur që në materialet dhe punimet e ardhshme të garantohet cilësia dhe adresimi i nevojave aktuale.

**Emri (sipas dëshirës):** \_\_\_\_\_

**Pozita në WV:** \_\_\_\_\_

**Zyra e vendit / Shtetit / Mbështetëse:** \_\_\_\_\_

**Lehtësuesi / Lehtësuesit e punimit:**

Synohet që ky formular të përdoret në fund të çdo dite të punimit, për të vlerësuar adresimin e nevojave aktuale si dhe për përshtatshmërinë kulturore të secilit sesion.

<b>Veprimtaritë dhe përmbajtja e sesioneve të mëposhtme do të funksionojnë mirë në kontekstin e vendit apo komunitetit tim</b>	<b>Përgjigjia (ju lutem rrethoni "Po" ose "Jo")</b>	<b>Nëse rrethuat "Jo", ju lutemi, sugjeroni se si ky sesion mund të bëhet më i përshtatshëm për kontekstin tuaj.</b>
Sesioni 2: Shpresa dhe ëndrra ime për familjen time	Po / Jo	
Sesioni 3: Ngjarja më e paharruar për mua nga fëmijëria	Po / Jo	
Sesioni 4: Shenja të plotësisë, shenja të thyerjes	Po / Jo	
Sesioni 5: Farat e mirësisë	Po / Jo	

**Festojmë familjet**

Modeli i përshtatshmërisë të sesionit

Sesioni 6: Gëzime dhe dhimbje	Po / Jo	
Sesioni 7: Hapësirë për dashuri dhe hir	Po / Jo	
Sesioni 8: Arsye për mirënjohje dhe mundësi për të falur	Po / Jo	
Sesioni 9: Momente përcaktuese	Po / Jo	
Sesioni 10: Ndërtues të mençur	Po / Jo	
Sesioni 11: Përcaktimi i hapave tanë	Po / Jo	
Sesioni 12: “Të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të mia”	Po / Jo	
Sesioni 13: Të themi bekime	Yes/ No	

**Festojmë familjen**

## Vlerësimi në përfundim të punimit

Skuadra e ZHSHF-së është e përkushtuar ndaj cilësisë në punimet si dhe të materialeve burimore të saj për ndërtimin e kapaciteteve. Komenti juaj do të bëjë të mundur që në materialet dhe punimet e ardhshme të garantohet cilësia dhe adresimi i nevojave aktuale.

**Emri (sipas dëshirës):** \_\_\_\_\_

**Pozita në WV:** \_\_\_\_\_

**Vendi/ZK/ZM:** \_\_\_\_\_

**Lehtësuesi i takimit:** \_\_\_\_\_

<b>Ju lutem renditni deklaratat e mëposhtme në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është vlerësimi më i ulët, ndërsa 5 është vlerësimi më i lartë), duke vendosur një grremç (✓) poshtë numrit që përshkruan mendimin tënd.</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
1. Trajnimi trajtoi temat që unë prisja të trajtonte.					
2. Sesionet janë me lidhje me aktualitetin dhe të dobishme.					
3. Veprimtaritë e trajnimit ishin interesante.					
4. Lehtësuesi e prezantoi me efikasitet materialin.					
5. Lehtësuesi / lehtësuesit lanë kohë të mjaftueshme për pyetje dhe iu përgjigjën atyre siç duhet.					
6. Metoda e përdorur në këtë sesion qe e përshtatshme dhe përfshirëse.					
7. Materialet burimore (formularët, fashikujt e shpërndarë, doracaku “Të festojmë familjet” etj.) janë të thjeshta në përdorim.					
8. Kohëzgjatja e trajnimit qe e përshtatshme për mua.					
9. Ritmi i trajnimit qe i duhuri për mua.					
10. Përmbajtja qe e qartë si dhe e lehtë për t’u kuptuar.					
11. Unë besoj se këtë punim mund ta përsëris në vendin / komunitetin tim, duke përdorur udhëzuesin “Festojmë familjen”.					
12. Mënyra se si kryhet trajnimi është e përshtatshme për kontekstin / vendin tim.					

**Cila është gjëja më e rëndësishme që mësuat nga trajnimi “Festojmë familjen”?**

---



---



---

**Çfarë ndryshoi në mendësinë tënde gjatë punimit?**

---



---



---

## Festojmë familjen

Vlerësimi në përfundim të punimit

Çfarë temash specifike duhet të ishin:

Shtuar: \_\_\_\_\_

Lënë pa trajtuar: \_\_\_\_\_

Theksuar më shumë: \_\_\_\_\_

Theksuar më pak: \_\_\_\_\_

A keni ndonjë sugjerim se si mund të përmirësohet trajnimi “Festojmë familjen”?

---

---

---

---

---

---

Komente të mëtejshme (ju lutem shkruani emrin dhe detajet e kontaktit, nëse dëshiron të kontaktohesh rreth komenteve të tua):

---

---

---

---

---

---

Faleminderit për  
kommentet e tua.

Ju lutem kthejeni këtë fletë te:  
Nestor Dedel dhe / ose Shelly Winterberg  
Specialistë për ZHSHF-në  
nestor\_dedel@wvi.org  
shelly\_shupewinterberg@wvi.org

## Festojmë familjen

### Dokumentimi i historisë së ndikimit

Ju lutem shpërndajeni modelin që çdo pjesëmarrës në mënyrë që ta plotësojë. Sapo modelet e plotësuara të jenë mbledhur, ju lutem, hidhni përgjigjet e dhëna në kompjuter dhe dërgojini ato te: [Shelly\\_ShupeWinterberg@wvi.org](mailto:Shelly_ShupeWinterberg@wvi.org). Ky informacion do të vijë në ndihmë për aktualizimin dhe për vlerësimin e efikasitetit të këtyre materialeve burimore

**Emri:** \_\_\_\_\_

**Zyra kombëtare, Programi i Zhvillimit Zonal ose organizata partnere:**

\_\_\_\_\_

#### Fotoja ime në trajnimin “Festojmë familjen”

Lehtësuesi do të bëjë fotot individuale të të gjithë pjesëmarrësve, të cilat mund të bashkëngjiten në mënyrë dixhitale kur komentet nga secili pjesëmarrës të jenë shtypur në kompjuter dhe të jenë hedhur në model.

Vendos këtu foton e pjesëmarrësit:

Vendos këtu një përshkrim të fotos.

**Disa prej gjërave më të rëndësishme që kam mësuar nga trajnimi “Festojmë familjen” janë:**


**Festojmë familjen**

## Dokumentimi i historisë së ndikimit

Tri veprime që premtoj se do të ndërmarr pas këtij punimi:

1.
2.
3.

Një foto e imja me familjen time gjashtë muaj pas trajnimit “Festojmë familjet”.

Vendos këtu foton e familjes së pjesëmarrësit (nëse familja nuk e ka problem këtë gjë)

Vendos këtu një përshkrim të fotos

Çfarë ka ndryshuar?
Sa të rëndësishme ishin ndryshimet?
Në ç'mënyrë kontribuan materialet dhe trajnimi “Festojmë familjen” te këto ndryshime?

**Festojmë familjen**

Fleta gjurmuese e replikimit

Data	Vendi	Shteti / rajoni	Numri i pjesëmarrësve	Përshkrimi i pjesëmarrësve

Ju lutem kthejeni këtë fletë te:  
Nestor Dedel dhe / ose Shelly Winterberg  
Specialistë për ZHSHF-në  
nestor\_dedel@wvi.org  
shelly\_shupewinterberg@wvi.org

World Vision®



## ZYRAT NDËRKOMBËTARE

**Zyra Ekzekutive e World Vision International**  
Waterview House  
1 Roundwood Avenue  
Stockley Park  
Uxbridge, Middlesex  
UB11 1FG, UK

**World Vision e Brukselit & Përfaqësia në BE** ivzw  
18, Square de Meeûs  
1st floor, Box 2  
B- 1050 Brussels, Belgium  
+32.2.230.1621

**World Vision International Zyra e Ndërlidhjes Gjenevë dhe Kombet e Bashkuara**  
7-9 Chemin de Balexert  
Case Postale 545  
CH-1219 Châtelaine  
Switzerland  
+41.22.798.4183

**World Vision International Zyra e Ndërlidhjes New York dhe Kombet e Bashkuara**  
919, 2nd Avenue, 2nd Floor  
New York, NY 10017, USA  
+1.212.355.1779

[www.wvi.org](http://www.wvi.org)

